



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME

RAPORT

I PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

MBI GJENDJEN E KRIMINALITETIT

PËR VITIN 2015

MARS 2016

PËRMBAJTJA E LËNDËS

| | |
|---|------------|
| I. Drejtimit dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit | ..6 |
| 1.1 Lufta kundër korrupsionit..... | 6 |
| 1.2 Lufta kundër krimit të organizuar..... | 10 |
| 1.3 Hetimet pasurore..... | 12 |
| 1.4 Arritje të tjera në luftën kundër kriminalitetit..... | 14 |
| 1.5 Bashkëpunimi ndërkombëtar..... | 16 |
| 1.6 Të drejtat e njeriut..... | 17 |
| 1.7 Forcimi i kapaciteteve institucionale..... | 20 |
| 1.8 Bashkëpunimi ndërinstitucional..... | 23 |
| II. Analiza e treguesve të kriminalitetit..... | 27 |
| 2.1 Volumi i punës në hetim | 27 |
| 2.2 Çështje të përfaqësuara në gjykatë..... | 28 |
| 2.3 Treguesit kryesor të punës së prokurorisë | 29 |
| 2.4 Procedime penale të regjistruara sipas prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë .. | 37 |
| 2.5 Koeficientët e kriminalitetit për 100.000 banorë bazuar në sistemin statistikor të prokurorisë..... | 41 |
| 2.6 Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale..... | 43 |
| 2.7 Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë..... | 44 |
| 2.8 Kriminaliteti sipas strukturës së kodit penal..... | 45 |
| 2.9 Analiza e veprave penale sipas strukturës së kodit penal..... | 50 |
| Krime kundër jetës të kryera me dashje..... | 50 |
| Krime kundër jetës shkaktuar me pakujdesi..... | 60 |
| Vepra penale kundër shëndetit të kryera me dashje..... | 61 |
| Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia..... | 68 |

| | |
|--|-----|
| Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës..... | 69 |
| Krime seksuale..... | 72 |
| Vepra penale kundër lirisë së personit..... | 77 |
| Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit..... | 82 |
| Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes..... | 87 |
| Liria e besimit..... | 92 |
| Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike..... | 93 |
| Mashtrimet..... | 103 |
| Shkatërrimi i pronës..... | 110 |
| Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare..... | 119 |
| Vepra penale në veprimtarite bankare dhe financiare..... | 122 |
| Krime në fushën e doganave..... | 124 |
| Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet..... | 130 |
| Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë..... | 136 |
| Falsifikimi i dokumenteve..... | 139 |
| Zhvillimi i palejuar i lojrave të fatit..... | 146 |
| Vepra penale që çënojnë regjimin juridik të tokës..... | 149 |
| Vepra penale kundër mjedisit..... | 155 |
| Krime kundër pavarësisë e rendit kushtetues dhe krime që çënojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera..... | 160 |
| Vepra me qëllime terroriste..... | 161 |
| Vepra penale të kryera nga banda e armatosur, organizata kriminale..... | 162 |
| Krime kundër autoritetit të shtetit..... | 164 |
| Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik..... | 169 |
| Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike..... | 177 |

| | |
|---|------------|
| Vepra penale që lidhen me pastrimin e parave..... | 194 |
| Vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë..... | 198 |
| Vepra penale kundër drejtësisë..... | 204 |
| Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve..... | 212 |
| Veprat penale të korrupsionit..... | 213 |
| Krimi kibernetik..... | 221 |
| Trafiqet e paligjshme..... | 227 |
| Veprat penale që lidhen me prodhimin dhe kultivimin e narkotikëve..... | 232 |
| 2.10 Përmbledhje e tendencave të kriminalitetit sipas grupveprave penale..... | 240 |
| 2.11 Treguesi i efektivitetit të organit të prokurorisë në vite, në ngritjen e akuzës në fazën e hetimit paraprak | 242 |
| Treguesi i efektivitetit të organit të prokurorisë në vite, në gjykimin dhe në dënimin e të pandehurve..... | 242 |
| Të dhëna mbi llojet e dënimeve | 243 |
| 2.12 Të dhëna për të pandehurit | 248 |
| Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit..... | 250 |
| Të pandehur të mitur..... | 255 |
| Pasojat e veprave penale..... | 259 |
| III. Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja..... | 261 |
| 3.1 Ekstradimet..... | 261 |
| 3.2 Letërporositë..... | 267 |
| 3.3 Njohjet e vendimeve penale..... | 273 |
| 3.4 Transferimet e procedimeve penale..... | 277 |
| 3.5 Transferimet e personave të dënuar..... | 278 |
| 3.6 Urdhrat e arrestit ndërkombëtar..... | 279 |
| 3.7 Trajnime, vizita të prokurorëve jashtë vendit..... | 280 |

| | |
|---|------------|
| IV. Prokuroria për Krimet e Rënda | 288 |
| V. Drejtimet dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2016..... | 292 |

I. DREJTIMIT DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2015

Prokuroria në Republikën e Shqipërisë ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit në gjyq, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, si dhe kryen detyra të tjera të parashikuara me ligj.

Raporti vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm mbi numrin, llojet, shtrirjen territoriale, intensitetin dhe format e kriminalitetit në Republikën e Shqipërisë paraqitet në përmbushje të detyrimit të parashikuar nga neni 149 pika 4 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 53 të ligjit nr.8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Prokuroria në vitin 2015 hartoi Strategjinë Afatmesme 2015 - 2017, që synon përmbushjen me sukses të detyrimeve të saj kushtetuese dhe ligjore për ndëshkueshmërinë pa kompromis të të gjitha veprave penale, duke garantuar në të njëjtën kohë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut.

Në fokus të kësaj strategjie dhe punës së prokurorisë është ndëshkimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar, si fenomene që mbajnë peng zhvillimin e vendit dhe shoqërisë, si dhe bëhen pengesë për procesin integruar të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Në funksion të këtij qëllimi madhor, synojmë rritjen e standarteve të procedimit, rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së hetimit, forcimin e profesionalizimit dhe integritetit të trupës së prokurorëve, përmirësimin dhe modernizimin e kapaciteteve teknike e teknologjike, mbrojtjen dhe fuqizimin e pavarësisë së institucionit, si dhe intensifikimin e bashkëpunimit me institucionet ligjzbatuese partnere shqiptare dhe të huaja.

Në mënyrë të përmbledhur zhvillimet kryesore në luftën kundër kriminalitetit dhe në veprimtarinë institucionale të prokurorisë gjatë vitit 2015 kanë qenë:

1.1 Lufta kundër korrupsionit

Lufta kundër korrupsionit dhe në veçanti korrupsioni në nivele të larta dhe në sistemin e drejtësisë ka qenë prioritet i rëndësishëm i veprimtarisë së institucionit të Prokurorisë edhe gjatë vitit 2015.

Për këtë qëllim për të rritur dhe forcuar më tej efektivitetin e hetimit të këtyre çështjeve në shtator 2015 seksioni i hetimit të korrupsionit dhe pasurive në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda u ngrit në nivel Njësie dhe numri i prokurorëve në këtë strukturë u shtua në 5 prokurorë.

Gjatë vitit 2015 vërehet rritje e numrit të çështjeve të hetuara për veprat korruptive dhe rritje e efencës së hetimit. Konkretisht:

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 49 % të numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale të korrupsionit, në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq vërehet rritje prej 75 % e procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 70 %, një rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 29 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 110 %.

Brenda grupveprave penale të korrupsionit vihet re se:

Për veprën penale të parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, organi i prokurorisë ka regjistruar 58 procedime penale, që përbën rritje 2,7 herë ose 176 % në krahasim me vitin 2014. Janë dërguar për gjykim 47 procedime penale ndërsa në vitin 2014 rezultojnë 12 procedime të dërguara për gjykim. Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, vihet re rritje 168 % e numrit të të pandehurve të regjistruar dhe një rritje prej 145 % e numrit të të pandehurve dërguar për gjykim krahasuar me vitin 2014. Edhe numri i të pandehurve të dënuar në vitin 2015 është rritur 5,7 herë krahasuar me një vit më parë.

Procedimet penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, në vitin 2015, rezultojnë me rritje prej 8,5 % në krahasim me vitin 2014.


Gjatë vitit 2015 është regjistruar 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë” dhe 2 procedime penale për nenin 260 të Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 319 i Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, organi i prokurorisë ka regjistruar 7 procedime penale me 9 të pandehur. Ndërsa për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë” vërehet tendencë e qartë rritjeje e konkretisht organi i prokurorisë ka regjistruar 25 procedime penale me 9 të pandehur, ndërkohë që në vitin 2014 janë regjistruar 7 procedime me 2 të pandehur. Janë dërguar për gjykim 2 procedime penale me akuzë ndaj 3 të pandehurve dhe nga gjykata ka përfunduar gjykimi dhe janë dënuar 2 të pandehur për vitin 2015 për këtë veprë penale.

Gjatë vitit 2015 prokuroria ka ndjekur një politikë të ashpër penale për të pandehurit që kanë kryer vepra korruptive dhe kjo pasqyrohet në të dhënat konkrete lidhur me kërkesat për masat e sigurimit dhe llojin e masën e dënimit, të kërkuar nga prokurori.

Më poshtë jepet një paraqitje grafike e kërkesave të prokurorit për caktimin e masave të sigurimit, ku vërehet se 76 % e tyre kanë pasur si objekt caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe 24 % e kërkesave kanë pasur si objekt caktimin e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Sa i përket kërkesave të prokurorit për caktimin e dënimit për të pandehurit që kanë kryer vepra korruptive, vërehet se 59,4 % e kërkesave lidhen me caktimin e dënimit me burg, 38,5 % e përbëjnë kërkesat për caktimin e alternativave të dënimit me burg, 1 % kërkesat për dënim me gjobë dhe 1 % kërkesat për uljen e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete.

Të dhëna të detajuara gjenden në grafikët e mëposhtëm:



Njësitë e Përbashkëta Hetimore

Një ndër objektivat e vazhdueshëm të prokurorisë ka qenë rritja e kapaciteteve dhe profesionalizmit të Njësitë të Përbashkëta Hetimore, si struktura të specializuara për ushtrimin e ndjekjes penale, në fushën e korrupsionit, krimit ekonomik dhe pastrimit të parave. Masat kryesore të ndërmarra për këtë qëllim janë fokusuar në kryerjen e trajnimeve specifike për

prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore të Njësive të Përbashkëta Hetimore nga Shkolla e Magjistraturës dhe me mbështetje të vazhdueshme nga ana e partnerëve ndërkombëtarë, OPDAT, PAMECA IV dhe EURALIUS, nëpërmjet projekteve të ndryshme.

Njësitë e Përbashkëta Hetimore, ashtu siç janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme nga raportet e institucioneve ndërkombëtare edhe gjatë vitit 2015 kanë treguar se janë struktura shumë efiçente për hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale në fushën e korrupsionit, krimit ekonomik dhe pastrimit të parave. Nga të dhënat statistikore të vitit 2015, rezulton se Njësitë kanë trajtuar 3113 referime, që krahasuar me vitin 2014 gjatë të cilit janë trajtuar 2476 referime, rezulton një rritje e volumit të punës me 26 %. Janë hetuar për vitin 2015, 3170 procedime penale, që përbëjnë një rritje prej 36 % ndaj 2337 procedimeve penale të hetuara një vit më parë. Me rritje prej 68 % rezulton edhe numri i procedimeve të dërguara për gjykim gjatë vitit 2015, konkretisht 779 procedime të dërguara gjyqit ndaj 463 të tillave për vitin 2014. Një tregues i rëndësishëm i veprimitarisë hetimore të kryer është edhe dënueshmëria e të pandehurve të dërguar gjyqit. Të dhënat tregojnë se është dhënë fajësi për 88 % të të pandehurve dhe vetëm për 12 % të tyre është vendosur pafajësia ose pushimi i gjykimit.

Procedimet penale të regjistruara nga Njësitë e Përbashkëta Hetimore, gjatë vitit 2015 kanë ardhur nga burimet si vijon:

Janë regjistruar 44 procedime penale të filluara kryesisht nga prokurorët;

Janë regjistruar 1171 procedime penale mbi bazën e 1921 referimeve të ardhura nga Policia e Shtetit;

Janë regjistruar 41 procedime penale mbi bazën e 41 kallëzimeve të ardhura nga Kontrolli i Lartë i Shtetit;

Janë regjistruar 50 procedime penale mbi bazën e 69 kallëzimeve të ardhura nga Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;

Janë regjistruar 5 procedime penale mbi bazën e 9 kallëzimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave;

Janë regjistruar 67 procedime penale mbi bazën e 91 kallëzimeve të ardhura nga organet tatimore;

Janë regjistruar 79 procedime penale mbi bazën e 93 kallëzimeve të ardhura nga organet doganore;

Procedimet e tjera penale kanë si burim kallëzime të shtetasve dhe nëpunësve të tjerë publikë.

Pastrimi i produkteve të veprës penale

Në vitin 2015 Shqipëria doli nga lista e monitorimit të Këshillit të Evropës pas rezultateve pozitive në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Prokuroria, si një organ me rëndësi të veçantë në këtë luftë, arriti të tregojë rezultate konkrete hetimi e dënimi të këtyre veprave në përputhje me rekomandimet e Komitetit MONEYVAL.

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 18 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale, në krahasim me vitin 2014 ku peshën kryesore prej 90 % e përbëjnë procedimet e regjistruara për nenin 287 të Kodit Penal “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”. Procedimet penale të regjistruara për këtë veprë rezultojnë me një rritje prej 21 % ndërkohë që janë dënuar 5 të pandehur për këtë veprë penale gjatë vitit 2015.

Ndjekja penale ndaj autorëve të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal dhe vepra të tjera penale në këtë fushë vazhdon të jetë prioritet i punës së prokurorisë.

1.2 Krimi i organizuar dhe krime të rënda

Lufta kundër krimit të organizuar dhe krimeve të tjera të rënda është prioritet i rëndësishëm i organit të prokurorisë.

Nga të dhënat statistikore rezulton se, në vitin 2015 janë regjistruar 15 procedime penale me 41 të pandehur për vepra të parashikuara në kreun e XI të Kodit Penal, vepra penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale, 14 nga këto procedime për nenin 333/a, “Grupi i strukturuar kriminal”.

Ka përfunduar hetimi dhe janë dërguar për gjykim 7 procedime penale me 47 të pandehur, për krijimin, organizimin, drejtimin ose pjesëmarrjen në grupe të strukturuar kriminale për kryerjen e veprave penale si “Trafikimi i lëndëve narkotike”, “Kultivimi i bimëve narkotike”, “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit”, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municioneve luftarake”, etj.

Trafikët e paligjshme në vitin 2015 kanë një ulje të numrit të procedimeve të regjistruara prej 14,5 % në krahasim me vitin 2014.

Peshën kryesore në këtë grup e zë vepra penale e parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal, “Trafikimi i mjeteve motorike” me 47 % të procedimeve të regjistruara. Procedimet e regjistruara për këtë veprë gjatë vitit 2015, rezultojnë me një ulje prej 20 %, ndërsa procedimet e dërguara gjyqit janë në të njëjtin nivel si në vitin 2014.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a “Trafikimi i narkotikëve”, janë regjistruar 131 procedime penale ose 15 % më pak se e njëjta periudhë e vitit 2014, ndërkaq 59 procedime penale janë dërguar për gjykim.

Për veprën penale të “Trafikimit të personave”, janë regjistruar 38 procedime penale dhe 8 procedime penale janë dërguar për gjykim. Lidhur me veprën penale të “Trafikimit të të miturve”, janë regjistruar 14 procedime penale dhe është dërguar 1 procedim për gjykim.

Lidhur me grup veprat penale në fushën e **prodhimit dhe kultivimit të narkotikëve**, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 52 % të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë grup veprash penale në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi rritje prej 1,4 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Për këtë grup veprash penale vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 43 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 11,4 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 4 % përkundrejt vitit 2014.

Konkretisht për veprën penale të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal “Kultivimi i bimëve narkotike”, në vitin 2015, vërehet tendencë rritje prej 117 % në krahasim me vitin 2014.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, në vitin 2015, numri i procedimeve të regjistruara është 4 % më i lartë se në vitin 2014.

Lidhur me veprat penale të **prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve** gjatë vitit 2015 konstatohet se:

Pesha specifike që zë vepra penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, në grupin e “Veprave penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2015 është 11 %, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 11,9 %. Si pesha specifike dhe tendenca e procedimeve të regjistruara për këtë veprë është me ulje në vitin 2015, kjo e fundit prej 20 % në krahasim me vitin 2014.

Gjatë vitit 2015 prokuroria ka synuar ashpërsim të politikës së dënimit për të pandehurit që kanë kryer këto vepra penale dhe kjo pasqyrohet në të dhënat konkrete lidhur me llojin dhe masën e dënimit, sipas të cilave rezulton se 83 % e kërkesave për llojin e dënimit të kërkuar i përbëjnë kërkesat për dënimin me burg.

Pesha specifike që zë vepra penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta” në grupin e “Veprave penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2015 është 2,3 %, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 2,6 %. Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 279 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta”, në vitin 2015, prej 24 % në krahasim me vitin 2014.

Pesha specifike që zë vepra penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive” në grupin e “Veprave penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2015 është 1,2 %, ndërkohë që në vitin 2014 është 1,9 %. Kjo veprë rezulton me tendencë ulje në vitin 2015 prej 43 % në krahasim me vitin 2014.

Në vitin 2015 numri i procedimeve për **krimet kundër jetës të kryera me dashje** kanë **pësuar një ulje prej 21,5 % në krahasim me vitin 2014**. Të dhënat paraqesin tendencën në ulje prej 17 % të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal “Vrasja me dashje”, tendencën në ulje prej 47 % të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 78 “Vrasja me paramendim”, tendencën në ulje prej 44 % të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 79 “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, krahasuar këto me vitin 2014.

Tendencë në ulje vërehet edhe për veprën penale të vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare megjithatë kjo vepër mbetet ende problematike. Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 janë regjistruar 28 procedime penale që përbëjnë një ulje prej 9,7 % krahasuar me 31 procedime të regjistruara për vitin 2014. Nga ana e prokurorisë edhe gjatë vitit 2015 hetimi dhe dërgimi në gjyq i këtyre çështjeve ka qenë i shpejtë dhe me prova të plota. Të dhënat tregojnë se janë dërguar në gjyq 22 procedime penale me 22 të pandehur dhe nga gjykata janë dënuar 22 të pandehur për këtë vepër penale gjatë vitit 2015.

1.3 Hetimet pasurore

Përveç veprimtarisë verifikuese që kryejnë prokurorët e Njesisë së Hetimit të Korrupsionit Pasurisë dhe Akteve Terroriste në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda për procedimet që hetojnë, kanë marrë në shqyrtim edhe materiale referuese me origjinë nga prokuroritë e tjera të shkallës së parë, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, drejtoritë e policisë në qarqe dhe nga vetë veprimtaria hetimore e prokurorëve të kësaj prokurorie.

Gjatë vitit 2015 janë paraqitur nga prokuroria dhe janë pranuar nga Gjykata e Shkallës së parë për Krime të Rënda 14 kërkesa për sekuestrim pasurie, të lëna në fuqi nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, përveç dy rasteve që janë ende në gjykim. Vlera e pasurive të sekuestruara, kryesisht pasuri të paluajtshme dhe llogari bankare, është në nivele të larta. Gjatë vitit 2015 u paraqit dhe u pranua 1 kërkesë për konfiskimin e pasurive të sekuestruara, e cila më pas u revokua nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda.

Aplikimi i përgjimit të komunikimeve elektronike në hetimet paraprake si mjet për kërkimin e provës


Përgjimi është një mjet efektiv për kërkimin e provës në procesin penal. Në sajë të ndjekjes në dinamikë të interceptimit nga oficerët e policisë gjyqësore të sektorit të përgjimeve dhe bashkëpunimit e bashkëveprimit me kolegët e tyre në terren, në vitin 2015 është arritur në arrestimin në kushtet e flagrancës të 593 personave të dyshuar për vrasje, trafikim të lëndëve narkotike, korrupsion, trafikim të armëve, e të tjera vepra, që përbën rritje prej 15 % krahasuar me një vit më parë. Kalimi në kohë i informacionit të përfituar gjatë interceptimit, ka krijuar premisa për zgjerimin e hetimeve, rrethin e personave të inkriminuar duke i hapur rrugë ecurisë së hetimit. Në disa raste mbi të dhënat e përfituara gjatë interceptimit, është mundur regjistrimi i procedimeve penale të tjera kryesisht për veprën penale të korrupsionit të personave që kryejnë funksione publike.

Gjatë vitit 2015 janë ekzekutuar gjithsej 1945 vendime për lejimin e përgjimit, marrë nga prokurorët në kushtet e emergjencës si dhe vendime të autorizuara nga gjykata në hetimet

paraprake, aplikuar në lidhje me 702 procedime penale. Sa sipër është mundësuar interceptimi për 4099 persona.

Numri më i madh i aplikimit të përgjimeve lidhet me procedimet penale të regjistruara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ku rezultojnë 859 vendime marrë në 164 procedime penale.

Ecuria e këtij mjeti kërkimi prove në 3 vitet e fundit paraqitet në grafikë si vijon:



Rritja e efektivitetit të hetimeve

Në vitin 2015, në Prokurorinë e Përgjithshme nisi funksionimi i shërbimeve të ekspertimit. Në vlerësojmë se vënia në efikasitet dhe rritja e kapaciteteve të shërbimeve të ekspertimeve, si ekspert autoteknik, ekspert kontabël dhe vlerësues, ekspert të kibernetikës, etj, me funksione këshillimore për prokurorët për çështje që kërkojnë njohuri të thelluara dhe të posaçme teknike në fusha të caktuara, i shërben rritjes së cilësisë dhe efektivitetit të hetimit, dhe këtë e mbështesin rezultatet konkrete të punës së ekspertëve gjatë vitit 2015.

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm për rritjen e shpejtësisë, cilësisë dhe efektivitetit në hetime **aksesin në bazat shtetërore të të dhënave**, nga institucioni i prokurorisë janë ndërmarrë hapa konkretë drejt bashkëpunimit me të gjitha institucionet kompetente, për të realizuar këtë objektiv. Prokuroria ka nënshkruar memorandumet përkatëse për të siguruar akses në bazat e të dhënave shtetërore të TIMS, Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, të Gjendjes Gjyqësore, Qendrës Kombëtare të Liçencimit, sistemin e menaxhimit elektronik të çështjeve të përmbarimit gjyqësor, bazën e të dhënave të shërbimit noterial shqiptar, sistemin e menaxhimit elektronik të çështjeve gjyqësore (ICMIS) dhe bazën e të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Konkretisht të dhënat evidentojnë rritje të efektivitetit të hetimit të organit të prokurorisë në vitin 2015 gjatë të cilit rezulton një rritje prej 5,6 % e numrit të çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2014 dhe një rritje prej 7,7 % e numrit të çështjeve të dërguara në gjyq në krahasim me vitin 2014.

Po kështu vërehet rritje edhe në efektivitetin e ngritjes së akuzës në vitin 2015, gjatë të cilit janë dërguar për gjykim 84 % e të pandehurve dhe janë pushuar hetimet për 16 % të të pandehurve, që krahasuar me vitin 2014 tregon një rritje prej 7 % të numrit të të pandehurve dërguar për gjykim.

1.4 Arritje të tjera në përmbushjen e prioritetëve në luftën kundër kriminalitetit

Juridiksioni fillestar

Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme hetojnë në shkallë të parë veprat penale të kryera nga subjektet për të cilat Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar në bazë të nenit 141 të Kushtetutës dhe nenit 75/b të Kodit të Procedurës Penale. Gjatë këtij viti, janë regjistruar në Prokurorinë e Përgjithshme 22 kallëzime e referime në bazë të të cilave janë regjistruar 12 procedime penale dhe është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 10 kallëzime/referime ndaj disa deputetëve, ish-deputetëve apo ish-ministrave.

Është për t'u theksuar fakti se 4 procedime penale janë hetuar e dërguar për gjykim në vitin 2015.

Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet

Në muajin Shtator 2015, Prokuroria e Përgjithshme nënshkroi me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme një Memorandum Bashkëpunimi në kuadër të forcimit të luftës kundër evazionit dhe informalitetit. Të dhënat statistikore tregojnë se në vitin 2015 ka një rritje prej 2 herë të numrit të procedimeve të regjistruara për “Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet” në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq ka një rritje prej 4 herë të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re sërish rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 2,5 herë, rritje 4 herë e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata 6 herë më shumë përkundrejt vitit 2014.

Kjo rritje vlerësojmë se është pasojë e rritjes së përgjegjshmërisë së strukturave shtetërore që kanë detyrimin ligjor të evidentimit dhe kallëzimit të shkeljeve penale në lidhje me taksat e tatimet.

Krime në fushën e doganave

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje të lehtë prej 2,6 % të numrit të procedimeve të regjistruara për krime në fushën e doganave në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi rritje prej 61 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 37 %, numri i të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit është rritur me 65,5 %, ndërsa numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është dyfishuar krahasuar me vitin 2014.

Vjedhja e pasurisë

Raporti që zë **vjedhja e pasurisë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 39,5 %, tregues pothuajse i njëjtë me vitin 2014.

Procedimet e regjistruara për vjedhjen e pasurisë paraqesin tendencën në ulje në vitin 2015 prej 7 % dhe po kështu vihet re ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 11 %. Ndërsa rezultojnë me rritje prej 25 % procedimet e dërguara për gjykim, rritje prej 16 % numri i të pandehurve të cilët janë dërguar për gjykim dhe rritje prej 45 % numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata, përkundrejt të njëjtëve tregues në vitin 2014.

Peshën më të madhe specifike në grupin “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike” e zë vepra penale e parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal “Vjedhja”, që përbën 79,7 % të procedimeve të regjistruara.

Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike është një vepër tjetër me peshë të lartë në këtë grup, konkretisht përbën 16,5 %, të totalit të procedimeve të regjistruara për veprat penale të vjedhjes së pasurisë. Ndërkaq, procedimet penale të regjistruara për këtë vepër kanë pësuar një ulje prej 15,7 % në krahasim me vitin 2014.

Në analizë të të dhënave për të pandehurit e regjistruar për këtë vepër penale, mund të nxjerrim si konkluzion se faktorët kriminogjenë që ndikojnë në kryerjen e saj kanë të bëjnë kryesisht me nivelin e papunësisë, ku pjesa më e madhe e të pandehurve 62,5 % rezulton e papunë dhe 36,5 % të punësuar në sektor privat dhe njëkohësisht me arsimimin e personave të marrë si të pandehur ku shtetasit me arsim deri 9 vjeçar rezultojnë më së shumti (54 %) si autorë të kësaj vepre dhe ata me arsim të lartë janë vetëm 4 %.

Nisur nga sa më sipër organi i prokurorisë ka qenë i kujdesshëm në politikën e tij të dënimit duke vlerësuar objektivisht faktet, provat e rrethanat e çdo çështjeje. Nga të dhënat lidhur me kërkesat e prokurorit për caktimin e dënimit rezulton se 55 % të tyre e përbëjnë kërkesat për dënim me burg.

Ndërtimi i paligjshëm

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale që çënojnë regjimin juridik të tokës për vitin 2015 është 88 %, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 93,6 %. Të dhënat tregojnë

tendencën në ulje të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal “Ndërtimi i paligjshëm” në vitin 2015 prej 31 % në krahasim me vitin 2014, ndërsa numri i të pandehurve të regjistruar është rritur me 5 %. Numri i procedimeve të dërguara për gjykim është rritur 52 % dhe numri i të pandehurve të dërguar për gjykim është rritur me 48 %.

Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2015 është 13 %, ndërkohë që për vitin 2014 ka qenë 10 %.

Për vitin 2015, për këtë vepër penale konstatohet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, prej 17 % në krahasim me vitin 2014.

Krimi kibernetik

Spektori i krimit kibernetik në Prokurorinë e Përgjithshme në bashkëpunim me partnerët që asistojnë prokurorinë, ka synuar edhe gjatë vitit 2015 ngritjen profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në hetimin e krimit kibernetik dhe unifikimin e procedurave hetimore në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Në këtë aspekt janë zhvilluar trajnime, vizita studimore dhe analiza të rasteve konkrete.

1.5 Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar

Gjatë vitit 2015 bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar në çështjet penale, në të gjithë fushat e tij si ekstradime, letërporosi, shpallje në kërkim ndërkombëtar, transferim procedimesh penale dhe personash të dënuar, njohje e vendimeve penale etj, ka pësuar zhvillime të rëndësishme që shprehen në tregues sasior dhe cilësor.

Bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar në çështjet penale ka ndihmuar veçanërisht në luftën kundër trafikëve të paligjshme, krimit të organizuar, terrorizmit dhe krimeve të tjera të rënda. Kështu të dhënat tregojnë se, Prokuroritë e Shkallës së Parë kanë dërguar pranë autoriteteve të huaja kërkesa për ndihmë juridike në kuadër të procedimeve penale të regjistruar për vepra të ndryshme penale, ndër të cilat përmendim ato të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda si më poshtë:

- 180 letërporosi për autoritetet e huaja (ose 24 % e totalit të letërporosive) për kryerjen e veprave penale të trafikëve të paligjshme, përfshirë këtu trafikimin e të miturve, personave të rritur, trafikimin e narkotikëve dhe trafikimin e mjeteve motorike;
- 121 letërporosi (ose 16,2 % e totalit të letërporosive) për kryerjen e veprave penale të krimit kibernetik, të cilat i janë drejtuar shteteve si, SHBA, Britani e Madhe, Nigeri, Gjermani, Suedi etj;

- 116 letërporosi (ose 15,5 % e totalit të letërporosive) për kryerjen e veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;
- 20 letërporosi (ose 2,7 % e totalit të letërporosive) për veprat penale të mashtrimit;
- 18 letërporosi (ose 2,4 % e totalit të letërporosive) në kuadër të procedimeve për kryerjen e krimeve kundër jetës të kryera me dashje;
- 5 letërporosi për kryerjen e veprave penale të dhunës në familje dhe braktisjes së fëmijëve;
- 4 letërporosi për kryerjen e veprave penale të korrupsionit aktiv apo pasiv të gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë, apo korrupsionit të personave që ushtrojnë funksione publike;
- 2 letërporosi drejtuar autoriteteve amerikave të drejtësisë në kuadër të veprës penale të grupit të strukturuar kriminal;
- si dhe 1 letërporosi për veprat penale të terrorizmit.

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2015, autoritetet gjyqësore të huaja kanë dërguar pranë autoriteteve shqiptare kërkesa për ndihmë juridike në kuadër të procedimeve penale të regjistruar për vepra të ndryshme penale, ndër të cilat përmendim ato të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda si më poshtë:

- 48 letërporosi të ardhura nga autoritetet e huaja gjyqësore për kryerjen e veprave penale të trafikëve të paligjshme, ndër të cilat 14 i ka transmetuar Kosova, 11 Italia etj;
- 17 letërporosi për vepra penale të kryera nga organizata kriminale, ndër të cilat 6 kanë ardhur nga Italia, 4 nga Franca etj;
- 12 letërporosi për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, nga shtete si Holanda, Greqia, Mbretëria e Belgjikës, Franca, Italia etj;
- 2 letërporosi për veprat penale të terrorizmit të ardhura nga autoritetet gjyqësore greke dhe serbe.

Gjithashtu, gjatë vitit 2015 rezulton se:

- 1 shtetas shqiptar është ekstraduar në Itali në kuadër të çështjes penale për veprën penale të krijimit të organizatës kriminale me qëllim kryerjen e akteve terroriste;
- 8 kërkesa për ekstradim janë paraqitur nga autoritetet e huaja për shtetasit e shpallur në kërkim ndërkombëtar që janë arrestuar në Shqipëri, për veprat penale të trafikimit;
- 28 kërkesa për ekstradim janë paraqitur nga autoritetet e huaja për shtetasit e shpallur në kërkim ndërkombëtar që janë arrestuar në Shqipëri, për veprat penale të organizatës kriminale, përkatësisht 1 nga Kosova e Serbia dhe 26 kërkesa nga Italia.

1.6 Të drejtat e njeriut

Prokuroria është angazhuar maksimalisht për të siguruar mbrojtjen e të drejtës kushtetuese të pronës private dhe shtetërore nga veprimtaria e kundërligjshme. Në këtë kuadër, është forcuar bashkëpunimi me Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Avokaturën e Shtetit,

me qëllim hetimin e plotë të veprave penale në këtë fushë dhe parandalimin e ardhjes së pasojave të tjera për shtetin dhe qytetarët.

Respektimi i të drejtave të ligjshme të shtetasve dhe mbrojtja e lirive themelore të tyre duke garantuar në çdo rast procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, përbën për organin e prokurorisë një detyrim kushtetues. Gjatë hetimeve paraprake dhe në mënyrë të veçantë në zbatimin e kushteve dhe kritereve ligjore në kërkesat për caktimin e masave të sigurimit dhe caktimit të dënimit, të drejtat e të pandehurve garantohen dhe mbrohen nga parimi i ligjshmërisë dhe proporcionalitetit.

Politikë e kujdesshme është ndjekur nga prokuroria në kërkesat e saj për të pandehurit e mitur dhe të pandehurat femra. Ka shënuar rritje të ndjeshme kërkesa e prokurorëve për masa sigurie alternative nga ajo e arrestit me burg. Po ashtu, edhe në dënimin përfundimtar, organi i prokurorisë ka dëshmuar kujdes në kërkesat e tij, me qëllim riintegrimin e të pandehurve të mitur dhe të pandehurave femra, të përfshirë në vepra të ndryshme penale.

Mbrojtja e të drejtave të të miturve në procesin penal, ka qënë në fokusin e punës së organit të prokurorisë edhe gjatë vitit 2015. Me miratimin e udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.3, datë 25.11.2013 *“Për hetimin e veprave penale ku i mituri përfshihet si i pandehur, person nën hetim, i dëmtuar dhe/ose dëshmitar”*, tashmë është unifikuar praktika dhe garancitë procedurale për të miturin në procesin penal. Kështu është siguruar pa asnjë përjashtim, pjesëmarrja e psikologut gjatë procedimeve penale, respektimin e sekretit të informacionit dhe ndalimin e publikimit të akteve hetimore të mbledhura nga policia gjyqësore, shmangia e vonesave të panevojshme gjatë hetimeve paraprake dhe gjatë gjykimit, siguri i njoftimit të menjëhershëm të prindërve ose përfaqësuesve të tyre ligjorë, mbrojtja dhe zbatimi i parimit të interesit më të lartë të të miturit etj.

Lidhur me caktimin e dënimit për të pandehurit e mitur 14 deri 18 vjeç gjatë vitit 2015, rezulton se për vitin 2015 është kërkuar për 385 të pandehur të mitur caktimi i dënimeve alternative, kryesisht pezullimi i vendimit të dënimit me burg dhe vënia në provë, e shprehur në përqindje një rritje prej 12 % krahasuar me vitin 2014 dhe 30 % krahasuar me vitin 2013. Ndërsa kërkesat e prokurorit për caktimin e dënimit me burg kanë ardhur duke u ulur çdo vit ku të dhënat tregojnë se në vitin 2015 janë ulur 10 % krahasuar me vitin 2014 dhe 26 % krahasuar me vitin 2013.

Në mënyrë të veçantë, **rritja e efektivitetit të hetimit të veprave penale të kryera ndaj fëmijëve, martesës dhe familjes ka qënë prioritet i prokurorisë. Në vitin 2015 prokuroria ka dërguar për gjykim një numër procedimesh që përbëjnë 81 % të numrit të procedimeve të regjistruara për këto vepra penale.**

Sa i përket veprave penale tipike që kanë si subjekt pasiv femrat, të dhënat statistikore tregojnë se krimet seksuale ndaj tyre janë pothuajse në të njëjtin nivel me vitin 2014, ndërsa një trend i

fortë rritës vërehet në procedimet penale të regjistruara për veprën “Shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë” me 115 %. Edhe për këtë vepër theksojmë se numri i procedimeve të dërguara për gjykim i korrespondon një shifre që përbën 60 % të numrit të procedimeve të regjistruara.

Ndihmësit e viktimave

Prokuroria ka synuar rritjen e përgjegjësisë institucionale në mbrojtjen e të drejtave të individit dhe respektimin e dinjitetit, privatësisë, sigurisë personale të personave të dëmtuar nga vepra penale dhe njëkohësisht njohjen me të drejtat e tyre në procesin penal. Realizimi i këtij qëllimi kërkon rritjen e standardeve në mënyrën sesi trajtohen viktimat e krimit, e cila ka një ndikim shumë të madh në sistemin e drejtësisë penale, në rehabilitimin e tyre dhe besimin e qytetarëve në këtë sistem. Për këtë qëllim në muajin janar 2016, është finalizuar ngritja e Zyrës së Ndihmësit të Viktimave duke patur si objekt të punës sigurimin e informimit dhe këshillimit të viktimave të krimit me fokus të veçantë viktimat në moshë të mitur apo me aftësi të kufizuara, viktimat e dhunës në familje, viktimat e dhunës ose shfrytëzimit seksual, trafikimit të qënieve njerëzore dhe terrorizmit.

Aksesi në drejtësi

Në vijim të bashkëpunimit dhe angazhimit institucional që ka ndërmarrë organi i prokurorisë në kuadër të garantimit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, veçanërisht të mbrojtjes nga diskriminimi dhe sigurimit të aksesit të barabartë në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara (PAK) në Shqipëri, me nënshkrimin në mars 2014 të Memorandum Bashkëpunimit me Shoqatën e të Verbërve të Shqipërisë, janë realizuar një sërë aktiviteteve dhe seminare në të gjithë vendin, ku kanë qenë pjesëmarrës gjyqtarë, prokurorë, noterë, avokatë, punonjës të administratës gjyqësore dhe oficerë të policisë gjyqësore. Qëllimi kryesor i këtyre aktiviteteve ka qenë rritja e kapaciteteve të administratës së sistemit të drejtësisë për të siguruar akses të barabartë të PAK në organet e drejtësisë, rritja e ndërgjegjësimit të medias dhe shoqërisë në këto çështje, dhe vetë personave me aftësi të kufizuara dhe partnerëve të tyre për të identifikuar, adresuar dhe referuar nevojat e PAK në organet e drejtësisë.

Në këtë projekt nga Prokuroria e Përgjithshme është ofruar mbështetje institucionale e vazhdueshme, nëpërmjet caktimit të një eksperti ligjor, i cili ka ndjekur dhe kontribuar në realizimin e objektivave konkretë.

Aksesi i publikut në informacion

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” në muajin Maj 2015 është përgatitur programi i transparencës për Prokurorinë Shqiptare, si një mënyrë konkrete për rritjen e transparencës në veprimtarinë e punës së prokurorisë.

Informacioni është ofruar nëpërmjet pasqyrimin të detajuar në faqen zyrtare të internetit, në mjediset e pritjes së publikut dhe në përgjigje të kërkesave gjithmonë në rritje të publikut, organizmave joqeveritare dhe shoqërisë civile.

Edhe marrëdhëniet me median kanë qenë korrekte duke u garantuar në çdo rast transparenca dhe konfidencialiteti në lidhje me veprimtarinë e institucionit tonë.

1.7 Forcimi i kapaciteteve institucionale

Kontrolli i brendshëm

Kontrolli i brendshëm i prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe i prokurorive pranë gjykatave të apelit, me synim mbikqyrjen e ushtrimit të funksioneve të tyre në zbatimin e Kushtetutës, ligjit dhe akteve normative të Prokurorit të Përgjithshëm, ka qenë një ndër prioritetet e punës së Prokurorisë së Përgjithshme në vitin 2015.

Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme në përmbushje të këtij funksioni, për këtë periudhë kanë ushtruar kontrole të përgjithshme, të pjesëshme, për grup çështjesh dhe për çështje të veçanta.

Në këtë kuadër, kryesisht mbi bazë të informacioneve të drejtuesve të prokurorive, ka përfunduar inspektimi, për veprimtarinë e disa prokurorëve në prokurori të ndryshme, konkretisht Kurbin, Lezhë, Sarandë, Mat dhe Fier. Janë ushtruar kontrole të pjesëshme, bazuar në informacionet e ardhura nga drejtoritë në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe nga ankesat e shtetasve dhe është kryer kontrolli i përgjithshëm në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, i cili është në fazën e përpilimit të raportit përfundimtar.

Gjatë vitit 2015 janë kontrolluar në total 1854 procedime penale (vendime mosfillimi, vendime për pushimin e hetimeve, etj.) si dhe 895 dosje të gjykuara dhe masa sigurimi të marra në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë. Nga kontrolli i ushtruar janë shfuqizuar vendimet për tre procedime penale, duke i kaluar për hetime të mëtejshme në prokuroritë përkatëse.

Në përfundim, nga rezultatet e kontrolleve të ushtruara si më sipër, janë filluar procedime disiplinore për 5 prokurorë.

Këshilli i Prokurorisë ka shqyrtuar procesin disiplinor për 5 prokurorë dhe në përfundim të këtij procesi, duke marrë në konsideratë propozimet e Këshillit të Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm ka dhënë masë disiplinore “Ulje në detyrë” për një prokuror, masë disiplinore “Vërejtje” për dy prokurorë, “Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra” për një prokuror, si dhe i ka propozuar Presidentit të Republikës shkarkimin nga detyra të një prokurori. Presidenti i Republikës ka dekretuar shkarkimin nga detyra të këtij prokurori.

Gjithashtu në rastin e fillimit të procedimit disiplinor për një prokuror, është dërguar për procedim disiplinor edhe oficeri i policisë gjyqësore, të cilit i ishte deleguar kryerja e veprimeve

hetimore. Pas shqyrtimit në Komisionin Disiplinor, ndaj këtij oficeri është dhënë masa disiplinore “Pezullim nga detyra deri në 6 muaj”.


Vendimmarrja e Prokurorisë së Përgjithshme

Veprimtaria hetimore e prokurorëve të shkallës së parë ka qenë objekt i kontrollit (*duke u iniciuar ky kontroll kryesisht, apo në bazë të ankesave të qytetarëve dhe institucioneve ligjzbatuese*) edhe nga prokurorët e drejtorive të kontrollit të hetimit dhe ndjekjes penale në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët gjatë vitit 2015 kanë shqyrtuar 1380 praktika.

Në përfundim të shqyrtimit janë marrë 89 vendime e konkretisht, 42 vendime për shfuqizimin e vendimeve të pushimit, 20 vendime për shfuqizimin e vendimeve të mosfillimit, janë marrë 20 vendime për zgjidhje të mosmarrëveshjeve për kompetencën tokësore apo lëndore. Vendimmarrje është ushtruar në funksion të zgjidhjes së kërkesave të tjera gjatë hetimit, si vendime lidhur me zëvendësimin e prokurorit ose mospranimi i kërkesave për zëvendësim të prokurorit, heqje dorë, zgjatje afati hetimor, ankim të prokurorit ndaj vendimit të drejtuesit etj.

Kontrolli i veprimtarisë hetimore nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme, nxjerrja e problematikave, urdhrave e udhëzimeve dhe lënia e detyrave konkrete për prokurorët pranë prokurorive të shkallës së parë, ka vijuar që të ndikojë në përfundimin e hetimeve në një kohë sa më të shkurtër dhe në rritjen e cilësisë së hetimit.

Grafiku në vijim paraqet të dhënat për vendimmarrjen e Prokurorisë së Përgjithshme gjatë vitit 2015:



Këshilli i Prokurorisë

Këshilli i Prokurorisë, si organ këshillimor në ndihmë të Prokurorit të Përgjithshëm, gjatë vitit 2015 ka zhvilluar 11 mbledhje, për të shqyrtuar dhe dhënë mendim për aktet nënligjore të Prokurorit të Përgjithshëm, procedime disiplinore të prokurorëve, vlerësimet e punës së prokurorëve, shqyrtimin e kandidaturave për t'u emëruar prokuror, drejtues prokurorie apo kandidatura për ngritje në detyrë, çështje të riorganizimit apo ristrukturimit të prokurorisë shqiptare. Propozimet e Këshillit të Prokurorisë në çdo rast janë pranuar nga Prokurori i Përgjithshëm.

Në drejtim të rritjes së rolit të Këshillit të Prokurorisë dhe rritjes së transparencës e meritokracisë në çështjet që lidhen me emërimin e prokurorëve, pas shqyrtimit dhe miratimit nga ky organ, Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë udhëzimin nr.3, datë 11.02.2015 "Procedura e konkurrimit të kandidatëve për prokurorë që kanë punuar gjyqtarë, prokurorë ose oficerë të policisë gjyqësore". Procesi organizohet nga Këshilli i Prokurorisë pas shpalljes publike të vendeve vakante sipas kësaj procedure:

- Verifikimi i plotësisimit të kriterëve nga Komisioni i Verifikimit dhe vlerësimi nga Këshilli i Prokurorisë;
- Testimi me shkrim që përgatitet nga Komisioni i Testimit i përbërë nga prokurorë me përvojë;
- Seanca dëgjimore për kandidatët që janë kualifikuar në fazën e parë, që zhvillohet nga Këshilli i Prokurorisë.

Këshilli i Prokurorisë ka organizuar me sukses në vitin 2015 procedurat e konkurrimit me shkrim e me gojë për emërimin si prokurorë të kandidatëve që kanë punuar më parë si prokurorë, gjyqtarë ose ata që vijnë nga një eksperiencë pune minimumi 5 vjet si oficerë të policisë gjyqësore.

Forcimi i integritetit të prokurorëve

Kodi i Etikës, i miratuar në muajin qershor të vitit 2014, parashikoi standarte të qarta dhe të detyrueshme sjelljeje për prokurorët, në thelb të të cilave qëndron detyrimi që ata të veprojnë në përputhje me të drejtat e njeriut dhe efektivitetin e drejtësisë penale.

Për të garantuar njohjen dhe kuptimin e drejtë e të unifikuar të këtyre rregullave, Bordi Organizativ i Trajnimeve pranë Prokurorisë së Përgjithshme, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës dhe Ambasadën Amerikane, kanë zhvilluar një cikël trajnimesh duke arritur brenda gjashtë mujorit të parë të vitit 2015 trajnimin e gjithë trupës së prokurorëve mbi Kodin e ri të Etikës.

Inspektori i Etikës ka luajtur rol këshillues si gjatë trajnimeve mbi Kodin e Etikës, duke qenë se janë trajtuar në formë hipotetike një numër i konsiderueshëm rastesh praktike mbi etikën, me të cilat mund të përballen prokurorët në ushtrimin e kompetencave të tyre, ashtu edhe në vijimësi. Inspektori i Etikës ka trajtuar raste konkrete të referuara si shkelje të etikës së prokurorit nga prokurorët, punonjësit e administratës së prokurorisë e të tjerë, duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse, ku veçojmë se në një rast është propozuar dhe ka nisur procedimi disiplinor.

Nga ana tjetër edhe sistemi i vlerësimit po ndikon në rritjen profesionale të prokurorëve, por synohet në përmirësimin e mëtejshëm të tij për t'i shërbyer objektivisht si karrierës së prokurorit ashtu edhe evidentimit të nevojave për ndërhyrje me trajnime.

Gjatë vitit 2015, janë përfunduar procedurat e vlerësimit të punës (për vitin 2014) për 222 prokurorë, duke kaluar për miratim në Këshillin e Prokurorisë të gjitha vlerësimet.

Gjithashtu nga drejtuesit e prokurorive janë bërë vlerësimet për 70 oficerë të policisë gjyqësore.

Trajnime dhe shkëmbime eksperiencash

Forcimi i kapaciteteve profesionale ka qenë dhe mbetet një nga objektivat e punës së prokurorisë me synim rritjen e aftësive profesionale dhe profilizimin e prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe punonjësve të administratës për të rritur efektivitetin në ushtrimin e funksioneve të tyre.

Në kuadër të trajnimit vazhdues të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, gjatë vitit 2015 ka pasur pjesëmarrje të lartë në trajnime, mbi bazë të tematikave të zgjedhura nga vetë prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe ndihmësit ligjorë.

Në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe me organizmat e tjera ndërkombëtar (OPDAT, PAMECA, EURALIUS, etj.) janë intensifikuar trajnimet e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore brenda dhe jashtë vendit.

Gjatë vitit 2015, Institucioni i Prokurorisë, ka marrë pjesë duke u përfaqësuar nga prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore dhe ndihmës ligjorë, në një sërë aktivitetesh ndërkombëtare si, vizita, konferenca, seminare, trajnime.

Gjithashtu janë organizuar pritjet e 2 përfaqësive të nivelit të lartë, Prokurorisë së Përgjithshme të Bosnje - Herzegovinës dhe Prokurorisë së Shtetit të Kosovës, është marrë pjesë në 7 vizita zyrtare në kuadër të bashkëpunimit dhe shkëmbimeve të ideve në drejtësinë penale në shtete si Gjermani, Çeki, Spanjë, Francë e po kështu Prokuroria e Përgjithshme ka marrë pjesë në 12 takime të nivelit të lartë, operacional dhe rajonal dhe 8 konferenca ndërkombëtare me tema si *Kundërveprimi ndaj pastrimit të parave që burojnë nga korrupsioni; Roli i sistemit të drejtësisë penale në zbatimin e strategjive parandaluese dhe shtypëse kundër luftëtarëve të huaj terroristë*, etj.

1.8 Bashkëpunimi ndërinstytucional

Raporti me Presidentin e Republikës

Gjatë vitit 2015, Presidenti i Republikës ka dekretuar disa propozime të Prokurorit të Përgjithshëm për emërimet, ngritje në detyrë, transferime të prokurorëve.

Presidenti i Republikës është informuar në vazhdimësi për konkluzionet e kontrolleve të ushtruara në organin e prokurorisë dhe për problematika të ndryshme. Një përfaqësues i Presidentit është anëtar i Këshillit të Prokurorisë, duke ndjekur në dinamikë veprimtarinë e Këshillit, objekt i të cilës janë çështjet më të rëndësishme të prokurorisë, si karriera, disiplina, aktet nënligjore të Prokurorit të Përgjithshëm, etj.

Raporti me Kuvendin e Shqipërisë

Prokuroria e Përgjithme ka patur një rol të rëndësishëm në proceset e diskutimeve të shumë projektligjeve, kryesisht në fushën e së drejtës penale. Krahas kontributit që ka dhënë drejtpërdrejt pranë institucioneve që kanë ushtruar iniciativën ligjore, një bashkëpunim serioz në dhënien e mendimeve ligjore mbi projektligjet e ndryshme ka qenë edhe ai me Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, ku prokuroria ka kontribuar aktivisht në përmirësimin e shumë projektligjeve. Një aspekt i rëndësishëm i bashkëpunimit me Kuvendin e Shqipërisë është edhe kontributi ynë në kuadër të Reformës në Drejtësi.

Raporti me Ministrinë

Marrëdhëniet me Ministrinë e Drejtësisë, gjatë vitit 2015 kanë qenë intensive në të gjitha drejtimet dhe nivelet e komunikimit dhe bashkëpunimit.

Ministria e Drejtësisë ka dërguar për mendim në prokurori një sërë projektaktesh të rëndësishme në fushën e drejtësisë penale. Nga ana jonë çdo iniciativë ligjore është vlerësuar me prioritet me qëllim dhënien e kontributit, eksperiencës dhe ekspertizës sonë për përmirësimin e kuadrit ligjor.

Vlerësohet të theksohet se gjatë vitit 2015 bashkëpunimi ndërmjet Drejtorive të Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Ministrinë e Drejtësisë ka qenë tejet i frytshëm dhe efikas, duke i shërbyer kështu forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndërveprimit në kohë reale për realizimin e objektivave.

Gjatë vitit 2015, nga ana e Ministrisë së Drejtësisë janë ushtruar kontrole dhe janë dërguar raportet për rezultatet, në 7 prokurori pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe një Prokurori Apeli. Mbi këtë bazë janë kryer inspektive verifikuese në 5 prokurori, sipas rekomandimeve e sugjerimeve të Ministrisë së Drejtësisë (për tre prokurori nuk janë konstatuar shkelje). Në përfundim të verifikimeve, vetëm në një rast është filluar procedimi disiplinor dhe është dhënë masa “Vërejtje” ndaj një prokurori të shkallës së parë.

Marrëdhëniet me Ministrinë e Brendshme, Policinë e Shtetit, administratën tatimore e doganore dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese, janë vlerësuar të një rëndësie prioritare nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme. Do të veçonim në këtë kuadër, se takimet mujore ndërmjet prokurorëve dhe zyrtarëve të policisë në nivel qendror dhe lokal në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit të

vitit 2013 dhe Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme në kuadër të forcimit të luftës kundër evazionit dhe informalitetit i nënshkruar në muajin Shtator 2015, po japin rezultate konkrete në luftën kundër kriminalitetit.

Prokurori i Përgjithshëm dhe Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit kanë shprehur angazhimin për zbatimin me efektivitet të masave të Prioritetit 3 të Udhërrëfyesit të Bashkimit Europian për Shqipërinë nëpërmjet një memorandumi bashkëpunimi, që synon analizën e të dhënave të rasteve të korrupsionit, përmirësimin e cilësisë së statistikave kundër korrupsionit dhe në planin parandalues, analizimin e prirjeve të korrupsionit dhe efektivitetit të masave kundër korrupsionit nëpërmjet shqyrtimit të një sistemi të unifikuar dhe kompjuterizuar të mbledhjes së të dhënave për rastet e korrupsionit.

Track record dhe statistikat e harmonizuara

Në zbatim të masave të prioriteteve 3 dhe 4 të udhërrëfyesit dhe të konkluzioneve të dialogut të nivelit të lartë Shqipëri BE – mbi 5 prioritetet, Prokuroria ka koordinuar e bashkëpunuar me institucionet e tjera shqiptare për krijimin e një historiku të hetimit e dënimit të rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Në muajin korrik 2015 u raportuan të dhëna (*track record*) për rastet e korrupsionit të nëpunësve të lartë shtetërorë e të zgjedhurve vendorë, rastet e korrupsionit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë si dhe të krimit të organizuar, për periudhën 2010 deri 2014. Po kështu u raportuan edhe statistikat e harmonizuara të gjashtë mujorit të parë 2015, për veprat penale të korrupsionit, krimit ekonomik, krimit të organizuar dhe krimeve të tjera të rënda. Pas takimit të Shtatorit 2015 dhe konkluzioneve përkatëse u kërkua krijimi i *track record* edhe për veprat penale në fushën e deklarimit dhe fshehjes së pasurisë. Prokuroria ka krijuar historikun e rasteve të hetimit të korrupsionit, krimit të organizuar dhe deklarimit të pasurive dhe ka përgatitur e përcjellë pranë strukturave përkatëse edhe raportimin për vitin 2015.

Raporti me Institucionet e Pavarura

Duke vlerësuar rëndësinë e veçantë të procesit të Zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore, në muajin Maj, Prokuroria e Përgjithshme dhe Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi. Prokuroria siguroi hetimin me përparësi të veprave penale në fushën e zgjedhjeve.

Prokuroria Shqiptare ka vijuar të zhvillojë raporte korrekte institucionale me Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Gjatë vitit 2015, në bazë të procedimeve penale të regjistruara, prokuroria i është drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë për lejimin e arrestimit për dy gjyqtarë. Këto kërkesa, në përputhje me ligjin, janë miratuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, duke krijuar kushtet e nevojshme procedurale për vijimin e procesit.


Marrëdhëniet me Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Kontrollit të Interesave, kanë qenë orientuar në zbatim të ligjit dhe memorandumeve të bashkëpunimit. Gjatë vitit 2015, këto institucione kanë qenë referuese për një numër të konsiderueshëm veprash penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit.

II. ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT, TË DHËNA PËR NUMRIN, LLOJET, SHTRIRJEN TERRITORIALE DHE FORMATE KRIMINALITETIT

2.1 VOLUMI I PUNËS NË HETIM PËR VITIN 2015¹

Gjatë vitit 2015, në organin e prokurorisë janë trajtuar 58529² materiale kallzuese që përbën një rritje prej 2,2 % në krahasim me vitin 2014. Janë ndjekur gjithsej 44077 procedime penale, që përbëjnë një rritje prej 0,6 % në krahasim me vitin 2014, nga të cilat 32497 janë procedime penale të regjistruara, me një ulje prej 4 % në krahasim me vitin 2014 dhe 878 procedime penale të rifilluara, që tregon rritje prej 53 % në krahasim me vitin 2014. Janë mbartur nga viti 2014, 10702 procedime penale me një rritje prej 14 % krahasuar me procedimet e mbartura në vitin 2014. Është vendosur mosfillimi për 14452 referime dhe kallzime penale, që do të thotë një rritje prej 8 % në krahasim me vitin 2014.

Volumi i punës në hetim i organit të prokurorisë për vitin 2015 paraqitet si vijon:




¹ Procedimi penal nuk njësohet me veprë penale, pasi:

- 1- Sistemi statistikor i prokurorisë regjistron të dhëna **për veprën penale më të rëndë**, pavarësisht se mund të jenë kryer disa vepra penale.
- 2- Në bazë të nenit 79 e 93 të Kodit të Procedurës Penale prokurori vendos bashkimin ose ndarjen e procedimeve.

² Tek kjo shifër e materialeve të trajtuara përfshihen: procedimet e mbartura nga viti 2014; procedimet e reja të regjistruara gjatë vitit 2015 për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal dhe Kodin Penal Ushtarak; procedimet e rifilluara gjatë vitit 2015 si rezultat i shfuqizimeve nga Prokuroria e Përgjithshme, gjykatat dhe nga drejtuesit e prokurorive për shkak të zbulimit të provave të reja; si dhe vendimet e mosfillimit të marra gjatë vitit 2015.

Më poshtë paraqitet në mënyrë grafike volumi i punës i prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë, prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe Prokurorisë së Përgjithshme³, për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014:



2.2 ÇËSHTJE TË PËRFAQËSUARA NË GJYKATË

Gjatë vitit 2015 nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë është ngritur dhe përfaqësuar akuza në gjykatë në emër të shtetit shqiptar për 14667 procedime penale (ritje prej 7,7 % në krahasim me vitin 2014) me 16941 të pandehur përkundrejt 15833 të pandehur në vitin 2014 (ritje prej 7 % në krahasim me vitin 2014). Gjithashtu, janë paraqitur në gjykatë 17591 kërkesa për caktimin e masave të sigurimit personal.

Nga prokuroritë pranë gjykatave të apelit është përfaqësuar akuza në emër të shtetit shqiptar për 5322 çështje themeli (ritje prej 34 % në krahasim me vitin 2014) dhe 3890 raste për masat e sigurimit personal (ritje prej 5,6 % në krahasim me vitin 2014).

Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme kanë përfaqësuar akuzën në emër të shtetit shqiptar pranë Gjykatës së Lartë për 205 gjykime themeli, (nga këto 4 çështje të juridiksionit fillestar), 2 gjykime në Kolegjet e Bashkuara, 30 masa sigurimi personal dhe në cilësinë e subjektit të interesuar në mbrojtje të interesave të shtetit dhe të individëve pranë Gjykatës Kushtetuese për 11 çështje.

Këto të dhëna të shprehura në përqindje paraqiten në grafikun e mëposhtëm:

³ Në shifrën përkatëse përfshihet vetëm numri i çështjeve të përfaqësuara në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese. Ndërkohë prokurorët e drejtorive të hetimit për vitin 2015, kanë shqyrtuar 1380 praktika, ndërsa prokurorët e drejtorisë së inspektimit kanë shqyrtuar 2749 praktika.




2.3 TREGUESIT KRYESORË TË PUNËS SË PROKURORISË NË PESË VITET E FUNDIT

Procedime të regjistruara

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2011 janë regjistruar 19726 procedime penale, në vitin 2012 janë regjistruar 22079 procedime penale që do të thotë rritje prej 11,9 % në krahasim me vitin 2011, në vitin 2013 janë regjistruar 27677 procedime penale që do të thotë rritje prej 25 % në krahasim me vitin 2012, në vitin 2014 janë regjistruar 33894 procedime penale që do të thotë rritje prej 22 % në krahasim me vitin 2013, dhe në vitin 2015 janë regjistruar 32497 procedime penale që do të thotë ulje prej 4 % në krahasim me vitin 2014.


Më poshtë paraqiten në mënyrë grafike procedimet penale të regjistruara në pesë vitet e fundit nga organi i prokurorisë:



Procedime në ndjekje

Në vitin 2011 rezultojnë 24975 procedime në ndjekje penale, në vitin 2012 rezultojnë 27626 procedime në ndjekje penale, që do të thotë rritje prej 10,6 % në krahasim me vitin 2011, në vitin 2013 rezultojnë 33761 procedime në ndjekje penale që do të thotë rritje prej 22 % në krahasim me vitin 2012, në vitin 2014 rezultojnë 43827 procedime në ndjekje penale që do të thotë rritje prej 30 % në krahasim me vitin 2013 dhe në vitin 2015 rezultojnë 44077 procedime në ndjekje penale që do të thotë rritje prej 0,6 % në krahasim me vitin 2014.


Më poshtë paraqiten në mënyrë grafike procedimet në ndjekje penale nga organi i prokurorisë në pesë vitet e fundit:



Ndjekja penale në bazë të Kodit Penal Ushtarak

Pesha specifike që zënë procedimet penale të regjistruara në bazë të Kodit Penal Ushtarak në numrin total të procedimeve penale të regjistruara në prokurori gjatë vitit 2015 është 0,1 %.


Grafiku në vijim paraqet të dhënat e volumit të punës në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës, për veprat penale në fushën e zbatimit të Kodit Penal Ushtarak.



Siç vërehet nga grafiku, në vitin 2015, janë regjistruar 45 procedime penale në bazë të Kodit Penal Ushtarak, janë marrë 13 vendime pushimi nga prokurori dhe janë mbartur 9 procedime penale.

Gjatë vitit 2015 nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë është ngritur dhe përfaqësuar akuza në gjykatë në emër të shtetit shqiptar për 32 procedime penale në bazë të Kodit Penal Ushtarak, me 35 të pandehur.

Procedimet penale janë regjistruar për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal Ushtarak që paraqiten në grafikun në vijim:



Procedime penale të regjistruara për veprat penale ushtarake sipas prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë për vitin 2015:

Në prokurorinë e shkallës së parë **Berat** janë regjistruar 2 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë **Durrës** janë regjistruar 4 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë **Elbasan** janë regjistruar 2 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë **Shkodër** janë regjistruar 8 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë **Tiranë** janë regjistruar 26 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë **Vlorë** janë regjistruar 3 procedime penale;

Në vijim të dhënave lidhen me vepra penale të parashikuara në Kodin Penal, ligji nr.7895/1995 i ndryshuar.

Çështje të përfunduara

Në lidhje me **çështjet e përfunduara**⁴, të dhënat statistikore tregojnë se në vitin 2013 ka patur një rritje prej 9 % të çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2012, në vitin 2014 ka patur një rritje prej 36 % të çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2013 dhe në vitin 2015 rezultojnë një rritje prej 5,6 % e çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2014.

Në lidhje me **çështjet e pushuara**, në vitin 2013 rezultojnë një ulje prej 12 % e çështjeve të pushuara në krahasim me vitin 2012, në vitin 2014 rezultojnë një rritje prej 35 % e çështjeve të

⁴ Në këtë tregues përveç çështjeve të pushuara, pezulluara dhe dërguar gjyqit mbledhen edhe çështjet e transferuara.


pushuara në krahasim me vitin 2013 dhe në vitin 2015 rezulton një rritje prej 2 % e çështjeve të pushuara në krahasim me vitin 2014.

Në lidhje me **çështjet e pezulluara**, në vitin 2013 rezulton një rritje prej 21 % e çështjeve të pezulluara në krahasim me vitin 2014, në vitin 2014 rezulton një rritje prej 16 % e çështjeve të pezulluara në krahasim me vitin 2013 dhe në vitin 2015 rezulton një rritje prej 4 % e çështjeve të pezulluara në krahasim me vitin 2014.


Në lidhje me **çështjet e dërguara në gjyq**, në vitin 2013 rezulton një rritje prej 12 % e çështjeve të dërguara në gjyq në krahasim me vitin 2012, në vitin 2014 rezulton një rritje prej 66 % e çështjeve të dërguara në gjyq në krahasim me vitin 2013 dhe në vitin 2015 rezulton një rritje prej 7,7 % e çështjeve të dërguara në gjyq në krahasim me vitin 2014.

Lidhur me numrin e të pandehurve të dërguar në gjyq vërehet se në vitin 2013 ky tregues është rritur 6,6 %, në vitin 2014 ky tregues është rritur 58,5 % krahasuar me vitin 2013 dhe në vitin 2015 numri i të pandehurve dërguar në gjyq është rritur 7 % krahasuar me vitin 2014.

Më poshtë paraqiten në mënyrë grafike të dhënat e tre viteve të fundit:



Më poshtë paraqiten të dhëna në **lidhje me të pandehurit** sipas mënyrës së përfundimit të ndjekjes penale në hetimet paraprake:




Vendimarrja e gjykatës

Vendi që zënë vendimet e gjykatës për **pushimin e çështjeve**, përkundrejt numrit total të çështjeve të dërguara në gjyq rezulton të jetë 3,4 %, në vitin 2014 numri i çështjeve të pushuara nga gjykata përbën 6,7 % të çështjeve të dërguara gjyqit dhe në vitin 2015 ky tregues përbën 2,3 % të çështjeve të dërguara në gjyq.

Në lidhje me **pushimin e akuzës** për të pandehurit, dinamika në tre vitet e fundit është e tillë që në vitin 2013 vetëm për 0,15 % të numrit të akuzave të ngritura në gjykatë është vendosur pushimi i akuzës, në vitin 2014 është vendosur pushimi i akuzës për 0,37 % të akuzave të ngritura, ndërsa në vitin 2015 është vendosur pushimi i akuzës për 0,08 % të akuzave të ngritura.

Në lidhje me **vendimet e gjykatës për pafajësinë**, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 nga totali i të pandehurve të dërguar në gjyq 2,38 % kanë marrë pafajësi me vendim gjykate, në vitin 2014 është dhënë fajësi për 1,7 % të të pandehurve të dërguar në gjyq ndërsa në vitin 2015 është dhënë pafajësi për 2,47 % të të pandehurve të dërguar në gjyq.


Më poshtë paraqiten të dhëna në lidhje me të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë nga ana e organit të prokurorisë dhe vendimet e gjykatës në lidhje me pafajësinë në tre vite, 2013-2015:



Pezullimet


Mbështetur në parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, prokuroria është organi kompetent për të vendosur pezullimin e hetimeve kur nuk njihet autori i veprës penale ose kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm. Pezullimi i hetimeve vendoset pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore dhe nga ana tjetër hetimi i pezulluar mund të rifillojë me vendimin e prokurorit. Ky tregues për vitin 2015 përbën 36,6 % të procedimeve për të cilat ka përfunduar hetimi.

Grafiku në vijim paraqet të dhënat për 2013-2015:



Në lidhje me procedimet e pezulluara nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 ka rritje me 21,8 %, në vitin 2014 numri i procedimeve të pezulluara është rritur me 16,2 %, ndërsa në vitin 2015 numri i procedimeve të pezulluara është rritur me 4,2 %.


Për vitin 2015, procedimet penale të pezulluara për moszbulim të autorit sipas grup veprave penale paraqiten grafikisht si më poshtë (në grafik janë dhënë vetëm procedimet e pezulluara për grup veprat penale numri i të cilave është mbi 20):



Mosfillimet

Në lidhje me referimet dhe kallëzimet për të cilat është vendosur mosfillimi, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 është vendosur mosfillimi për 8414 njoftime për vepra penale, në vitin 2014 të dhënat statistikore tregojnë se është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 13416 referime dhe kallëzime kundrejt 8414 vendimeve të marra në vitin 2013 ose rritje prej 59 %, dhe në vitin 2015 të dhënat statistikore tregojnë se është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 14452 referime dhe kallëzime ose një rritje prej 8 % kundrejt vendimeve të mosfillimit të marra në vitin 2014.

Të dhëna të detajuara gjenden në grafikun e mëposhtëm:



2.4 PROCEDIME PENALE TË REGJISTRUARA SIPAS PROKURORIVE PRANË GJYKATAVE TË SHKALLËS SË PARË PËR VITIN 2015⁵

Në prokurorinë e shkallës së parë **Berat** janë regjistruar 1053 procedime penale, që do të thotë ulje prej 20,6 % në krahasim me vitin 2014;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Dibër** janë regjistruar 496 procedime penale, që do të thotë ulje prej 21 % në krahasim me vitin 2014;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Durrës** janë regjistruar 2337 procedime penale, që do të thotë ulje prej 3,6 % në krahasim me vitin 2014;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Elbasan** janë regjistruar 2704 procedime penale, që do të thotë ulje prej 14,7 % në krahasim me vitin 2014;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Fier** janë regjistruar 1782 procedime penale, që do të thotë ulje prej 3,6 % në krahasim me vitin 2014;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Gjirokastrë** janë regjistruar 859 procedime penale, që do të thotë ulje prej 8 % në krahasim me vitin 2014;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Kavajë** janë regjistruar 478 procedime penale, që do të thotë ulje prej 28 % në krahasim me vitin 2014;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Korçë** janë regjistruar 1513 procedime penale, që do të thotë ulje prej 10 % në krahasim me vitin 2014;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Krujë** janë regjistruar 640 procedime penale, që do të thotë ulje prej 15 % në krahasim me vitin 2014;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Kukës** janë regjistruar 511 procedime penale, që do të thotë ulje prej 24 % në krahasim me vitin 2014;

⁵ Në total 32452 procedime penale për vepra penale të parashikuara në Kodin Penal (civil).

Në prokurorinë e shkallës së parë **Kurbin** janë regjistruar 496 procedime penale, që do të thotë ulje prej 9 % në krahasim me vitin 2014;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Lezhë** janë regjistruar 1198 procedime penale, që do të thotë ulje prej 16,8 % në krahasim me vitin 2014;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Lushnje** janë regjistruar 965 procedime penale, që do të thotë rritje prej 1 % në krahasim me vitin 2014;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Mat** janë regjistruar 304 procedime penale, që do të thotë ulje prej 3,5 % në krahasim me vitin 2014;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Përmet** janë regjistruar 134 procedime penale që do të thotë rritje prej 23 % në krahasim me vitin 2014;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Pogradec** janë regjistruar 426 procedime penale, që do të thotë ulje prej 5,7 % në krahasim me vitin 2014;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Pukë** janë regjistruar 224 procedime penale, që do të thotë ulje prej 13,5 % në krahasim me vitin 2014;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Sarandë** janë regjistruar 879 procedime penale, që do të thotë ulje prej 4 % në krahasim me vitin 2014;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Shkodër** janë regjistruar 2309 procedime penale, që do të thotë rritje prej 4,4 % në krahasim me vitin 2014;


Në prokurorinë e shkallës së parë **Tiranë** që është prokuroria me ngarkesën më të madhe në vend, janë regjistruar 9955 procedime penale, që do të thotë rritje prej 3 % në krahasim me vitin 2014;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Tropojë** janë regjistruar 349 procedime penale që do të thotë rritje prej 25 % në krahasim me vitin 2014;

Në prokurorinë e shkallës së parë **Vlorë** janë regjistruar 2385 procedime penale, që do të thotë rritje prej 4,4 % në krahasim me vitin 2014;


Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë për **Krime të Rënda** janë regjistruar 455 procedime penale, që do të thotë rritje prej 45 % në krahasim me vitin 2014;

Sa më sipër paraqitet grafikisht në vijim:



Siç vërehet nga të dhënat, numrin më të madh të procedimeve e ka regjistruar prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë me 31 % të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Elbasan ka regjistruar 8 % të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Vlorë, Durrës e Shkodër kanë regjistruar respektivisht 7 % të numrit total të procedimeve të regjistruara dhe prokuroritë e shkallës së parë Korçë e Fier kanë regjistruar respektivisht 5 % të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi.

Më poshtë paraqiten të dhënat në përqindje mbi procedimet penale të regjistruara sipas prokurorive të shkallës së parë në vitin 2015⁶:



⁶ Nuk është përfshirë prokuroria për krime të rënda e cila ka regjistruar 1,4 % të procedimeve.

2.5 KOEFICIENTËT E KRIMINALITETIT PËR 100.000 BANORË BAZUAR NË SISTEMIN STATISTIKOR TË PROKURORISË

Koeficienti i kriminalitetit për procedimet penale të regjistruara⁷, për 100.000 banorë⁸ në vitin 2015 (bazuar në sistemin statistikor të Prokurorisë) është 1122, ndërsa në vitin 2014 ka qenë 1169. Në lidhje me koeficientët e kriminalitetit për 100.000 banorë, sipas qarqeve të dhënat statistikore rezultojnë si më poshtë:




⁷ Nuk përfshihet shifra e “errët” e krimit (vepra penale të cilat nuk raportohen dhe mbeten të panjohura për organet e zbatimit të ligjit).

⁸ <http://www.instat.gov.al/al/themes/popullsia.aspx?tab=tabs-5>

Në qarkun Berat që përfshin prokurorinë e shkallës së parë Berat koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2015 është 738; në qarkun Dibër që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Dibër dhe Mat, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2015 është 586; në qarkun Durrës që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Durrës dhe Krujë, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2015 është 1087; në qarkun Elbasan që përfshin prokurorinë e shkallës së parë Elbasan koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2015 është 897; në qarkun Fier që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Fier dhe Lushnje koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2015 është 872; në qarkun Gjirokastrë që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastrë dhe Përmet koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2015 është 1375; në qarkun Korçë që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Korçë dhe Pogradec koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2015 është 865; në qarkun Kukës që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Kukës dhe Tropojë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2015 është 1006; në qarkun Lezhë që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Lezhë dhe Kurbin koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2015 është 1238; në qarkun Shkodër që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Shkodër dhe Pukë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2015 është 1159; në qarkun Tiranë që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Tiranë dhe Kavajë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2015 është 1304 dhe në qarkun Vlorë që përfshin prokuroritë e shkallës së parë Vlorë dhe Sarandë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2015 është 1783.

Siç rezulton nga të dhënat, përqindjen më të ulët të kriminalitetit e ka qarku Dibër ndërsa përqindjen më të lartë qarku Vlorë. Renditja sipas prefekturave paraqitet grafikisht në vijim:



2.6 TË DHËNA NË LIDHJE ME NJOFTIMET PËR VEPRAT PENALE

Bazuar në të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 janë **filluar kryesisht** 160 procedime penale nga ana e prokurorisë.

Kallëzime nga nëpunësit publikë: në vitin 2015 rezulton të kenë ardhur në prokurori 1181 kallëzime, që do të thotë ulje prej 7,4 % në krahasim me vitin 2014, në vitin 2014 rezulton të kenë ardhur në prokurori 1275 kallëzime, që do të thotë rritje prej 17 % në krahasim me vitin 2013, në vitin 2013 rezulton të jenë 1087 kallëzime, që do të thotë ulje prej 4,1 % në krahasim me vitin 2012, ndërsa për vitin 2012 rezulton të kenë ardhur 1134 kallëzime, që do të thotë rritje prej 60,4 % në krahasim me vitin 2011.

Kallëzime nga personeli mjekësor: në vitin 2015 rezulton të ketë ardhur në prokurori 1 kallëzim, që do të thotë ulje kundrejt 8 kallëzimeve të ardhura në vitin 2014, në vitin 2014 numri i kallëzimeve nga personi mjekësor rezulton me rritje prej 2,6 herë në krahasim me vitin 2013 gjatë të cilit rezultojnë 3 kallëzime nga personeli mjekësor, për vitin 2012 rezultojnë 4 kallëzime penale dhe për vitin 2011 rezultojnë 3 kallëzime penale.

Kallëzime nga shtetasit: në vitin 2015 rezulton të kenë ardhur në prokurori 2070 kallëzime, që do të thotë ulje prej 14,5 % në krahasim me vitin 2014, në vitin 2014 rezulton të kenë ardhur në prokurori 2420 kallëzime, që do të thotë rritje prej 14 % në krahasim me vitin 2013, në vitin 2013 rezultojnë 2118 kallëzime që do të thotë ulje prej 15,41 % në krahasim me vitin 2012, në vitin 2012 rezultojnë 2504 kallëzime që do të thotë rritje prej 39,03 % në krahasim me vitin 2011.

Kallëzime për vepra penale që ndiqen mbi ankim: në vitin 2015 rezulton të kenë ardhur në prokurori 324 kallëzime për vepra penale që ndiqen mbi ankim, që do të thotë ulje prej 5 % në krahasim me vitin 2014, në vitin 2014 rezulton të kenë ardhur në prokurori 341 kallëzime, që do të thotë rritje prej 82 % në krahasim me vitin 2013, në vitin 2013 rezultojnë 187 kallëzime që do të thotë ulje prej 62 % në krahasim me vitin 2012, në vitin 2012 rezultojnë 500 ankime që do të thotë rritje prej 34,05 % në krahasim me vitin 2011.

Gjatë vitit 2015 është marrë njoftim për **5535 ngjarje** që përbën një ulje prej 26 % krahasuar me vitin 2014, në vitin 2014 është marrë njoftim për 7545 ngjarje që përbën një rritje prej 36 % krahasuar me vitin 2013, në vitin 2013 është marrë njoftim për 5565 ngjarje, që do të thotë rritje 17,9 % në krahasim me vitin 2012, gjatë vitit 2012 është marrë njoftim për 4717 ngjarje, që do të thotë rritje prej 61,87% në krahasim me vitin 2011.

Gjatë vitit 2015 janë marrë **33306 referime nga Policia e Shtetit dhe Polici të tjera** që do të thotë rritje prej 4 % në krahasim me vitin 2014, gjatë vitit 2014 janë marrë 31949 referime, që do

të thotë rritje prej 32 % në krahasim me vitin 2013, në vitin 2013 janë marrë 24215 referime, që do të thotë rritje prej 27 % në krahasim me vitin 2012, gjatë vitit 2012 janë marrë 19038 referime, që do të thotë rritje prej 28 % në krahasim me vitin 2011.


2.7 TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE PENALE TË FORMËS SË PRERË

Për të gjitha vendimet gjyqësore të formës së prerë të marra gjatë vitit 2015, organi i prokurorisë ka urdhëruar ekzekutimin.

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 urdhrat për ekzekutim të dënimeve kryesore me burgim, gjobë e dënime plotësuese, zënë 57 % të totalit të urdhrave për ekzekutim të lëshuara nga prokurori, ndërsa urdhrat për ekzekutim të dënimeve alternative zënë 43 % të totalit të urdhrave për ekzekutim të lëshuara nga prokurori. Treguesit e mësipërm krahasuar me vitin 2014 rezultojnë me rritje përkatësisht, urdhrat e ekzekutimit për dënimet me burgim të përjetshëm, me burgim, me gjobë dhe dënime plotësuese kanë pësuar një rritje prej 27,6 %, ndërsa dënimet alternative kanë pësuar një rritje prej 17 %.

Më konkretisht, gjatë vitit 2015 janë ekzekutuar 6067 vendime penale të formës së prerë, ndërsa kanë mbetur pa u ekzekutuar gjatë vitit 2015, 6466 vendime. Numri i vendimeve sipas llojit të tyre të mbetura pa ekzekutuar është 1223 vendime me burgim, 2316 vendime për dënimin me gjobë, 103 dënime plotësuese dhe 2820 dënime alternative.


Sa më sipër paraqitet në grafikun në vijim:




2.8 KRIMINALITETI SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL

Raporti krime dhe kundërvajtje

Më poshtë paraqitet analiza e strukturës së kriminalitetit për vitin 2015, sipas ndarjes në krime dhe kundërvajtje penale duke përfshirë të dhëna që lidhen me procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë sipas veprave penale të parashikuara nga Kodi Penal.



Procedime të regjistruara sipas seksioneve të Kodit Penal për vitet 2014-2015:



Raporti i grup veprave me numrin e procedimeve të regjistruara në prokurori, sipas strukturës së Kodit Penal:


Nga analiza e të dhënave statistikore rezulton se:

- Raporti që zënë **krimet kundër jetës të kryera me dashje**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 1,46 %⁹;
- Raporti që zënë **krimet kundër jetës të kryera me pakujdesi** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 0,03 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër shëndetit të kryera me dashje** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 2,5 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër shëndetit të kryera me pakujdesi** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 0,009 %;
- Raporti që zënë **veprat penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 0,34 %;
- Raporti që zënë **krimet seksuale** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 0,4 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër lirisë së personit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 0,55 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 0,81 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 4,16 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër lirisë së besimit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 0,006 %;
- Raporti që zënë **vjedhja e pasurisë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 39,50 %;
- Raporti që zënë **mashttrimet** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 3,30 %;
- Raporti që zënë **shkatërrimi i pronës** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 2,96 %;
- Raporti që zënë **veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 0,10 %;
- Raporti që zënë **veprat penale në lidhje me veprimtarinë bankare dhe financiare** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 0,21 %;
- Raporti që zënë **krimet në fushën e doganave** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 0,72 %;

⁹ Përfshirë vrasjet e mbetura në tentativë.

- Raporti që zënë **veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 1,75 %;
- Raporti që zënë **falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 0,41 %;
- Raporti që zënë **falsifikimi i dokumenteve** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 3,04 %;
- Raporti që zënë **veprat penale në fushën e falimentimit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 0 %;
- Raporti që zënë **zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 1,05 %;
- Raporti që zënë **veprat penale që cënojnë regjimin juridik të tokës** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 3,83 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër mjedisit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 0,73 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër pavarësisë dhe integritetit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 0 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër rendit kushtetues** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 0,006 %;
- Raporti që zënë **krimet që cënojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 0,003 %;
- Raporti që zënë **veprat me qëllime terroriste** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 0,04 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 2,28 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 2,50 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 24,43 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 1,32 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër drejtësisë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 1,41 %;
- Raporti që zënë **veprat penale që prekin zgjedhjet e lira**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 0,06 %;
- Raporti që zënë **veprat penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 0,05 %;

Këto të dhëna paraqiten grafikiisht si më poshtë:



Në vijim do të analizohet në mënyrë më të detajuar secili nga seksionet e Kodit Penal:

2.9 ANALIZA E VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL¹⁰

KRIME KUNDËR JETËS TË KRYERA ME DASHJE

Pesha specifike¹¹ që zë ky grup veprash penale për vitin 2015 është 1,3 % e numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, ndërsa për vitin 2014 ky grup veprash përbënte 1,6 % të totalit të procedimeve. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun II, Seksioni I, “Krime kundër jetës të kryera me dashje”.

| KRIME KUNDËR JETËS ME DASHJE | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|---|----------------|----------------------|-------------------|----------------------|---------------|----------------|----------------------|---------------------------------|----------------------|---------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pandenuar | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj. ¹² | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pandenuar |
| Neni 76 Vrasja ¹³ | 46 | 17 | 30 | 20 | 27 | 38 | 17 | 18 | 17 | 30 |
| Neni 77 Vrasja për një krim tjetër | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 1 | 2 | 0 |
| Neni 78 Vrasja me paramendim | 59 | 22 | 40 | 28 | 30 | 31 | 22 | 23 | 30 | 24 |
| Neni 78/a Vrasje për gjakmarrje | 8 | 3 | 7 | 4 | 2 | 3 | 3 | 4 | 4 | 4 |
| Neni 79 Vrasja në rrethana cilësuese | 50 | 25 | 43 | 33 | 37 | 28 | 17 | 29 | 21 | 30 |
| Neni 79/a Vrasja e funksionarëve publikë | 5 | 3 | 1 | 4 | 0 | 4 | 0 | 1 | 0 | 1 |
| Neni 79/b Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit | 5 | 1 | 6 | 2 | 0 | 7 | 2 | 24 | 2 | 2 |
| Neni 79/c Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare | 31 | 28 | 24 | 31 | 17 | 28 | 22 | 26 | 22 | 22 |
| Neni 80 | 6 | 2 | 5 | 4 | 1 | 3 | 1 | 4 | 4 | 4 |
| Neni 81 Vrasja e foshnjës | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 | 1 | 1 | 0 | 1 | 1 |
| Neni 82 Vrasja në tronditje psikike | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 |

¹⁰ Në statistikat e të pandehurve të regjistruar, dërguar në gjykim dhe /ose dënua, shifrat në tabelat përkatëse përfshijnë edhe raste të mbartura nga vite të tjera.

¹¹ Këtu e në vijim “Pesha specifike” është llogaritur si raport i grupveprave të renditura në tabelë me numrin total të procedimeve. Për shkak të grupimit të veprave jo gjithmonë sipas strukturës së Kodit Penal, por edhe sipas fushës, mund të mos ketë përputhje midis këtij treguesi dhe raportit të grup veprave me numrin e procedimeve të regjistruara në prokurori, sipas strukturës së Kodit Penal.

¹² Ky tregues është totali i personave në hetim dhe të pandehur të regjistruar në organin e prokurorisë.


¹³ Nuk janë përfshirë vrasjet e mbetura në tentativë (49 procedime regjistruar dhe 61 të pandehur regjistruar).

| | | | | | | | | | | |
|--|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|
| Neni 83 Vrasja e kryer në kapërcim mbrojtjes nevojshme | 1 | 2 | 0 | 3 | 2 | 0 | 1 | 0 | 1 | 2 |
| Neni 83/a Kanosja për hakmarrje/ gjakmarrje | 16 | 1 | 2 | 1 | 3 | 4 | 1 | 1 | 1 | 1 |
| Neni 83/b Nxitja për gjakmarrje | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 84 Kanosja | 307 | 108 | 186 | 117 | 64 | 274 | 108 | 154 | 121 | 96 |
| Totali | 539 | 214 | 347 | 249 | 185 | 423 | 197 | 285 | 227 | 217 |

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore të paraqitura në tabelë, rezulton se në vitin 2015 ka një ulje prej 21,5 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Krime Kundër Jetës të Kryera me Dashje” në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi një ulje prej 8 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Edhe në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re ulje përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 18 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 9 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 17 % përkundrejt vitit 2014.

Grafikisht tendenca e krimeve kundër jetës të kryera me dashje për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TE PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, moshja, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Në lidhje me gjininë e të pandehurve vihet re se 97,1 % e tyre janë meshkuj (nga të cilët 3,35 % janë të mitur) dhe vetëm 2,9 % janë femra (ndër të cilat nuk rezultojnë të mitura).

Në lidhje me arsimimin e të pandehurve, rezulton se për këto grup veprash penale 1,8 % e të pandehurve të regjistruar janë me arsim të lartë, 37,6 % e të pandehurve të regjistruar janë me arsim të mesëm dhe pjesa tjetër e të pandehurve rezultojnë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjendjes shoqërore, nga të dhënat statistikore rezulton se rreth 67,9 % e të pandehurve janë të papunë, rreth 30,9 % e të pandehurve janë të punësuar në sektorin privat dhe vetëm më pak se 1,2 % e tyre janë nëpunës shtetërorë.

Rezulton se rreth 52,6 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 47,4 % prej tyre në fshat. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në qytet.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se më pak se 1 % e tyre janë përsëritës për të njëjtën veprë penale, 5,7 % përsëritës për vepra të tjera dhe 94,2 % janë të padënuar më parë.

Bazuar në sa më sipër, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e këtyre veprave penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.


VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Vrasja me dashje


Të dhënat statistikore tregojnë se në vitin 2015, ka tendencë në ulje prej 17 % të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal “Vrasja me dashje”, në krahasim me vitin 2014.

Ndërsa lidhur me peshën specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Krimet kundër jetës të kryera me dashje” për vitin 2015 është 9 % ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 8,5 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rretheve për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal “Vrasja me dashje” për vitin 2015:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara është në prokuroritë e shkallës së parë Tiranë, Elbasan e Korçë, nga 6 procedime penale ose 16 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Fier, Kurbin e Shkodër janë regjistruar nga 3 procedime që përbëjnë 8 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Berat, Gjirokastrë, Krujë e

Sarandë janë regjistruar përkatësisht 2 procedime penale ose 5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Durrës e Lezhë është regjistruar nga 1 procedim penal ose 2,6 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Kavajë, Kukës, Lushnje, Mat, Përmet, Pogradec, Pukë, Tropojë e Vlorë nuk kanë regjistruar asnjë procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal “Vrasja me dashje” gjatë vitit 2015.

Vrasja me paramendim


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Klime kundër jetës të kryera me dashje” për vitin 2015 është 7 %, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 11 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011 - 2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015, ka një ulje prej 47 % të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 78 “Vrasja me paramendim” i Kodit Penal, krahasuar me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me numrin e procedimeve penale të regjistruara në vitet 2014 – 2015, sipas prokurorive të shkallës së parë për veprën penale të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal “Vrasja me paramendim”:



Lidhur me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre në vitin 2015 grafiku në vijim paraqet të dhënat në përqindje sipas prokurorive:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të vrasjes me paramendim, është në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë që përbën 19 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Ndërkohë në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë është regjistruar 16 % e këtyre procedimeve, në prokuroritë e shkallës së parë Shkodër e Durrës janë regjistruar respektivisht nga 3 procedime që përbëjnë 10 % të procedimeve në shkallë vendi, ndërsa në prokuroritë e shkallës së parë Elbasan, Fier, Kurbin, Sarandë e Tropojë janë regjistruar respektivisht nga 2 procedime penale (e shprehur në përqindje nga 6,5 %). Prokuroritë e shkallës së parë Berat, Korçë, Kukës e Lushnje kanë regjistruar nga 1 procedim penal (e shprehur në përqindje nga 3,2 %). Prokuroritë e shkallës së parë, Dibër, Gjirokastër, Kavajë, Krujë, Lezhë, Mat, Përmet, Pogradec e Pukë nuk kanë regjistruar asnjë procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal “Vrasja me paramendim” gjatë vitit 2015.

Vrasja në rrethana të tjera cilësuese


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime kundër jetës të kryera me dashje” është 6,6 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 9 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015, ka ulje prej 44 % të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, krahasuar me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rretheve për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” në vitin 2015:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të vrasjes në rrethana të tjera cilësuese është në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë ku janë regjistruar 29 % e procedimeve për këtë veprë në shkallë vendi. Në prokuroritë e shkallës së parë Fier e Tiranë janë regjistruar 14 % e totalit të procedimeve penale. Në prokuroritë e shkallës së parë Durrës e Shkodër janë regjistruar nga 2 procedime që përbëjnë 7 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Berat, Gjirokastër, Krujë, Kurbin, Lezhë, Lushnje, Mat dhe prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda që ka në kompetencë ndjekjen penale për shkronjën “ç” të këtij neni, vrasjen ndaj kallëzuesit, dëshmitarit, të dëmtuarit ose palëve të tjera ndërgjyqëse, është regjistruar nga 1 procedim penal i shprehur në përqindje përkatësisht nga 3,6 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Ndërkaq në prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Elbasan, Kavajë, Korçë, Përmet, Pogradec, Pukë, Sarandë e Tropojë nuk është regjistruar asnjë procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” gjatë vitit 2015.

Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Krime kundër jetës të kryera me dashje” është 6,6 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 5,75 %.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 79/c i Kodit Penal “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”. Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 janë regjistruar 28 procedime penale që përbëjnë një ulje prej 9,7 % krahasuar me 31 procedime të regjistruara për vitin 2014, për veprën penale të vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare.




Kanosja

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje edhe për procedimet e regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal “Kanosja”.


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krimet kundër jetës të kryera me dashje” është 65 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 57 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 janë regjistruar 274 procedime penale që përbëjnë një ulje prej 11 % krahasuar me 307 procedime të regjistruara për vitin 2014, për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal “Kanosja”.

Të dhënat e detajuara për procedimet e regjistruara gjatë vitit 2015 në prokuroritë e shkallës së parë për veprën penale të kanosjes gjenden në mënyrë të detajuar në vijim:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të kanosjes është në prokuroritë e shkallës së parë Tiranë që përbën 23 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këtë veprë në shkallë vendi.

Në prokurorinë e shkallës së parë Fier janë regjistruar 11 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 10 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë janë regjistruar 6 % e totalit të procedimeve penale, në prokuroritë e shkallës së parë Shkodër e Berat janë regjistruar respektivisht 14 e 13 procedime që përbëjnë secila rreth 5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Kurbin janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe në prokuroritë e shkallës së parë Korçë e Durrës janë regjistruar nga 3 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2015. Prokuroritë e tjera kanë regjistruar një numër më të vogël procedimesh (më pak se 3 %) për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal “Kanosja”.

KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e II-të, Seksioni i II “Krime kundër jetës shkaktuar me pakujdesi”:

| KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|---|----------------|---------------|------------------|--------------|-----------------|----------------|---------------|-------------------|---------------|-----------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per | Nr. Pand denuar | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per | Nr. Pand denuar |
| | | | | | | | | | | |

| | | gjykim | | gjykim | | | gjykim | | gjykim | |
|-------------------------------|-----------|----------|----------|----------|----------|-----------|----------|----------|----------|-----------|
| Neni 85 Vrasja nga pakujdesia | 13 | 9 | 6 | 9 | 9 | 11 | 9 | 8 | 9 | 12 |
| Totali | 13 | 9 | 6 | 9 | 9 | 11 | 9 | 8 | 9 | 12 |

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka ulje të numrit të procedimeve të regjistruara për “Krime kundër jetës të shkaktuar me pakujdesi” me 15 % në krahasim me vitin 2014. Procedimet e dërguara për gjykim rezultojnë në të njëtin nivel si në vitin 2014, 9 procedime, ndërsa në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale vihet re një rritje nga 6 në vitin 2014 në 8 të pandehur të regjistruar në vitin 2015 dhe numri i të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit është rritur nga 9 në 12.

TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2015 në total janë 10 të pandehur në hetim ashtu si dhe në vitin 2014.

Të gjithë të pandehurit janë të moshës madhore (mbi 18 vjeç).

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 70 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 30 % me arsim të mesëm dhe asnjë me arsim të lartë.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të pandehurit për këtë grup veprash rezultojnë 42,8 % nga sektori privat dhe pjesa tjetër rezultojnë të jenë të papunë.

Rezulton se 30 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 70 % prej tyre në fshat. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në qytet.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se të gjithë të pandehurve janë të padënuar më parë.

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2015 është 2,5 % e numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, ndërsa për vitin 2014 ky grup veprash përbënte 2,7 % të totalit të procedimeve. Pra, vihet re ulje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e II-të, Seksioni i III “Vepra penale kundër shëndetit të kryera me dashje”:

| VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|--|----------------|----------------------|-------------------|----------------------|---------------|----------------|----------------------|------------------|---------------------|---------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pandenuar | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pandenuar |
| Neni 86 Tortura | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 87 Tortura me pasoja të rënda | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 88 Plagosje e rëndë me dashje | 130 | 82 | 154 | 99 | 105 | 122 | 75 | 134 | 92 | 71 |
| Neni 88/a Plagosje e rëndë në gjendje të tronditjes së fortë psikike | 3 | 4 | 3 | 5 | 6 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 |
| Neni 88/b Plagosje e rëndë në kapërcim të mbrojtjes | 2 | 3 | 3 | 4 | 2 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 |
| Neni 89 Plagosje e lehtë me dashje | 793 | 305 | 739 | 390 | 198 | 695 | 357 | 715 | 505 | 342 |
| Neni 89/a | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 90 Dëmtime të tjera | 1 | 0 | 2 | 1 | 1 | 3 | 1 | 1 | 1 | 1 |
| Totali | 930 | 394 | 901 | 499 | 312 | 822 | 434 | 851 | 599 | 418 |

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore të paraqitura në tabelë, rezulton se në vitin 2015 ka një ulje prej 11,5 % e numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra Penale Kundër Jetës të Kryera me Dashje” në krahasim me vitin 2014. Tendencë në rritje prej 10 % paraqet numri i procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Sa i përket të pandehurve, tendencë ulje prej 5,5 % paraqet në këtë grup veprash penale numri i të pandehurve të regjistruar, përkundrejt këtij totali në vitin 2014, tendencë rritje prej 20 % paraqet numri i të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit dhe numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata me 34 % përkundrejt vitit 2014.

Grafikisht tendenca e krimeve kundër shëndetit të kryera me dashje për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TE PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Në lidhje me gjininë e të pandehurve vihet re se vetëm 2,3 % e tyre janë femra dhe pjesa tjetër janë meshkuj, rreth 97,7 %. Gjithashtu, rezulton se 7,1 % e të pandehurve janë minorenë (14-18 vjeç).

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se për këto grup veprash penale janë regjistruar 2,4 % të pandehur me arsim të lartë, 32,4 % të pandehur janë me arsim të mesëm dhe pjesa tjetër e të pandehurve rezultojnë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore rezulton se rreth 71,9 % e të pandehurve janë të papunë, rreth 27,6 % e të pandehurve janë të punësuar në sektorin privat dhe më pak se 1 % e tyre janë nëpunës shtetëror.

Rezulton se 42,5 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 57,5 % prej tyre në fshat. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në qytet.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se vetëm 3,3 % prej tyre janë të dënuar për vepra të tjera penale, më pak se 1 % të dënuar për të njëjtën vepër penale, ndërsa 96,3 % janë të pa dënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Plagosja e rëndë me dashje


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime kundër shëndetit të kryera me dashje” për vitin 2015 është 14,8 %, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 14 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015, vihet re tendenca në ulje prej 6 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 88 i Kodit Penal "Plagosja e rëndë me dashje", në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me numrin e procedimeve penale të regjistruara sipas prokurorive të shkallës së parë në vitet 2014 – 2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 88 i Kodit Penal "Plagosja e rëndë me dashje":



Lidhur me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre në vitin 2015 grafiku në vijim paraqet të dhënat në përqindje sipas prokurorive:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të plagosjes së rëndë me dashje është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë që përbën 20 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këtë veprë në shkallë vendi, e në vijim, në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan që përbën 11 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë që përbën 10 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë e shkallës së parë Durrës e Shkodër që kanë regjistruar respektivisht nga 8 % të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Mat që përbën 7 % të numrit total të procedimeve, në prokuroritë e shkallës së parë Fier, Kavajë, Korçë e Pogradec që kanë regjistruar nga 4 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë e shkallës së parë Berat e Pukë që kanë regjistruar respektivisht 3 % të numrit total të procedimeve. Prokuroritë Dibër, Gjirokastër, Krujë, Kukës, Lushnje, Përmet, Sarandë e Tropojë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbëjnë më pak se 3 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, ndërkohë që prokuroria e shkallës së parë Kurbini nuk ka regjistruar asnjë procedim gjatë vitit 2015, për veprën penale të parashikuar nga neni 88 i Kodit Penal “Plagosja e rëndë me dashje”.

Plagosja e lehtë me dashje


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Kryera kundër shëndetit të kryera me dashje” për vitin 2015 është 84,5 %, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 85 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015, vihet re tendenca në ulje prej 12 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal “Plagosja e lehtë me dashje”, në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rretheve për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal “Plagosja e lehtë me dashje” për vitin 2015:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të plagosjes së lehtë me dashje është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë që përbën 27 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këtë veprë në shkallë vendi, në vijim, në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan që përbën 12 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë e shkallës së parë Durrës që përbën 11 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë e shkallës së parë Korçë që përbën 10 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë që përbën 7 % të numrit total të procedimeve, në prokuroritë e shkallës së parë Fier, Shkodër e Berat që kanë regjistruar respektivisht 4 % të numrit total të procedimeve, në prokuroritë e shkallës së parë Lushnje e Krujë që kanë regjistruar rreth 3 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Gjirokastrë, Kavajë, Kukës, Kurbin, Lezhë, Mat, Përmet, Pogradec, Pukë e Tropojë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbëjnë më të ulët se 3 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi gjatë vitit 2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal “Plagosja e lehtë me dashje”.

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e II-të, Seksioni i IV “Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia”:

| VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|--|----------------|----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|----------------|----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 91 Plagosja e rëndë nga pakujdesia | 4 | 0 | 1 | 0 | 0 | 3 | 0 | 2 | 0 | 1 |
| Neni 92 Plagosja e lehtë nga pakujdesia | 2 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali | 6 | 0 | 2 | 0 | 0 | 3 | 0 | 2 | 0 | 1 |

Sikurse vihet re edhe nga tabela, të dhënat statistikore tregojnë se numri i procedimeve penale për “Vepra Penale kundër shëndetit të shkaktuar me pakujdesi” të regjistruara në vitin 2015 është më i ulët se numri i procedimeve të regjistruara në vitin 2014, nga 6 procedime në 3. Gjatë këtij viti nuk është dërguar për gjykim asnjë procedim penal, ndërsa në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, vihet re se numri i të pandehurve të regjistruar është i njëjtë, 2 të pandehur, ndërkohë që është dhënë edhe një vendim dënimi për një të pandehur.

VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZANISË OSE MOSDHËNIA E NDIHMËS

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,3 %. Ky tregues për vitin 2014 ka qenë 0,4 %, pra vihet re ulje e tij për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në seksionin V të kreut të dytë të Kodit Penal “Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës”.


| VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZANISË OSE NGA MOSDHËNIA E NDIHMËS | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|---|----------------|----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|----------------|----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 93 Ndërprerja e shtatzanisë pa pëlqim të gruas | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 94 Ndërprerja e shtatzanisë e kryer në vende dhe nga persona të paautoriz. | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 95 Dhënia e mjeteve për ndërprerjen e shtatzanisë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 96 Mjekimi i pakujdesshëm | 37 | 5 | 6 | 6 | 4 | 37 | 9 | 6 | 13 | 12 |
| Neni 97 Mosdhënia ndihmë | 6 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 98 Mosdhënia e ndihmës nga kapiteni i anijes | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 | 0 |
| Neni 99 Shkaktimi i vetëvrasjes | 96 | 5 | 7 | 5 | 2 | 70 | 5 | 7 | 5 | 5 |
| Totali | 142 | 11 | 16 | 12 | 7 | 109 | 15 | 14 | 19 | 17 |

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një ulje prej 23 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose nga mosdhënia e ndihmës”, në krahasim me vitin 2014. Numri i procedimeve dërguar për gjykim ka pësuar rritje me 36 % në krahasim me vitin 2014, numri i të pandehurve regjistruar është ulur me 12,5 % dhe numri i të pandehurve dërguar për gjykim është rritur me 58 %. Rritje vërehet edhe në lidhje me numrin e të pandehurve të

dënuar nga gjykata nga 7 të pandehur në vitin 2014 në 17 të pandehur të dënuar në vitin 2015 (ose 2,4 herë më shumë).

Grafikisht tendenca e veprave penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2015 në total janë 29 të pandehur në hetim. Ndërsa në lidhje me të pandehurit gjatë vitit 2014 në total kanë qënë 24 të pandehur në hetim, pra kemi një rritje prej 20,8 %.

Në lidhje me gjininë e të pandehurve vihet re se 86,9 % e tyre janë meshkuj dhe pjesa tjetër janë femra, rreth 13 %.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 21,7 % e të pandehurve janë me arsim të mesëm 65,2 % e të pandehurve me arsim të lartë dhe pjesa tjetër me arsim deri në 9 vjeçar.

Rezulton se 87 % e të pandehurve e kanë vendbanimin në qytet ndërsa 13 % prej tyre në fshat. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në qytet.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë të gjithë të pandehurit janë të padënuar më parë.


VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Mjekimi i pakujdesshëm

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia” është 34 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 26 %.

Të dhënat statistikore tregojnë se numri i procedimeve penale të regjistruara në vitin 2015 për këtë vepër penale është i njëjtë me atë të regjistruar në vitin 2014.


Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Shkaktimi i vetëvrasjes

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia” është 64 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 67,6 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në ulje prej 27 % e procedimeve të regjistruara në vitin 2015, për veprën penale të parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal “Shkaktimi i vetëvrasjes”, në krahasim me vitin 2014.

KRIME SEKSUALE

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2015 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 0,3 %, ndërkohë që për vitin 2014 ka qenë 0,26 %. Pra vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e VI të Kodit Penal “Krime Seksuale”:


| KRIME SEKSUALE | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|---|----------------|----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|----------------|----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 100 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur | 20 | 14 | 19 | 17 | 21 | 19 | 16 | 17 | 17 | 15 |
| Neni 101 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës me 14-18 vjeç | 19 | 10 | 19 | 11 | 3 | 19 | 9 | 21 | 9 | 3 |
| Neni 102 Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura | 21 | 3 | 13 | 5 | 5 | 22 | 5 | 22 | 5 | 2 |
| Neni 102/a Marrëdhënie homoseksuale me dhunë me të rritur | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 |
| Neni 103 Marrëdhënie seksuale | 2 | 1 | 1 | 1 | 1 | 8 | 1 | 5 | 1 | 0 |

| | | | | | | | | | | |
|--|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|------------|-----------|-----------|-----------|-----------|
| ose homoseksuale me persona te pazotë për t'u mbrojtur | | | | | | | | | | |
| Neni 104 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës | 2 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 |
| Neni 105 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 106 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose në kujdestari | 1 | 1 | 0 | 1 | 2 | 2 | 1 | 1 | 1 | 0 |
| Neni 107 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale ne vende publike | 2 | 2 | 3 | 3 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 |
| Neni 108 Vepra të turpshme | 21 | 13 | 15 | 14 | 9 | 31 | 19 | 24 | 19 | 17 |
| Totali | 88 | 44 | 72 | 52 | 42 | 102 | 51 | 91 | 52 | 40 |

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka rritje prej 16 % të numrit të procedimeve të regjistruara për krime seksuale në krahasim me vitin 2014. Ndërkohë që kemi të njëjtën rritje prej 16 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 26 %, numër i njëjtë i të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit (52) dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 4,8 % përkundrejt vitit 2014.

Grafikisht tendenca e krimeve seksuale për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TE PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit, nga të dhënat statistikore rezulton se 94,8 % e të pandehurve të rritur (mbi 18 vjeç) janë meshkuj dhe 5,2 % femra. Ndërkohë nga numri i përgjithshëm i të pandehurve 1,4 % janë të mitur (14-18 vjeç).

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 59,8 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 38 % me arsim të mesëm. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se nga sektori privat janë regjistruar 55,3 % e të pandehurve dhe pjesa tjetër janë të papunë.

Rezulton se 59,1 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 41,9 % prej tyre në fshat. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në qytet.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime seksuale” është 18,6 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 22,7%. Pra vihet re ulje krahasuar me vitin 2014.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Në këtë grup veprash penale në vitin 2015, vihet re një ulje e lehtë e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 100 i Kodit Penal “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, prej 0,5 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rretheve për këtë veprë penale:




Rezulton se në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë janë regjistruar 6 procedime penale për këtë veprë, që është edhe numri më i madh i regjistruar në shkallë vendi. Në prokurorinë e shkallës së parë Lushnje janë regjistruar 4 procedime penale, në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 3 procedime penale, në prokurorinë e shkallës së parë Durrës janë regjistruar 2

procedime penale, në prokuroritë e shkallës së parë Kavajë, Korçë, Fier e Sarandë është regjistruar përkatësisht nga 1 procedim penal, për veprën penale të parashikuar nga neni 100 i Kodit Penal “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, në vitin 2015.

Vepra të turpshme


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime seksuale” është 30 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 24 %. Pra vihet re rritje krahasuar me vitin 2014.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Në vitin 2015, në këtë grup veprash vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 108 i Kodit Penal “Vepra të turpshme”, prej 48 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rretheve për këtë vepër penale:



Rezulton se në prokuroritë e shkallës së parë Tiranë dhe Sarandë janë regjistruar nga 8 procedime penale për këtë veprë, që është edhe numri më i madh i regjistruar në shkallë vendi. Në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 5 procedime penale, në prokurorinë e shkallës së parë Durrës janë regjistruar 4 procedime penale, në prokuroritë e shkallës së parë Berat e Lushnje janë regjistruar 2 procedime penale, në prokuroritë e shkallës së parë Fier e Kurbin janë regjistruar përkatësisht nga 1 procedim penal, në vitin 2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 108 i Kodit Penal “Vepra të turpshme”.

VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2015 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,4 % dhe për vitin 2014 ka qenë 0,34 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e VII “Vepra penale kundër lirisë së personit”.

| VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|--|----------------|----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|----------------|----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 109 Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit | 3 | 1 | 0 | 3 | 8 | 10 | 0 | 9 | 0 | 3 |
| Neni 109/a Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit në rrethana lehtësuese | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | 1 |

| | | | | | | | | | | |
|--|------------|-----------|------------|-----------|-----------|------------|-----------|------------|------------|-----------|
| Neni 109/b Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë | 47 | 31 | 32 | 20 | 20 | 65 | 32 | 53 | 51 | 35 |
| Neni 109/c Zhdukja me forcë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 110 Heqja e paligjshme e lirisë | 51 | 25 | 57 | 47 | 29 | 38 | 22 | 41 | 38 | 35 |
| Neni 111Rrëmbimi i avioneve, anijeve dhe mjeteve të tjera | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 112 Dhunimi i banesës | 15 | 8 | 15 | 11 | 7 | 27 | 15 | 22 | 26 | 16 |
| Totali | 116 | 65 | 104 | 81 | 64 | 140 | 70 | 125 | 116 | 90 |

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 20,7 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër lirisë së personit” në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi rritje prej 7,7 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 20 %, një rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 43 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 40,6 % përkundrejt vitit 2014.

Grafikisht tendenca e krimeve kundër lirisë së personit për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TE PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit, nga të dhënat statistikore rezulton se 91,5 % e të pandehurve të rritur (mbi 18 vjeç) janë meshkuj dhe 8,5 % femra. Ndërkohë nga numri i përgjithshëm i të pandehurve 1,5 % janë të mitur (14-18 vjeç) meshkuj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 60 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 38 % me arsim të mesëm dhe 2 % e të pandehurve me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror nuk është regjistruar asnjë i pandehur.

Nga sektori privat janë regjistruar 55,3 % e të pandehurve dhe të papunë 41,7 %. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 60 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 40 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër lirisë së personit” është 7 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 2,58 %.

Në vitin 2015 për këtë vepër janë regjistruar 10 procedime penale tregues ky në rritje ndaj 3 procedimeve penale të regjistruara në vitin 2014.

Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër lirisë së personit” është 46 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 40,5 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 109/b i Kodit Penal “Shtërëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, në vitin 2015, prej 38 % në krahasim me vitin 2014.

Heqja e paligjshme e lirisë


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Kundër lirisë së personit” është 27 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 44 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal “Heqja e paligjshme e lirisë”, në vitin 2015, prej 25 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rretheve për këtë veprë penale:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të heqjes së paligjshme të lirisë është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, ku janë regjistruar përkatësisht 24 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Fier e Vlorë kanë regjistruar respektivisht 16 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Lezhë ka regjistruar 10 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Durrës ka regjistruar 8 % të procedimeve, prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastrë, Korçë e Mat kanë regjistruar nga 2 procedime penale ose 5 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Krujë, Kurbin, Lushnjë e Shkodër kanë regjistruar nga 1 procedim penal dhe prokuroritë e shkallës së parë Berat, Dibër, Elbasan, Kavajë, Kukës, Përmet, Pogradec, Pukë, Sarandë e Tropojë nuk kanë regjistruar asnjë procedim gjatë vitit 2015, për veprën penale të parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal “Heqja e paligjshme e lirisë”.

VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT DHE DINJITETIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,8 %, shifër kjo e njëjtë me atë të vitit 2014.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e VIII të Kodit Penal “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit”.

| VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT DHE DINJITETIT | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|---|-----------------|-----------------------|-------------------|----------------------|------------------|-----------------|-----------------------|------------------|---------------------|------------------|
| | Nr. Proced Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denu ar | Nr. Proced Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denu ar |
| Neni 113 Prostitucioni | 17 | 9 | 43 | 27 | 22 | 15 | 23 | 28 | 59 | 37 |
| Neni 114 Shfrytëzimi i prostitucionit | 52 | 17 | 60 | 40 | 28 | 46 | 17 | 44 | 27 | 18 |
| Neni 115 Mbajtja e lokaleve për prostitucion | 2 | 2 | 2 | 5 | 4 | 1 | 1 | 4 | 2 | 3 |
| Neni 117 Pornografia | 28 | 0 | 1 | 0 | 0 | 30 | 1 | 1 | 1 | 0 |
| Neni 118 Dhunimi i varreve | 25 | 6 | 13 | 10 | 7 | 18 | 4 | 4 | 6 | 5 |
| Neni 119 Fyerja | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 |
| Neni 120 Shpifja | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 121 Ndërhyrje të padrejta në jetën private | 7 | 0 | 1 | 0 | 0 | 7 | 2 | 4 | 2 | 1 |
| Neni 121/a Përndjekja | 140 | 81 | 110 | 83 | 59 | 140 | 82 | 114 | 82 | 68 |
| Neni 122 Përhapja e sekreteve vetjake | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 123 Pengimi ose shkelja e fshehtësisë së korrespondencës | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 | 1 | 1 | 1 | 0 |
| Totali | 274 | 115 | 230 | 165 | 120 | 262 | 131 | 200 | 180 | 133 |

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një ulje prej 4,4 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit” në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi rritje prej 14 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, vihet re ulje prej 13 % e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014, numri i të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit tregon rritje me 9 % dhe rritje prej 11 % ka pësuar edhe numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata krahasuar me vitin 2014.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër moralit dhe dinjitetit për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TE PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit, 2,6 % kanë qenë të pandehur të mitur; të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 16,2 % femra dhe pjesa tjetër meshkuj (81,2 %).

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 62,5 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 34,7 % me arsim të mesëm dhe 2,8 % të pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore, nga sektori privat janë regjistruar 15,5 % e të pandehurve dhe 84,5 % rezultojnë të papunë. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 69 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 31 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë dhe vetëm 6,7 % e tyre janë përsëritës në vepra penale.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Shfrytëzimi i prostitucionit


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit” është 17,5 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 19 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 114 i Kodit Penal “Shfrytëzimi i prostitucionit”, në vitin 2015 me 11,5 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rretheve për veprën penale të shfrytëzimit të prostitucionit:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të heqjes së paligjshme të lirisë është në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan, ku janë regjistruar përkatësisht 17 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Tiranë ka regjistruar 15 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 11 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Durrës e Lezhë kanë regjistruar 9 % të procedimeve, prokuroritë e shkallës së parë Berat, Korçë e Lushnje kanë regjistruar nga 6,5 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Shkodër ka regjistruar 2 procedime që përbën 4 % të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi dhe prokuroria e shkallës së parë Kurbin ka regjistruar 1 procedim penal për vitin 2015. Ndërkaq në prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Gjirokastrë, Kavajë, Krujë, Kukës, Mat, Përmet, Pogradec, Sarandë e Tropojë nuk është regjistruar asnjë procedim gjatë vitit 2015, për veprën penale të parashikuar nga neni 114 i Kodit Penal “Shfrytëzimi i prostitucionit”.

Pornografia


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit” është 11,5 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 10 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet se gjatë viteve 2011, 2012, 2013 nuk është regjistruar asnjë procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 117 i Kodit Penal “Pornografia”, ndërsa në vitin 2015 janë regjistruar 30 procedime penale që përbëjnë rritje prej 7 % krahasuar me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike (numrin e procedimeve penale të regjistruara) sipas rretheve për veprën penale të pornografisë:




Siç vërehet nga grafiku numri më i madh i procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për këtë vepër penale është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, e cila ka regjistruar 77 % të procedimeve penale. Prokuroria e shkallës së parë Fier ka regjistruar 14 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Kurbin, Lezhë e Sarandë kanë regjistruar respektivisht 3 % të procedimeve në shkallë vendi, ndërkohë që nuk ka anjë procedim të regjistruar në vitin 2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 117 i Kodit Penal “Pornografia”, në prokuroritë e shkallës së parë Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Gjirokastër, Kavajë, Korçë, Krujë, Kukës, Lushnjë, Mat, Përmet, Pogradec, Pukë, Shkodër, Tropojë e Vlorë.

Përndjekja

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit” është 53 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 51 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në tre vite, 2012¹⁴-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):

¹⁴ Shtuar me ligjin 23/2012



Nga të dhënat statistikore vërehet se në vitin 2015 është regjistruar numër i njëjtë procedimesh si në vitin 2014 për veprën penale të parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal “Përndjekja”.

VEPRA PENALE KUNDËR FËMIJËVE, MARTESËS DHE FAMILJES

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 4 %, ndërsa për vitin 2014 ka qenë 3,8 %. Pra, vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e IX-të të Kreut të Dytë të Kodit Penal “Vepra Penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes”:


| VEPRA PENALE KUNDËR FËMIJËVE, MARTESËS DHE FAMILJES | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|---|-----------------|-----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|-----------------|-----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
| | Nr. Proced Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proced Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 124 Braktisja e fëmijëve të mitur | 16 | 10 | 14 | 11 | 7 | 25 | 7 | 19 | 7 | 9 |
| Neni 124/b Keqtrajtimi i të miturit | 19 | 13 | 19 | 14 | 5 | 18 | 11 | 17 | 12 | 13 |
| Neni 125 Mosdhënia e mjeteve për jetesë | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 |
| Neni 126 Mosnjoftimi i ndryshimit të vendbanimit | 3 | 2 | 3 | 2 | 1 | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 |
| Neni 127 Marrja e padrejtë e fëmijës | 8 | 0 | 2 | 0 | 0 | 8 | 1 | 5 | 1 | 0 |
| Neni 128 Ndërrimi i fëmijëve | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | | | | | | | | | | |
|---|-------------|------------|-------------|-------------|------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| Neni 128/a Fshehja ose ndërrimi me dashje i fëmijës | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 129 Shtytja e të miturve në krim | 3 | 0 | 0 | 0 | 1 | 4 | 1 | 3 | 1 | 1 |
| Neni 130 Shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë | 34 | 23 | 31 | 23 | 18 | 73 | 44 | 44 | 44 | 37 |
| 130/a Dhuna në familje | 1215 | 941 | 1189 | 998 | 727 | 1206 | 1023 | 1197 | 1097 | 985 |
| Totali | 1299 | 989 | 1259 | 1048 | 759 | 1336 | 1087 | 1287 | 1162 | 1046 |

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 3 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi rritje prej 10 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, vihet re rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 2 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit me 11 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 38 % përkundrejt vitit 2014.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër fëmijëve martesës dhe familjes për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TE PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, moshja, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit, 1 % e të pandehurve janë të mitur meshkuj. Të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 7 % femra dhe 92 % meshkuj të pandehur.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 63,6 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 33,5 % me arsim të mesëm dhe 2,9 % të pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se nga sektori shtetëror janë regjistruar 3 të pandehur. Nga sektori privat janë regjistruar 30,8 % e të pandehurve dhe pjesa tjetër e të pandehurve janë të papunë.

Rezulton se 47 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 53 % e të pandehur në fshat. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, ku vetëm 3 % e tyre janë të dënuar për vepra të tjera penale.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Shtrengimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” për vitin 2015 është 5,5 %, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 2,6 % .

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje prej 114 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 130 i Kodit Penal “Shtrengimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë”, në vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

Dhuna në familje


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” është 90 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 93,5 %.

Ecuria e kësaj vepre penale (e shtuar me ligjin 23/2012), për vitet 2012-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore vihet re një tendencë e lehtë ulje prej 0,7 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a të Kodit Penal “Dhuna në familje”, në vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me numrin e procedimeve penale të regjistruara sipas prokurorive të shkallës së parë në vitet 2014 – 2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal “Dhuna në familje”:



Lidhur me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre në vitin 2015 grafiku në vijim paraqet të dhënat në përqindje sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të dhunës në familje është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 30 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në vijim sipas numrit më të madh të procedimeve të regjistruara renditen, prokuroria e shkallës së parë Fier që ka regjistruar 10 % të procedimeve, prokuroria e shkallës së parë Elbasan që ka regjistruar 9 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Durrës që ka regjistruar 7 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Berat, që ka regjistruar 6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokuroritë e shkallës së parë Korçë e Lushnje janë regjistruar përkatësisht 5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve dhe në prokuroritë e shkallës së parë Pogradec e Lezhë janë regjistruar respektivisht 3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e tjera kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 3 % të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a “Dhuna në familje”, ku numri më i ulët për vitin 2015 rezulton në prokuroritë e shkallës së parë Përmet e Tropojë.

LIRIA E BESIMIT

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të parashikuara në seksionin e X-të të Kreut të Dytë të Kodit Penal, veprat penale kundër lirisë së besimit:

| VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË BESIMIT | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|--|----------------|----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|----------------|----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 131 Pengimi i veprimtarive të organizatave fetare | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 132 Shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit | 3 | 1 | 1 | 1 | 0 | 2 | 1 | 2 | 1 | 2 |
| Neni 133 Pengimi i ceremonive fetare | 1 | 1 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali | 4 | 2 | 2 | 2 | 0 | 2 | 1 | 2 | 1 | 2 |

Për këtë grup veprash penale të dhënat statistikore tregojnë se gjatë vitit 2015 janë regjistruar 2 procedime penale me 2 të pandehur, të 2 këto procedime për veprën penale “Shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit”. 1 procedim penal me 1 të pandehur për këtë vepër penale është dërguar për gjykim, dhe janë dënuar 2 të pandehur. Krahasuar me vitin 2014 vërehet tendencë në ulje për këtë grup veprash penale.

VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË DHE NË SFERËN EKONOMIKE

VJEDHJA E PASURISË

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 39 %, ndërsa në vitin 2014 ka qenë 40 %. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e parë të Kreut të tretë të Kodit Penal, Vjedhja e Pasurisë.

| VJEDHJA E PASURISË ¹⁵ | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|---|-----------------|-----------------------|------------------|---------------------|-----------------|-----------------|-----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
| | Nr. Proced Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proced Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 134 Vjedhja | 10533 | 1609 | 2023 | 2094 | 1945 | 10065 | 1338 | 1707 | 1702 | 1634 |
| Neni 135 Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën | 160 | 63 | 127 | 107 | 62 | 147 | 95 | 79 | 111 | 82 |
| Neni 136 Vjedhja e bankave dhe e arkave të kursim. | 8 | 4 | 7 | 9 | 7 | 7 | 8 | 8 | 15 | 8 |
| Neni 137 Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike | 2470 | 1107 | 1711 | 1135 | 561 | 2082 | 2077 | 1642 | 2097 | 2115 |


¹⁵ Vecuar nga ky grup dhe trajtuar me vete trafiket

| | | | | | | | | | | |
|--|--------------|-------------|-------------|-------------|-------------|--------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| Neni 137 /aVjedhja e rrjetit te komunikimeve elektronike | 6 | 2 | 4 | 2 | 0 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 138 Vjedhja e veprave të artit e kulturës | 6 | 2 | 1 | 3 | 3 | 2 | 1 | 0 | 1 | 1 |
| Neni 139 Vjedhja me dhunë | 326 | 85 | 130 | 139 | 126 | 258 | 78 | 116 | 126 | 134 |
| Neni 140 Vjedhja me armë | 75 | 16 | 30 | 32 | 43 | 58 | 18 | 38 | 31 | 24 |
| Neni 141 Vjedhja me pasojë vdekjen | 5 | 1 | 10 | 2 | 7 | 7 | 3 | 7 | 4 | 2 |
| Neni 142 Sigurimi i mjeteve për vjedhje | 5 | 1 | 3 | 1 | 0 | 2 | 2 | 1 | 2 | 1 |
| Totali | 13594 | 2890 | 4046 | 3524 | 2754 | 12631 | 3620 | 3598 | 4089 | 4001 |


TENDENCA

Sikurse vihet re, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një ulje prej 7 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vjedhjen e pasurisë në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi rritje prej 25 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 11 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 16 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 45 % përkundrejt vitit 2014.

Grafikisht tendenca e veprave penale të vjedhjes së pasurisë për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



Për vitin 2015 procedimet penale për veprat e këtij seksioni krahasuar me vitin 2014 paraqesin tendencat si vijon:



TE PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit, 10 % kanë qenë të pandehur të mitur, të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 6 % femra dhe 94 % meshkuj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 61,6 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 34,7 % me arsim të mesëm dhe 3,7 % e të pandehurve me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 2,6 % e të pandehurve përkundrejt 1 % të tillë në vitin 2014.

Nga sektori privat janë regjistruar 21,2 % e të pandehurve dhe të papunë 76,2 %. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 65 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 35 % prej tyre në fshat.

Pra, ky fenomen është i përhapur si në fshat ashtu dhe në ato urbane, por tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në qytet.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 4,7 % prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër penale, ndërsa 3,7 % e të pandehurve janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Vjedhja


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike” është 79,7 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 77,4 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Në këtë grup veprash penale vihet re se procedimet e regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal “Vjedhja”, në vitin 2015 janë ulur me 4 % në krahasim me vitin 2014.

Në lidhje me numrin e procedimeve penale të regjistruara sipas prokurorive të shkallës së parë gjatë viteve 2014 - 2015, grafiku më poshtë paraqet të dhënat statistikore si vijon:



Lidhur me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre në vitin 2015 grafiku në vijim paraqet të dhënat në përqindje sipas prokurorive:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të vjedhjes është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 37 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Durrës e Elbasan janë regjistruar respektivisht 8 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Fier, Shkodër, Sarandë e Lushnje janë regjistruar respektivisht 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Korçë janë regjistruar 5 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë janë regjistruar 3 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Berat, Gjirokastër, Kavajë e Krujë janë regjistruar përkatësisht 2 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e tjera kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 2 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2015, për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal “Vjedhja”.

Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale kundër vjedhjes së pasurisë është 1,16 %, ndërsa për vitin 2014 ky tregues ka qenë 1,18 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën”, në vitin 2015, prej 8 % në krahasim me vitin 2014.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2015 për këtë vepër, rezulton si më poshtë vijon:




Siç vërehet nga grafiku, prokuroritë që kanë regjistruar numrin më të madh të kësaj vepre janë prokuroria e shkallës së parë Tiranë që përbën 24 % të totalit të procedimeve të regjistruara për këtë vepër në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Fier me 16 % të totalit të procedimeve,

prokuroria e shkallës së parë Elbasan me 13 % të totalit të procedimeve të regjistruara. Prokuroria e shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 10 % të totalit të procedimeve, prokuroritë e shkallës së parë Shkodër, Durrës e Korçë kanë regjistruar respektivisht 5 % të totalit të procedimeve, prokuroria e shkallës së parë Berat 3 % të totalit të procedimeve dhe prokuroritë e shkallës së parë Lezhë e Mat kanë regjistruar 3 % të procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Gjirokastër, Kavajë, Krujë, Kukës, Kurbin, Lushnje, Përmet, Pogradec, Pukë e Sarandë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 2 % të totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, ndërsa prokuroria e shkallës së parë Tropojë nuk ka regjistruar asnjë procedim për vitin 2015, për veprën penale të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën”.

Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Vjedhja e pasurisë” për vitin 2015 është 16,5 %, ndërkohë që për vitin 2014 ka qenë 18 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 numri i procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 137 “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike” i Kodit Penal, ka një ulje prej 15,7 % në krahasim me vitin 2014.

Nga të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë veprë penale, rezulton se 91,9 % e të pandehurve të rritur (mbi 18 vjeç) janë meshkuj dhe 8,1 % femra. Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 54 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 42 % me arsim të mesëm dhe 4 % e të pandehurve me arsim të lartë. Përsa i përket gjendjes shoqërore nga

të dhënat statistikore vihet re se nga sektori privat janë regjistruar 36,5 % e të pandehurve dhe të papunë 62,5 %. Sa i përket vendbanimit, rezultojnë se 72 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 28 % prej tyre në fshat. Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, ndërsa me pak se 1% rezultojnë të dënuar për vepra të tjera penale.

Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale gjatë vitit 2015 sipas prokurorive të shkallës së parë:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të vjedhjes së energjisë elektrike ose impulseve telefonike është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 57 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në vijim në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër që përbën 11 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan që përbën 9 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 5 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Durrës e Fier janë regjistruar respektivisht 3 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Berat ka regjistruar një numër procedimesh që përbën 2,4 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Lushnje ka regjistruar një rreth 2 % të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Gjirokastrë, Kavajë, Korçë, Krujë, Kukës, Kurbin, Lezhë, Mat, Pogradec, Pukë, Përmet, Sarandë e Tropojë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbëjnë më pak se 1,4 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi, ndërkohë që në prokuroritë e shkallës së parë Kukës, Përmet e Tropojë është regjistruar numri më i ulët i procedimeve penale për vitin 2015 (1 procedim), për veprën penale

të parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”.

Vjedhja me dhunë


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Vjedhja e pasurisë” për vitin 2015 është 2 % ndërkohë që për vitin 2014 ka qenë 2,4 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore se në vitin 2015 ka ulje prej 21 % në krahasim me vitin 2014 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 139 “Vjedhja me dhunë” i Kodit Penal.

Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale gjatë vitit 2015 sipas prokurorive të shkallës së parë:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të vjedhjes me dhunë është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 43 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në vijim procedimet sipas numrit më të madh janë regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Durrës që përbën 11 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë që përbën 8 % të numrit total të procedimeve në shkallë vend, në prokuroritë e shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 6 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Elbasan, Lezhë e Fier janë regjistruar 5 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi dhe në prokurorinë e shkallës së parë Kurbini janë regjistruar 4 % e procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Sarandë, Gjirokastrë, Korçë e Krujë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën 2 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Berat, Dibër, Kukës, Lushnjë e Përmet kanë regjistruar përkatësisht rreth 1 % të procedimeve penale, ndërkohë që në prokuroritë e shkallës së parë Kavajë, Mat, Pogradec, Pukë e Tropojë nuk rezultojnë asnjë procedim i regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal “Vjedhja me dhunë” për vitin 2015.

MASHTRIMET

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 3 %, ndërsa në vitin 2014 është 2,5 %. Pra, vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e II, të Kreut të Tretë të Kodit Penal “Mashttrimet”:

| MASHTRIMET | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|--|-----------------|-----------------------|--------------------|-----------------------|------------------|-----------------|----------------------|-------------------|---------------------|------------------|
| | Nr. Proceđ Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pand . Regj. | Nr. Pand . Per gjykim | Nr. Pand denu ar | Nr. Proceđ Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand . Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denu ar |
| Neni 143 Mashtrimi | 526 | 204 | 215 | 230 | 182 | 531 | 220 | 240 | 250 | 187 |
| Neni 143/a Skemat mashtruese dhe piramidale | 3 | 1 | 1 | 2 | 0 | 3 | 1 | 1 | 1 | 2 |
| Neni 143/a/1 Manipulimi i tregut | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 143/a/2 Përdorimi i paautorizuar dhe përhapja e informacionit të privilegjuar | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 143/a/3 Manipulimi i cmimeve dhe përhapja e informacionit të rremë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 143/a/4 Paraqitja e të dhënave të rreme dhe shpërndarja e paautorizuar e tyre | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 143/a/5 Regjistrimi i titujve në bursë në mënyrë të paautorizuar | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 143/a/6 Fshehja e pronësisë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 143/a/7 Tregtimi i paligjshëm i titujve | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 144 Mashtrimi në subvencione | 2 | 0 | 3 | 6 | 3 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 144/a | 11 | 4 | 9 | 4 | 1 | 7 | 2 | 4 | 2 | 0 |
| Neni 145 Mashtrimi në sigurime | 220 | 96 | 131 | 97 | 45 | 421 | 263 | 194 | 267 | 223 |
| Neni 146 Mashtrimi në kredi | 15 | 11 | 4 | 13 | 10 | 11 | 6 | 2 | 7 | 5 |
| Neni 147 Mashtrimi për veprat e artit e të kulturës | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 |
| Neni 148 Botimi i veprës së tjetrit me emrin e vet | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| Neni 149 Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit | 6 | 0 | 3 | 0 | 2 | 5 | 1 | 3 | 1 | 0 |
| Neni 149/a Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale | 77 | 10 | 33 | 12 | 3 | 31 | 16 | 16 | 17 | 15 |
| Neni 149/b Shkelja e të drejtave të topografisë së qarkut të gjysmëpërcuesit | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali | 860 | 326 | 399 | 364 | 246 | 1011 | 509 | 460 | 545 | 433 |

TENDENCA

Sikurse vihet re, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 numri i procedimeve të regjistruara për veprat penale të mashtrimit ka një rritje prej 18 % krahasuar me vitin 2014. Ndërkaq kemi rritje prej 56 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 36 %, një rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 50 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 76 % përkundrejt vitit 2014.

Grafikisht tendenca e veprave penale të mashtrimeve për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit, 3 kanë qënë të mitur meshkuj, ndërsa të rritur (mbi 18 vjeç) kanë qënë 24 % femra, dhe 76 % të pandehur meshkuj në vitin 2015.

Përsa i përket arsimit të të pandehurve rezulton se 53,7 % e të pandehurve janë me arsim deri 9 vjeçar të lartë, 38,4 % me arsim të mesëm dhe vetëm 7,9 % me arsim të lartë.

Në këtë grup veprash janë marrë të pandehur 9 shtetas të huaj.

Rezulton se 58 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 42 % prej tyre në fshat, pra, raporti i të pandehurve sipas vendbanimit paraqet një diferencë të vogël.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se vetëm 3 % prej tyre janë përsëritës në krime.


Bazuar në sa më sipër, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e këtyre veprave penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Mashtrimi


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Mashtrimet” është 52,5 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qënë 61 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Në këtë grup veprash penale vihet re një tendencë e lehtë në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal "Mashtrimi", në vitin 2015, prej 1 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal "Mashtrimi", gjatë vitit 2015:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, edhe për këtë veprë penale numri më i madh i procedimeve të regjistruara është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 45 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan që përbën 8 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Fier e Vlorë që përbëjnë përkatësisht 7 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Durrës që përbën 6 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër e Lezhë që kanë regjistruar nga 5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Korçë e Berat që përbëjnë përkatësisht 3 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastrë, Kavajë, Kukës, Krujë, Kurbin, Lushnjë, Mat, Përmet, Pukë, Pogradec e Sarandë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 2 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi, ndërkohë që në prokuroritë e shkallës së parë Dibër e Tropojë nuk rezulton asnjë procedim i regjistruar gjatë vitit 2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal “Mashtrimi”.

Mashtrimi në sigurime


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Mashtrimet” është 41,6 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 25,6 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë);



Nga të dhënat statistikore vihet re një rritje e madhe e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal “Mashtrimi në sigurime”, me 90 % në vitin 2015 krahasuar me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal “Mashtrimi në sigurime”, gjatë vitit 2015:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të mashtrimit në sigurime është në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër, që përbën 35 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Tropojë që përbën 26 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Kukës që përbën 19 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë që përbën 9 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Dibër që përbën 4 % të numrit total të procedimeve dhe në prokurorinë e shkallës së parë Pukë që përbën 3 % të procedimeve të regjistruar në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Berat, Durrës, Korçë, Krujë, Lezhë, Pogradec e Sarandë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 1,5 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi, ndërkohë që në prokuroritë e shkallës së parë Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Kavajë, Kurbin, Lushnje, Mat, Përmet e Vlorë nuk rezulton asnjë procedim i regjistruar në vitin 2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal “Mashtrimi në sigurime”.

Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale kundër mashtrimit është 3 %, ndërsa për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ky tregues ka qenë 9 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 149/a i Kodit Penal “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”, në vitin 2015, prej 60 % krahasuar me vitin 2014.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale gjatë vitit 2015 të dhënat konkrete paraqiten në grafikun e mëposhtëm:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale shkelja e të drejtave të pronësisë intelektuale është në prokurorinë e shkallës së parë Berat që përbën 36 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë që përbën 26 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë është regjistruar një numër procedimesh që përbën 13 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan që përbën 10 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe në prokurorinë e shkallës së parë Sarandë ku janë regjistruar një numër procedimesh që përbëjnë 6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Korçë, Shkodër e Fier, kanë regjistruar nga 1 procedim penal që përbën respektivisht 3 % të totalit të regjistruar në shkallë vendi, ndërkohë që në prokuroritë e tjera, nuk rezulton asnjë procedim i regjistruar gjatë vitit 2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 149/a i Kodit Penal “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”.

SHKATËRRIMI I PRONËS

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 3 %, ndërsa për vitin 2014 ka qenë 2,7 %.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e III, të Kreut të III të Kodit Penal:

| SHKATËRRIMI I PRONËS | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|---|----------------|----------------------|------------------|---------------------|-----------------|----------------|----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 150 Shkatërrimi i pronës | 362 | 69 | 99 | 83 | 81 | 327 | 67 | 126 | 92 | 83 |
| Neni 151 Shkatërrimi i pronës me zjarr | 290 | 32 | 45 | 35 | 28 | 346 | 30 | 33 | 31 | 19 |
| Neni 152 Shkatërrimi i pronës me eksploziv | 78 | 1 | 4 | 1 | 0 | 50 | 0 | 6 | 0 | 0 |
| Neni 153 Shkatërrimi i pronës me përmbytje | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 154 Shkatërrimi i pronës me mjete të tjera | 6 | 1 | 5 | 3 | 2 | 5 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 155 Shkatërrimi i rrugëve | 24 | 3 | 6 | 9 | 2 | 29 | 5 | 15 | 11 | 9 |
| Neni 156 Shkatërrimi i rrjetit elektrik | 56 | 8 | 10 | 10 | 8 | 65 | 8 | 8 | 9 | 4 |
| Neni 157 Shkatërrimi i rrjetit të ujitjes | 5 | 0 | 0 | 0 | 0 | 7 | 1 | 1 | 1 | 0 |
| Neni 158 | 1 | 0 | 1 | 0 | 2 | 2 | 0 | 1 | 0 | 0 |
| Neni 159 Shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit | 90 | 36 | 46 | 37 | 16 | 80 | 50 | 39 | 51 | 31 |
| Neni 160 Shkatërrimi i veprave kulturore | 3 | 1 | 0 | 1 | 1 | 6 | 1 | 1 | 1 | 0 |
| Neni 161 Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia | 15 | 6 | 7 | 6 | 7 | 46 | 14 | 27 | 17 | 5 |
| Neni 162 Përplasja e mjeteve të transportit masiv | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali | 930 | 157 | 223 | 185 | 147 | 963 | 176 | 257 | 213 | 151 |

TENDENCA

Sikurse vihet re, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka rritje në krahasim me vitin 2014, në masën 3,5 % të numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të shkatërrimit të pronës. Ndërkaq kemi rritje prej 12 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 15 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 15 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 2,7 % përkundrejt vitit 2014.

Grafikisht tendenca e veprave penale të shkatërrimit të pronës për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit, më pak se 3 % kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj dhe asnjë femër; të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 4,8 % femra dhe 92,2 % meshkuj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 68 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 30 % me arsim të mesëm dhe 2 % e të pandehurve me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se nga sektori privat janë regjistruar 34,7 % e të pandehurve dhe 65,3 % janë të papunë. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 42 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 58 % prej tyre në fshat. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në qytet.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë 96 % e të pandehurve, vetëm 4 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Shkatërrimi i pronës me zjarr


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Shkatërrimi i pronës” është 36 % për vitin 2015, ndërkohë që për vitin 2014 ka qenë 31 % .

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës me zjarr”, në vitin 2015, prej 19 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me procedimet penale të regjistruara në vitin 2015, për këtë vepër sipas prokurorive të shkallës së parë:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të shkatërrimit të pronës me zjarr është në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë, që përbën 15 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan që përbën 14 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë që përbën 9 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Korçë ku janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokuroritë e shkallës së parë Durrës e Fier numri i procedimeve të regjistruara për këtë veprë përbën 7 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Krujë përbën 6 % të numrit total të procedimeve, në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër përbën 5 % të numrit total të procedimeve, në prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Lushnje e Lezhë procedimet e regjistruara përbëjnë 4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe në prokuroritë e shkallës së parë Berat e Tropojë numri i procedimeve të regjistruara është 3 % e procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Ndërkaq prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastrë, Kavajë, Kukës, Kurbin, Mat, Përmet, Pogradec, Pukë e Sarandë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 2 % të totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2015, për veprën penale të parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës me zjarr”.

Shkatërrimi i pronës me eksploziv


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Shkatërrimi i pronës” për vitin 2015 është 5 %, ndërsa në vitin 2014 ky tregues ka qenë 8 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara në vitin 2015, për veprën penale të parashikuar nga neni 152 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës me eksploziv”, prej 36 % në krahasim me vitin 2014.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2015, të dhëna të detajuara jepen në grafikun e mëposhtëm:




Siç vërehet nga grafiku, prokuroritë që kanë regjistruar numrin më të madh të kësaj vepre janë prokuroritë e shkallës së parë Tiranë e Krujë nga 10 procedime penale ose 20 % të totalit të

procedimeve të regjistruara për këtë vepër në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Vlorë që ka regjistruar 8 procedime penale ose 16 % të totalit të procedimeve, prokuroria e shkallës së parë Gjirokastrë me 7 procedime ose 14 % të totalit të procedimeve, prokuroria e shkallës së parë Shkodër me 4 procedime ose 8 % të totalit të procedimeve të regjistruara. Ndërkaq, prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Kavajë e Sarandë kanë regjistruar nga 2 procedime penale ose 4 % të totalit të procedimeve, prokuroritë e shkallës së parë Durrës, Kurbin, Lezhë, Pukë e Tropojë kanë regjistruar nga 1 procedim penal ose 2 % të totalit të procedimeve. Prokuroritë e shkallës së parë Berat, Elbasan, Fier, Korçë, Kukës, Lushnjë, Mat, Përmet e Pogradec nuk kanë regjistruar asnjë procedim për vitin 2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 152 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës me eksploziv”.


Shkatërrimi i rrjetit elektrik

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Shkatërrimi i pronës” është 7 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014, pesha specifike e kësaj vepre është 6 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara në vitin 2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 156 i Kodit Penal “Shkatërrimi i rrjetit elektrik”, prej 16 %, krahasuar me vitin 2014.




Siç vërehet nga grafiku, prokuroritë që kanë regjistruar numrin më të madh të kësaj vepre janë prokuroria e shkallës së parë Fier që përbën 23 % të totalit të procedimeve të regjistruara për këtë vepër në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Elbasan që ka regjistruar 20 % të totalit të procedimeve, prokuroria e shkallës së parë Tropojë me 17 % të totalit të procedimeve, prokuroria e shkallës së parë Vlorë me 14 % të totalit të procedimeve të regjistruara. Prokuroria e shkallës së parë Tiranë ka regjistruar 9 % të totalit të procedimeve, prokuroria e shkallës së parë Durrës ka regjistruar 6 % të totalit të procedimeve, prokuroritë e shkallës së parë Dibër e Korçë kanë regjistruar nga 2 procedime penale ose 3 % dhe prokuroritë e shkallës së parë Krujë, Kukës e Lezhë kanë regjistruar nga 1 procedim penal ose 2 % të totalit të procedimeve. Prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar asnjë procedim për vitin 2015, për veprën penale të parashikuar nga neni 156 i Kodit Penal “Shkatërrimi i rrjetit elektrik”.

Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Shkatërrimi i pronës” është 5 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014, pesha specifike e kësaj vepre është 1,6 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje prej tre herë më shumë e procedimeve të regjistruara në vitin 2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 161 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia”, krahasuar me vitin 2014.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2015, rezulton se:



Siç vërehet edhe në paraqitjen grafike, të dhënat statistikore tregojnë se peshën më të madhe të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për veprën penale të parashikuar nga neni 161 i

Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia”, e kanë regjistruar prokuroritë e shkallës së parë Tiranë e Fier me 7 procedime ose 15 %. Prokuroritë e shkallës së parë Elbasan e Lezhë kanë regjistruar 11 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Berat e Kavajë kanë regjistruar 9 % të procedimeve, prokuroritë e shkallës së parë Durrës, Lushnje e Vlorë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën 6,5 % të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Krujë, Përmet, Pukë, Sarandë e Shkodër kanë regjistruar nga 2 % të procedimeve, ndërsa prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Gjirokastër, Korçë, Kukës, Kurbin, Mat, Pogradec e Tropojë nuk kanë regjistruar asnjë procedim për këtë vepër penale.

VEPRA PENALE TË KRYERA NË SHOQËRITË TREGTARE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 0,09 %, për vitin 2014 ka qenë 0,04 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e IV të Kreut të III të Kodit Penal “Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare”.

| VEPRA PENALE TË KRYERA NË SHOQËRITË TREGTARE | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|--|----------------|-----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|-----------------|-----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proced Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 163 Përpilimi i deklaratave të rreme | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 164 Shpërdorimi i kompetencave | 5 | 2 | 0 | 2 | 0 | 4 | 1 | 1 | 1 | 1 |
| Neni 165 Falsifikimi i nënshkrimeve | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 166 Emetimi i parregullt i aksioneve | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 167 Mbajtja e padrejtë e dy cilësive | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 168 Dhënia e informacioneve të rreme | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 169 Zbulimi i sekreteve të shoqërisë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 170 Mosbërja e shënimeve të detyrueshme | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 170/a Punësimi i paligjshëm | 7 | 4 | 5 | 4 | 3 | 24 | 12 | 16 | 12 | 5 |
| Neni 170/b Konkurrenca e paligjshme nëpërmjet dhunës | 2 | 1 | 3 | 1 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali | 15 | 7 | 8 | 7 | 4 | 29 | 13 | 17 | 13 | 6 |

TENDENCA

Sikurse vihet re nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka rritje të gjithë treguesve statistikorë në krahasim me vitin 2014 për veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare. Kështu numri i procedimeve penale të regjistruara, numri i procedimeve të dërguara për gjykim, numri i të pandehurve të regjistruar dhe numri i të pandehurve dërguar gjyqit, është rreth dy herë më i madh krahasuar me vitin 2014, ndërkohë që numri i të pandehurve të dënuar është rritur me 50 % për vitin 2015 përkundrejt vitit 2014.

Grafikisht tendenca e veprave penale të kryera në shoqëritë tregtare për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit, 93 % meshkuj kanë qenë të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) dhe 7 % femra.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 21 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 64 % me arsim të mesëm dhe 15 % të pandehur me arsim të lartë.

Nga sektori privat janë regjistruar 62 % e të pandehurve dhe 38 % e të pandehurve të regjistruar janë të papunë.

Rezulton se 85 % të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 15 % prej tyre në fshat. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në qytet.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se të gjithë rezultojnë të padënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Punësimi i paligjshëm


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare” në vitin 2015 është 83 %, ndërkohë që për vitin 2014 ka qenë 46,6 % .

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 170/a i Kodit Penal “Punësimi i paligjshëm”. Kështu në vitin 2015 janë regjistruar 24 procedime penale, kundrejt 7 procedimeve penale të regjistruara në vitin 2014 ose 3,4 herë më shumë.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me procedimet penale të regjistruara gjatë vitit 2014:



Sikurse vërehet edhe nga paraqitja grafike për këtë veprë penale numrin më të madh të procedimeve e ka regjistruar prokuroria e shkallës së parë Vlorë 5 procedime penale ose 21 % të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Tiranë, Berat, Sarandë e Elbasan kanë regjistruar nga 3 procedime penale ose 13 % të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Kukës ka regjistruar 2 procedime ose 8 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Durrës, Shkodër, Lezhë, Pukë, e Korçë kanë regjistruar nga 1 procedim penal ose 4 % të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, ndërsa prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar asnjë procedim gjatë vitit 2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 170/a i Kodit Penal “Punësimi i paligjshëm”.

VEPRA PENALE NË LIDHJE ME USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE BANKARE DHE FINANCIARE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,2 %, ndërsa për vitin 2014 është 0,18 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin V të Kreut të II të Kodit Penal:

| V.P. NË LIDHJE ME | 2014 | 2015 |
|-------------------|------|------|
| | | |


| USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE BANKARE E FINANCIARE | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar | | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
|---|----------------|----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|--|----------------|----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
| Neni 170/c | 5 | 4 | 3 | 4 | 3 | | 7 | 7 | 7 | 7 | 9 |
| Neni 170/ç | 58 | 27 | 45 | 27 | 21 | | 61 | 54 | 55 | 54 | 45 |
| Totali | 63 | 31 | 48 | 31 | 24 | | 68 | 61 | 62 | 61 | 54 |

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 8 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare, në krahasim me vitin 2014, ndërsa numri i të pandehurve regjistruar është rritur me 29 %. Rritje të konsiderueshme paraqesin numri i procedimeve të dërguara gjyqit dhe numri i të pandehurve dërguar gjyqit me 97 % ndërkohë që edhe për të pandehurit e dënuar nga gjykata rezulton rritje me 2,25 herë më shumë se në vitin 2014.

Në vitin 2015, në këtë grup veprash peshën më të madhe e ka neni 170/ç i Kodit Penal, “Ushtrimi pa licence i veprimtarive financiare”, që përbën 90 % të totalit të procedimeve të regjistruara për këtë grup. Për këtë veper vërehet tendenca në rritje me 5 % e numrit të procedimeve penale të regjistruara, krahasuar me vitin 2014.

Grafikisht tendenca e veprave penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare, për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2015 në total janë 81 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2014 në total kanë qenë 48 të pandehur në hetim. Pra kemi një rritje prej 68,7 % më shumë se në vitin 2014.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se nga sektori shtetëror nuk është regjistruar asnjë i pandehur, nga sektori privat janë regjistruar 61 % e të pandehurve dhe pjesa tjetër rezultojnë të papunë.

Rezultojnë se 81 % e të pandehurve janë me vendbanim në qytet ndërsa 19 % e tyre me vendbanim në fshat. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në qytet.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vetëm 4 % e të pandehurve rezultojnë të dënuar më parë për vepra penale të tjera.

KRIME NË FUSHËN E DOGANAVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,7 %, ndërsa për vitin 2014 është 0,67 %.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin V të Kreut të II të Kodit Penal:

| KRIME NË FUSHËN E DOGANAVE | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|--|----------------|----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|----------------|----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 171 Kontrabanda me mallra të ndaluar | 3 | 1 | 10 | 1 | 0 | 7 | 8 | 11 | 19 | 16 |
| Neni 172 Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë | 59 | 17 | 33 | 32 | 15 | 57 | 42 | 53 | 48 | 18 |
| Neni 173 Kontrabanda me mallra të licencuar | 3 | 1 | 2 | 1 | 0 | 6 | 5 | 10 | 9 | 6 |
| Neni 174 Kontrabanda me mallra të tjera | 73 | 36 | 42 | 45 | 32 | 72 | 44 | 63 | 67 | 47 |
| Neni 175 Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore | 2 | 1 | 6 | 1 | 1 | 1 | 0 | 4 | 1 | 2 |
| Neni 176 Kontrabanda e vlerave kulturore | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 177 Kontrabanda me mallra me regjim të ndërmjetëm | 2 | 0 | 1 | 0 | 0 | 21 | 12 | 12 | 12 | 6 |
| Neni 178 Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë | 65 | 23 | 46 | 28 | 8 | 41 | 19 | 37 | 26 | 25 |
| Neni 179 Ruajtja apo depozitimi i mallrave kontrabandë | 5 | 5 | 4 | 5 | 4 | 8 | 4 | 6 | 4 | 1 |
| Neni 179/a Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë | 15 | 6 | 8 | 6 | 2 | 20 | 11 | 12 | 11 | 8 |
| Totali | 227 | 90 | 152 | 119 | 62 | 233 | 145 | 208 | 197 | 129 |

TENDENCA

Sikurse vihet re nga të dhënat statistikore rezultojnë se në vitin 2015 ka një rritje të lehtë prej 2,6 % të numrit të procedimeve të regjistruara për krime në fushën e doganave në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi rritje prej 61 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 37 %, numri i të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit është rritur me 65,5 %, ndërsa numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është rritur me më shumë se dy herë krahasuar me vitin 2014.

Grafikisht tendenca e veprave penale në fushën e doganave për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve të regjistruar rezultojnë të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 95,2 % meshkuj dhe 4,7 % femra.

Rezultojnë 4 shtetas të huaj të pandehur për këtë grup veprash penale në vitin 2015. Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezultojnë se 36,6 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 55,8 % me arsim të mesëm dhe 7,6 % të pandehur me arsim të lartë.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2015 gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 3 të pandehur përkundrejt 12 të tillëve në vitin 2014. Të gjithë të pandehurit nën këtë seri statistikore janë “nëpunës të nivelit të mesëm” dhe vetëm 1 në nivel ekzekutiv.

Ndërkohë, sektori privat përbën dhe 67,6 % të numrit të të pandehurve të regjistruar.

Rezultojnë se 60,5 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 39,5 % prej tyre në fshat. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në qytet.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, vetëm 4 prej tyre janë përsëritës për të njëjtën veprë penale dhe 1 përsëritës në krim.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në vitin 2015 në grupin e krimeve në fushën e doganave është 24,5 %, ndërsa për vitin 2014 ky tregues ka qenë 26 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 172 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë”, në vitin 2015, prej 3 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen gjeografike të kësaj veprë sipas prokurorive të shkallës së parë ku ka patur procedime penale të regjistruara:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të kontrabandës me mallra të tjera është në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër, që përbën 30 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë e shkallës së parë Durrës janë regjistruar 26 % e procedimeve, në prokurorinë e shkallës së parë Korçë janë regjistruar 11 % e procedimeve, në prokurorinë e shkallës së parë Kukës janë regjistruar 9 % e procedimeve, në prokurorinë e shkallës së parë Pogradec janë regjistruar 5 % e procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Fier e Krujë janë regjistruar nga 2 procedime penale ose 4 % e procedimeve penale në shkallë vendi, në prokuroritë Dibër, Elbasan, Gjirokastrë, Lushnjë, sarandë, Tiranë e Vlorë është regjistruar respektivisht nga 1 procedim penal ose 2 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për veprën penale të parashikuar nga neni 172 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë”.

Kontrabanda me mallra të tjera


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Krime në fushën e doganave” është 31 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 31 %.

Nga të dhënat statistikore vihet re se procedimet penale të regjistruara për këtë veprë janë pthujse në të njëjtin nivel me vitin 2014, konkretisht në vitin 2015 janë regjistruar 72 procedime penale kundrejt 73 procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra të tjera”, në vitin 2014.


Kontrabanda me mallra me regjim të ndërmjetëm

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Krime në fushën e doganave” është 9 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 0,9 %. Pra vërehet tendencë rritje për këtë tregues gjatë vitit 2015.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të kësaj veprë sipas prokurorisë të shkallës së parë:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të kontrabandës me mallra të tjera është në prokuroritë e

shkallës së parë Shkodër që ka regjistruar 47 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe Vlorë që ka regjistruar 16 % të procedimeve. Në prokuroritë e shkallës së parë Durrës e Sarandë janë regjistruar nga 1 procedim penal ose 5 % e procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar për vitin 2015 asnjë procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 177 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra me regjim të ndërmjetëm”.

Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë


Në grupin e krimeve në fushën e doganave vihet re tendenca në ulje prej 37 % në vitin 2015 e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal “Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë”, ku kjo vepër ka një peshë prej 17,6 % në këtë grup ndërsa në vitin 2014 ka patur një peshë prej 28,6 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet se për vitin 2015 janë regjistruar 41 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal, “Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë” që përbën tendencë në ulje me 37 %, krahasuar me vitin 2014, në të cilin u regjistruan 65 procedime penale.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna mbi procedimet penale të regjistruara sipas prokurorive të shkallës së parë në vitin 2015:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të tregtimit dhe transportimit të mallrave që janë kontrabandë është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë ku janë regjistruar 13 procedime penale ose 32 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi. Në prokuroritë e shkallës së parë Pogradec e Shkodër janë regjistruar 5 procedime ose 12 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Korçë janë regjistruar nga 4 procedime ose 10 % e totalit të procedimeve penale, në prokurorinë e shkallës së parë Dibër janë regjistruar 3 procedime ose 7 % e totalit të procedimeve, në prokuroritë e shkallës së parë Berat, Durrës, Elbasan e Fier janë regjistruar nga 2 procedime ose 5 % e procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastrë, Pukë e Sarandë kanë regjistruar nga 1 procedim penal ose 3 %, ndërsa prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar gjatë vitit 2015 asnjë procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal.

VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME TAKSAT DHE TATIMET

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 1,75 %, ndërsa për vitin 2014 është 0,8 %. Pra vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun III, Seksionin e VI “Veprat penale në lidhje me taksat e tatimet” i Kodit Penal.


| VEPRA PENALE NË LIDHJE ME TAKSAT E TATIMET | 2014 | 2015 |
|--|------|------|
| | | |

| | Nr. Proecd Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proecd Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
|---|-----------------|-----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|-----------------|-----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
| Neni 180 Fshehja e të ardhurave | 192 | 46 | 114 | 53 | 19 | 487 | 257 | 357 | 280 | 198 |
| Neni 181 Mospagimi i taksave dhe tatimeve | 63 | 16 | 38 | 20 | 16 | 72 | 29 | 29 | 42 | 17 |
| Neni 181/a Moskryerja e detyrave nga organet tatimore | 3 | 1 | 1 | 1 | 0 | 1 | 0 | 10 | 0 | 0 |
| Neni 182 Ndryshimi në aparatet matëse | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 7 | 0 | 2 | 0 | 0 |
| Neni 182/a | 7 | 3 | 3 | 3 | 0 | 2 | 1 | 1 | 1 | 0 |
| Totali | 265 | 66 | 156 | 77 | 35 | 569 | 287 | 399 | 323 | 215 |

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 2 herë të numrit të procedimeve të regjistruara për “Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet” në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi rritje prej 4 herë të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re sërish rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 2,5 herë, rritje 4 herë e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata 6 herë më shumë përkundrejt vitit 2014.

Grafikisht tendenca e veprave penale në fushën e taksave dhe tatimeve për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit e regjistruar, të rritur (mbi 18 vjeç) janë 5,1 % femra dhe 94,8 % meshkuj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 32,9 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 52,1 % me arsim të mesëm dhe 15 % e të pandehurve me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim e mesëm.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori privat janë regjistruar 78 % e të pandehurve.

Rezulton se 66 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 34 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të pa dënuar më parë, vetëm 1,3 % e tyre janë përsëritës në krim.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Fshehja e të ardhurave


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet” është 86 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 72 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje 2,5 herë më shumë e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal “Fshehja e të ardhurave” në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për këtë veprë në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara në vitin 2015 në shkallë vendi:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të fshehjes së të ardhurave është në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër ku janë regjistruar 23 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan, ku janë regjistruar 16 % e procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Fier ku janë regjistruar nga 15 % e procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë ku janë regjistruar rreth 8 % e procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Tiranë, Berat e Dibër kanë regjistruar përkatësisht 7 %, 5 % dhe 5 % të numrit total të procedimeve dhe prokuroria e shkallës së parë Korçë ka regjistruar 3 % të numrit total të procedimeve. Prokuroritë e tjera kanë regjistruar më pak se 2 % të totalit të procedimeve penale ndërkohë që prokuroria e shkallës së parë nuk ka regjistruar në vitin 2015 asnjë procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal “Fshehja e të ardhurave”.

Mospagimi i taksave dhe i tatimeve


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet” është 13 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 24 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara në vitin 2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal “Mospagimi i taksave dhe i tatimeve”, prej 14% krahasuar me procedimet e regjistruara në vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për këtë veprë në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara në vitin 2015 në shkallë vendi:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për veprën penale të mospagimit të taksave dhe tatimeve është në prokurorinë e shkallës së parë Durrës ku janë regjistruar 31 procedime penale ose 43 % e tyre në shkallë vendi. Pastaj renditen prokuroria e shkallës së parë Vlorë që ka regjistruar 13 procedime penale, prokuroria e shkallës së parë Fier që ka regjistruar 6 procedime penale, prokuroritë e shkallës së parë Tiranë, Elbasan, Gjirokastrë e Lezhë që kanë regjistruar respektivisht nga 3 procedime penale, prokuroritë e shkallës së parë Kavajë, Korçë e Pogradec që kanë regjistruar nga 2 procedime penale. Prokuroritë Berat, Kukës, Pukë e Tropojë kanë regjistruar nga 1 procedim penal, ndërkohë që prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Krujë, Kurbin, Lushnjë, Mat, Përmet, Shkodër e Sarandë nuk kanë regjistruar asnjë procedim për vitin 2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

Ndryshimi në aparatet matëse

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet” është 1,2 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 0 %.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për këtë veprë në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara në vitin 2015 në shkallë vendi:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, prokuroria e shkallës së parë Korçë ka regjistruar 3 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 182 i Kodit Penal “Ndryshimi në aparatet matëse”. Prokuroritë e shkallës së parë Lushnje, Përmet, Pogradec e Tiranë kanë regjistruar respektivisht nga 1 procedim penal, ndërkohë që prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar asnjë procedim për këtë veprë gjatë vitit 2015.

FALSIFIKIMI I MONEDHAVE DHE LETRAVE ME VLERË

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 0,4 % ndërsa për vitin 2014 është 0,3 %. Pra, vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreu III, Seksioni VII “Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë” i Kodit Penal:

| FALSIFIKIMI I MONEDHAVE DHE LETRAVE ME VLERË | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|--|----------------|----------------------|-------------------|----------------------|------------------|----------------|----------------------|------------------|---------------------|------------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denu ar | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denu ar |
| Neni 183 Falsifikimi i monedhave | 108 | 20 | 39 | 25 | 32 | 133 | 36 | 52 | 37 | 23 |
| Neni 184 Falsifikimi i letrave me vlerë | 4 | 0 | 2 | 2 | 2 | 0 | 1 | 0 | 1 | 3 |
| Neni 185 Prodhimi i mjeteve për falsifikim | 0 | 1 | 3 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali | 112 | 21 | 44 | 28 | 35 | 133 | 37 | 52 | 38 | 26 |

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 19 % të numrit të procedimeve të regjistruara për grup veprat e “Falsifikimi i monedhave dhe i letrave me vlerë” në krahasim me vitin 2014 dhe rritje prej 76 % të procedimeve të dërguara për gjykim. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 18 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 36 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 26 % përkundrejt vitit 2014.

Grafikisht tendenca e veprave penale të falsifikimit të monedhave dhe letrave me vlerë për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit, 27,5 % kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj dhe asnjë femër; të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) kanë qenë 10 % femra dhe 90 % meshkuj.

Në lidhje me gjendjen shoqërore rezultojnë se 75 % e të pandehurve kanë qenë të papunë dhe pjesa tjetër nga sektori privat.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezultojnë se 42,5 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 50 % me arsim të mesëm dhe 6,5 % e të pandehurve me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve.

Rezultojnë se 75 % e të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 25 % prej tyre në fshat. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në qytet.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vetëm 10 % rezultojnë përsëritës në krim, pjesa tjetër e të pandehurve rezultojnë të padënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Falsifikimi i monedhave


Për vitin 2015 pesha specifike e kësaj vepre përbën tërësinë e grupit të veprave penale “Falsifikimi i monedhave dhe i letrave me vlerë”, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 96,4 % .

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 183 i Kodit Penal “Falsifikimi i monedhave”, në vitin 2015, prej 23 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 183 i Kodit Penal “Falsifikimi i monedhave”:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh procedimeve e ka regjistruar prokuroria e shkallës së parë Tiranë, numër që përbën 35 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 15 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Korçë ka regjistruar 8 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Fier e Sarandë kanë regjistruar 7 % të numrit total të procedimeve, prokuroria e shkallës së parë Durrës ka regjistruar 5 % të numrit total të procedimeve, prokuroria e shkallës së parë Elbasan ka regjistruar 4,5 % të procedimeve, prokuroritë e shkallës së parë Lezhë e Lushnje kanë regjistruar secila 3 % të procedimeve në shkallë vendi ndërsa prokuroritë e shkallës së parë Berat, Dibër, Gjirokastrë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Pogradec e Shkodër kanë regjistruar një numër procedimesh më të ulët se 2,3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Ndërkohë prokuroritë e shkallës së parë Kukës, Mat, Përmet, Pukë e Tropojë nuk kanë regjistruar asnjë procedim penal në vitin 2015, për veprën penale të parashikuar nga neni 183 i Kodit Penal “Falsifikimi i monedhave”.

FALSIFIKIMI I DOKUMENTEVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 përkundëjt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 3 %, ndërsa për vitin 2014 është 2,6 %. Pra, vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e VII të Kreut të III të Kodit Penal “Falsifikimi i dokumenteve”.


| FALSIFIKIMI I DOKUMENTEVE | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|--|----------------|----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|----------------|----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 186 Falsifikimi i dokumenteve | 523 | 147 | 161 | 225 | 140 | 565 | 159 | 167 | 245 | 156 |
| Neni 187 Falsifikimi i dokumenteve shkollore | 37 | 11 | 22 | 16 | 12 | 26 | 16 | 24 | 25 | 17 |
| Neni 188 Falsifikimi i dokumenteve shëndetësore | 3 | 1 | 0 | 1 | 1 | 2 | 1 | 2 | 1 | 1 |
| Neni 189 Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave | 186 | 69 | 86 | 74 | 54 | 217 | 107 | 138 | 122 | 74 |
| Neni 190 Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve | 97 | 46 | 62 | 100 | 69 | 132 | 78 | 96 | 87 | 55 |
| Neni 191 Falsifikimi i akteve të gjendjes civile | 24 | 7 | 9 | 8 | 6 | 17 | 9 | 6 | 12 | 9 |
| Neni 192 Prodhimi i mjeteve për falsifikim të dokumenteve | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 192/a Zhdukja dhe vjedhja e dokumenteve | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 0 | 1 | 0 |

| | | | | | | | | | | |
|---------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|
| Totali | 872 | 281 | 340 | 424 | 282 | 960 | 371 | 433 | 493 | 312 |
|---------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 10 % të numrit të procedimeve të regjistruara për grup veprat e falsifikimit të dokumenteve në krahasim me vitin 2014. Rritje ka pësuar edhe numri i procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014, me 32 %. Në lidhje me të pandehurit, vërehet sërish rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 27 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 16 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 11 % përkundrejt vitit 2014.

Grafikisht tendenca e veprave penale të falsifikimit të dokumenteve për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit, 16 % kanë qenë të pandehur femra (mbi 18 vjeç) dhe 84 % meshkuj.

Në vitin 2015 rezultojnë 39 shtetas të huaj të pandehur për këtë grup veprash penale, përkundrejt 45 të tillë në vitin 2014, që do të thotë ulje prej 13 % e këtij treguesi në vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve, rezulton se 34 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar 49 % me arsim të mesëm dhe 17 % e të pandehurve me arsim të lartë. Sikurse vihet re

faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, dhe një pjesë e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim të mesëm.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 12,7 % e të pandehurve. Nga këta, 18 % janë nëpunës të lartë 2,2 % janë nëpunës të mesëm, 4,5 % nëpunës të nivelit të ulët, 2,6 % nivel ekzekutues dhe 72,7 % e të pandehurve janë nëpunës të thjeshtë.

Nga sektori privat janë regjistruar 37,2 % e të pandehurve dhe pjesa tjetër e të pandehurve rezultojnë të papunë.

Rezulton se 78 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 22 % e të pandehurve në fshat. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në qytet.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Falsifikimi i dokumentave


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve” është 59 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 60 % .

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore vërehet rritje e e numrit të procedimeve të regjistruara për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014, me 8 %.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me numrin e procedimeve penale të regjistruara në vitet 2014 - 2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal “Falsifikimi i dokumenteve”, në prokuroritë e shkallës së parë:



Lidhur me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre në vitin 2015 grafiku në vijim paraqet të dhënat në përqindje sipas prokurorive:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh të procedimeve të regjistruara e ka prokuroria e shkallës së parë Tiranë, numër që përbën 26 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 15 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Elbasan e Durrës kanë regjistruar 8 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Shkodër ka regjistruar 6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Fier ka regjistruar 5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Korçë, Lezhë e Pogradec kanë regjistruar respektivisht 4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Sarandë ka regjistruar 3 % të procedimeve, prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastër, Kukës e Kurbini kanë regjistruar respektivisht 2 % të procedimeve penale, prokuroritë e shkallës së parë Mat, Berat, Krujë, Lushnje, Pukë, Përmet, Kavajë, Tropojë e Dibër kanë regjistruar një numër procedimesh më të ulët se 2 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi në vitin 2015, për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal “Falsifikimi i dokumenteve”.

Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Falsifikimi i Dokumenteve” për vitin 2015 është 23 %, ndërkohë që vitin 2014 është 21 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet se në vitin 2015 procedimet e regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 189 i Kodit Penal “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, kanë pësuar një rritje prej 17 % krahasuar me një vit më parë.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprën penale:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh të procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale e kanë prokuroria e shkallës së parë Tiranë, me 53 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, pas saj renditen prokuroritë e shkallës së parë Durrës e Shkodër që kanë regjistruar 10 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Fier e Elbasan kanë regjistruar 4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 3 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Berat, Dibër, Gjirokastër, Korçë, Krujë, Kukës, Kurbin, Lezhë, Lushnje, Përmet, Pogradec, Sarandë e Tropojë kanë regjistruar një numër procedimesh më të ulët se 3 %, ndërkohë që prokuroritë e shkallës së parë Kavajë, Mat e Pukë nuk kanë regjistruar asnjë procedim penal në vitin 2015, për veprën penale të parashikuar nga neni 189 i Kodit Penal “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”.

Falsifikimi i akteve të gjendjes civile

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Falsifikimi i akteve të gjendjes civile” është 1,7 % për vitin 2015, ndërkohë që për vitin 2014 rezulton 2,7 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore, vërehet ulje e ndjeshme e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 191 i Kodit Penal “Falsifikimi i akteve të gjendjes civile”, në vitin 2015, prej 29 % në krahasim me vitin 2014.

ZHVILLIMI I PALEJUAR I LOJRAVE TË FATIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 1 %, ndërsa për vitin 2014 është 2 %. Pra vihet re ulje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e III, seksioni X i Kodit Penal “Zhvillimi i palejuar i lojrave të fatit”.

| ZHVILLIMI I PALEJUAR I LOJËRAVE TË FATIT | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|---|----------------|----------------------|------------------|---------------------|-----------------|----------------|----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 197 Organizimi i llotarive të palejuara | 682 | 720 | 564 | 740 | 531 | 330 | 331 | 263 | 340 | 402 |
| Neni 197/a Paracaktimi i rezult. në garat sportive | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 197/b Shtrembërimi i konkurences ne garat sportive | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 198 Vënia në dispozicion e lokaleve për lojra të palejuara | 12 | 5 | 7 | 7 | 2 | 9 | 4 | 7 | 5 | 9 |
| Totali | 694 | 725 | 571 | 747 | 533 | 341 | 335 | 270 | 345 | 411 |

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një ulje të numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale zhvillimi i palejuar i lojrave të fatit, në krahasim me vitin 2014 me 51 %, ulje të numrit të procedimeve të dërguara për gjykim me 54 %, ulje të numrit të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale 53 % përkundrejt këtij totali në vitin 2014, ulje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit me 54 % dhe ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 23 % përkundrejt vitit 2014.

Grafikisht tendenca e veprave penale të zhvillimit të palejuar të lojrave të fatit për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit, 99 % kanë qenë të pandehur meshkuj të rritur (mbi 18 vjeç) dhe 1 % femra.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 42 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 53 % me arsim të mesëm dhe 5 % të pandehur me arsim të lartë.

Nga sektori privat janë regjistruar 81 % e të pandehurve ndërsa 19 % rezultojnë të papunë.

Rezulton se 61 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 39 % prej tyre në fshat. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në qytet.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më pare, vetëm 2 % janë përsëritës për të njëjtën vepër penale dhe 3 % e tyre rezultojnë të dënuar për krime.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Organizimi i llotarive të palejuara


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Zhvillimi i palejuar i lojrave të fatit” është 97 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 98,3 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal “Organizimi i llotarive të palejuara”, në vitin 2015, me 52 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara (në përqindje) në vitin 2015, për veprën penale të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal “Organizimi i llotarive të palejuara”:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh të procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale e kanë prokuroritë e shkallës së parë Tiranë e Elbasan që përbëjnë përkatësisht 18 % dhe 15 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Berat ka regjistruar 10 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Kurbin ka regjistruar 7 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Durrës e Tropojë kanë regjistruar respektivisht 6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Korçë, Lushnje e Vlorë kanë regjistruar 5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Fier, Gjirokastër, Kavajë, Lezhë e Shkodër kanë regjistruar 3 % të numrit total të procedimeve, ndërsa prokuroritë e tjera kanë regjistruar një numër procedimesh më të ulët se 3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe prokuroria e shkallës së parë Mat nuk ka regjistruar asnjë procedim penal në vitin 2015, për veprën penale të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal “Organizimi i llotarive të palejuara”.

VEPRA PENALE QË CËNOJNË REGJIMIN JURIDIK TË TOKËS

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 3,8 %, ndërsa për vitin 2014 ky tregues ka qenë 4,96 %. Pra vihet re ulje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin XI, të Kreut të II të Kodit Penal “Vepra Penale që çënojnë regjimin juridik të tokës”.


| REGJIMI JURIDIK I TOKËS | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|---|---------------------|------------------------------------|-----------------------------|-----------------------------------|-----------------------|------------------------|------------------------------------|----------------------------|----------------------------------|---------------------------|
| | Nr. Proce d Regj | Nr. proced per gjyki m | Nr. i pand · Regj. | Nr. Pand. Per gjyki m | Nr. Pand denuar | Nr. Proce d Regj | Nr. proced per gjyki m | Nr. i pand · Regj | Nr. Pand per gjyki m | Nr. Pand denua r |
| Neni 199 Shpërdorimi i tokës | 13 | 2 | 7 | 2 | 5 | 31 | 14 | 23 | 14 | 10 |
| Neni 199/a Ndertimi i paligjshëm | 1574 | 626 | 755 | 648 | 312 | 1092 | 954 | 793 | 960 | 766 |
| Neni 199/b Dhënia e ndihmës për ndërtim të paligjshëm ¹⁶ | | | | | | 7 | 1 | 48 | 12 | 5 |
| Neni 200 Pushtimi i tokës | 95 | 28 | 42 | 29 | 15 | 114 | 55 | 69 | 80 | 26 |
| Totali | 1682 | 656 | 804 | 679 | 332 | 1244 | 1024 | 933 | 1066 | 807 |

TENDENCA

¹⁶ Shtuar me ligjin 176/2014

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një ulje prej 26 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale që çënojnë regjimin juridik të tokës, në krahasim me vitin 2014 dhe rritje prej 56 % të procedimeve të dërguara për gjykim. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re rritje prej 16 % e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014, rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 60 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 2,4 herë përkundrejt vitit 2014.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër regjimit juridik të tokës për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve të regjistruar, rezultojnë të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 4 % femra dhe 96 % meshkuj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 36 % janë me arsim të mesëm, 5 % të pandehur me arsim të lartë dhe pjesa tjetër me arsim 9 vjeçar (59 % e të pandehurve). Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9 vjeçar.

Nga sektori privat janë regjistruar 40 % e të pandehurve dhe pjesa tjetër e të pandehurve janë të papunë (60 % e të pandehurve) ndërsa vetëm 1 (një) i pandehur rezulton nga sektori shtetëror, nivel i ulët i nëpunësit civil. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre

penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 47 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 53 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e tyre janë të padënuar më parë dhe më pak se 1 % e të pandehurve janë të dënuar.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Ndërtimi i paligjshëm

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale që çënojnë regjimin juridik të tokës është 88 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 93,6 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal “Ndërtimi i paligjshëm” në vitin 2015 prej 31 % në krahasim me vitin 2014, ndërsa numri i të pandehurve të regjistruar është rritur me 5 %. Numri i procedimeve të dërguara për gjykim është rritur 52 % dhe numri i të pandehurve të dërguar për gjykim është rritur me 48 %.


Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë vepër penale, tregojnë se 96 % e të pandehurve të rritur (mbi 18 vjeç) janë meshkuj dhe 4 % femra.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 63 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 33 % me arsim të mesëm dhe 4 % e të pandehurve me arsim të lartë. Përsa i përket


gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se nga sektori shtetëror janë regjistruar 0,5 % e të pandehurve, nga sektori privat 40 % dhe të papunë 59,5 %. Rezulton se 49 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 51 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, ndërsa me pak se 1 % rezultojnë të dënuar për vepra të tjera penale.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me numrin e procedimeve penale të regjistruara në vitet 2014 - 2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal “Ndërtimi i paligjshëm”, në prokuroritë e shkallës së parë:



Lidhur me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre në vitin 2015 grafiku në vijim paraqet të dhënat në përqindje sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale e ka prokuroria e shkallës së parë Tiranë, që përbën 24 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe prokuroria e shkallës së parë Elbasan që ka regjistruar 19 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Durrës ka regjistruar 10 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Shkodër ka regjistruar 9 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Berat ka regjistruar 8 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Fier e Vlorë kanë regjistruar respektivisht 4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Kavajë ka regjistruar 3 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Lezhë, Korçë, Kurbin, Krujë, Lushnje e Sarandë kanë regjistruar 2 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, ndërsa prokuroritë e tjera kanë regjistruar një numër procedimesh më të ulët se 1 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi gjatë vitit 2015, për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal “Ndërtimi i paligjshëm”.

VEPRA PENALE KUNDËR MJEDISIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,7 %, ndërkohë që për vitin 2014 është 0,8 %. Pra vihet re ulje e peshës specifike të këtij grupi veprash penale për vitin 2015.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun IV “Vepra penale kundër mjedisit”.

| VEPRA PENALE KUNDËR MJEDISIT | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|--|----------------|----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|----------------|----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 201 Ndotja e ajrit | 16 | 4 | 6 | 4 | 4 | 26 | 16 | 25 | 18 | 7 |
| Neni 202 Transportimi i mbeturinave toksike | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 203 Ndotja e ujërave | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 7 | 1 | 1 | 1 | 0 |
| Neni 204 Peshkim i ndaluar | 24 | 9 | 24 | 17 | 5 | 13 | 11 | 21 | 21 | 16 |
| Neni 205 Prerja e paligjshme e pyjeve | 205 | 46 | 140 | 57 | 39 | 146 | 44 | 101 | 48 | 32 |
| Neni 206 Prerja e drurëve dekorativ dhe frutorë | 19 | 3 | 5 | 3 | 1 | 14 | 7 | 9 | 7 | 4 |
| Neni 206/a Shkaterrimi me zjarr i pyjeve | 11 | 0 | 1 | 0 | 0 | 27 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 206/b Shkaterrimi nga pakujd. me zjarr i pyjeve | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 207 Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve | 3 | 0 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali | 280 | 62 | 180 | 81 | 50 | 235 | 79 | 157 | 95 | 59 |

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një ulje prej 16 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër mjedisit në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi rritje prej 27 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 13 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 17 % dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 18 % përkundrejt vitit 2014.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër mjedisit për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurit të regjistruar rezultojnë të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) të gjithë meshkuj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 79 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 20 % me arsim të mesëm dhe më pak se 1 % të pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Nga sektori privat janë regjistruar 49 % të pandehurve dhe të papunë rezultojnë të jenë 50 %. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 23 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 77 % prej tyre në fshat. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, vetëm 2 % prej tyre është përsëritës për vepra penale të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Ndotja e ajrit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër mjedisit” është 11 % për vitin 2015, ndërkohë që për vitin 2014 ka qenë 5,7 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 201 i Kodit Penal “Ndotja e ajrit” në vitin 2015, prej 63 % në krahasim me vitin 2013.

Prerja e paligjshme e pyjeve


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër mjedisit” është 62 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 73 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal “Prerja e paligjshme e pyjeve”, në vitin 2015 prej 29 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale në vitin 2015:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, prokuroria e shkallës së parë Korçë ka regjistruar numrin më të madh të procedimeve penale për këtë vepër, 30 të tilla ose 21 % të totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Elbasan ka regjistruar 23 procedime

penale ose 16 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi për këtë vepër. Prokuroria e shkallës së parë Lezhë ka regjistruar 10 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Shkodë ka regjistruar 9 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe prokuroritë e shkallës së parë Kukës e Pogradec kanë regjistruar 8 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Berat, Dibër, Durrës e Tiranë kanë regjistruar respektivisht 5 %, 4 %, 4 % dhe 3 % të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Fier, Gjirokastrë, Krujë, Lushnje, Mat, Tropojë e Vlorë kanë regjistruar një numër procedimesh më të ulët se 3 % e numrit total të procedimeve ndërkohë që prokuroritë e shkallës së parë Kavajë, Kurbin, Përmet, Pukë e Sarandë nuk kanë regjistruar asnjë procedim për vitin 2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal “Prerja e paligjshme e pyjeve”.

Shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër mjedisit” është 11 % për vitin 2015, ndërkohë që për vitin 2014 ka qenë 3,9 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 206/a i Kodit Penal “Shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor” në vitin 2015, me 2,5 herë në krahasim me vitin 2014.

KRIME KUNDËR PAVARËSISË E RENDIT KUSHTETUES
dhe
KRIME QË CËNOJNË MARRËDHËNIET ME SHTETET E TJERA

Pesha specifike që zënë krimet kundër rendit kushtetues dhe krimet që çënojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015, është 0,009 % ndërsa në vitin 2014 ka qenë 0,01 %.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat e detajuara në lidhje me këto vepra:

| KREU V- VI | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|--|-----------------------|-----------------------------|--------------------------|-----------------------------|------------------------|-----------------------|-----------------------------|-------------------------|----------------------------|------------------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Vepra Penale kundër Pavarësisë e Rendit Kushtetues | 4 | 1 | 1 | 1 | 1 | 2 | 1 | 1 | 1 | 1 |
| Vepra Penale që çënojnë Marrëdhëniet me Shtetet e tjera | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 | 0 |
| Totali | 5 | 1 | 1 | 1 | 1 | 3 | 2 | 2 | 2 | 1 |

VEPRA ME QËLLIME TERRORISTE

Pesha specifike që zënë veprat me qëllime terroriste në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2015 është 0,037 %, ndërsa në vitin 2014 ky tregues ka qenë 0,03 %.


| VEPRA PENALE ME QËLLIME TERRORISTE | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|---|----------------|----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|----------------|----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 230 Vepra me qëllime terroriste | 11 | 0 ¹⁷ | 2 | 0 | 0 | 6 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 230/a Financimi i terrorizmit | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 230/b Fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera, që financojnë terrorizmin | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 230/c Dhënia e informacioneve nga persona që ushtrojnë funksione publike ose në ushtrim të detyrës a profesionit | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 230/ç Kryerja e shërbimeve dhe veprimeve me persona të shpallur | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 231 Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 | 0 |
| Neni 232 Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terrorise | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 232/a Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 5 | 2 | 7 | 10 | 0 |
| Neni 232/b Kanosja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 233 Krijimi i turmave të armatosura | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 234 Prodhimi i armëve luftarake | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 234/a Organizata terroriste | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 234/b Banda e armatosur | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali | 11 | 0 | 2 | 0 | 0 | 12 | 3 | 8 | 11 | 0 |

¹⁷ 1 procedim penal me 7 të pandehur është dërguar për gjykim për kryerjen e veprave terroriste nga grup i strukturuar kriminal.

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore rezulton se totali i procedimeve të regjistruara për vepra penale me qëllime terroriste në vitin 2015 është 12 ndërsa në vitin 2014 janë regjistruar 11 procedime penale. Numri i procedimeve të dërguara për gjykim në vitin 2015 është 3 dhe numri i të pandehurve të dërguar për gjykim është 11.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër autoritetit të shtetit për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



Prokuroria për krime të rënda në vitin 2015 ka regjistruar 6 procedime penale për nenin 230 të Kodit Penal “Vepra me qëllime terroriste”, 5 procedime penale me 7 të pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 232/a i Kodit Penal “ Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste dhe 1 procedim penal me 1 të pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 231 i Kodit Penal “Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit”.

VEPRA PENALE TË KRYERA NGA BANDA E ARMATOSUR DHE ORGANIZATA KRIMINALE

Pesha specifike që zënë veprat penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori në vitin 2015 është 0,046 %, ndërsa në vitin 2014 ka qenë 0,038 %.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat e detajuara në lidhje me këto vepra:

| KRIMI I ORGANIZUAR | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|---|----------------|-----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|----------------|-----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Procd Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 333 Organizata kriminale | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 333/a Grupi i strukturuar kriminal | 13 | 2 | 38 | 13 | 0 | 14 | 7 | 40 | 47 | 6 |
| Neni 334 Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 |
| Totali | 13 | 2 | 38 | 13 | 0 | 15 | 7 | 41 | 47 | 6 |

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore rezulton se, në vitin 2015 janë regjistruar 15 procedime penale me 41 të pandehur për vepra penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale, 14 nga këto procedime për nenin 333/a, “Grupi i strukturuar kriminal”, ndërsa në vitin 2014 rezultojnë 13 procedime të regjistruara për këtë vepër penale. Të pandehur regjistruar për këto grup vepra gjatë vitit 2015 janë 41, ndërsa në vitin 2014 rezultojnë të regjistruar 38 të pandehur. Ndërkaq në vitin 2015, 7 procedime penale me 47 të pandehur janë dërguar për gjykim.

Grafikisht tendenca e veprave penale të krimit të organizuar për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit e regjistruar rezultojnë se pjesa më e madhe janë të rritur (mbi 18 vjeç) meshkuj dhe më pak se 3 % janë femra.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezultojnë se 65 % e të pandehurve janë me arsim të mesëm dhe 35 % me arsim 9-vjeçar.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se nga sektori privat janë regjistruar 82 % e të pandehurve 18 % e të pandehurve rezultojnë të papunë.

Lidhur me vendbanimin rezultojnë se 65 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 35% prej tyre në fshat.

Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në qytet.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë.

KRIME KUNDËR AUTORITETIT TË SHTETIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 2 %, shifër e njëjtë kjo me vitin 2014.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e VIII, “Krime Kundër Autoritetit të shtetit”.


| KRIME KUNDËR AUTORITETIT TË SHTETIT | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|---|----------------|----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|----------------|-----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proc. Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 235 Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik | 64 | 35 | 63 | 41 | 38 | 56 | 35 | 47 | 43 | 34 |
| Neni 236 Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik | 216 | 206 | 339 | 334 | 276 | 190 | 158 | 271 | 237 | 214 |
| Neni 237 Goditjet për shkak të detyrës | 115 | 89 | 124 | 107 | 93 | 109 | 96 | 103 | 107 | 109 |
| Neni 238 Kanosja për shkak të detyrës | 34 | 9 | 16 | 10 | 7 | 45 | 16 | 23 | 20 | 10 |
| Neni 242 Mosbindja ndaj urdhrat të punonjësit të policisë së rendit publik | 261 | 198 | 247 | 215 | 132 | 246 | 203 | 227 | 218 | 193 |
| Neni 243 Goditjet ndaj pjesëtarëve të familjes së personit që kryen një detyrë shtetërore | 2 | 1 | 2 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 246 Përvetësimi i titullit apo i | 6 | 2 | 4 | 2 | 2 | 11 | 5 | 6 | 5 | 2 |

| detyrës shtetërore | | | | | | | | | | |
|---|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|
| Neni 246/a Ushtrimi i profesionit të ekspertit kontabël dhe i shoqërisë audituese pa qenë i regjistruar | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 247 Mbajtja pa të drejtë e uniformës | 4 | 1 | 3 | 1 | 2 | 2 | 3 | 2 | 3 | 3 |
| Totali | 702 | 541 | 798 | 711 | 551 | 659 | 516 | 679 | 633 | 565 |

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një ulje prej 6 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Krime kundër autoritetit të shtetit” në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi ulje prej 4,6 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 15 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 11 % dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 2,5 % përkundrejt vitit 2014.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër autoritetit të shtetit për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit, rreth 2 % kanë qenë të pandehur të mitur. Të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) janë regjistruar 4 % femra dhe 94 % meshkuj.

Në këtë grup veprash janë dhe 2 të pandehur shtetas të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 52 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 40 % me arsim të mesëm dhe 8 % e të pandehurve me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj veprë penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 2 % e të pandehurve. Nga sektori privat janë regjistruar 28 % e të pandehurve dhe të papunë 70 %.

Rezulton se 57 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 43 % prej tyre në fshat. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në qytet.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 4 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme dhe më pak se 1 % të dënuar për të njëjtën vepër penale.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër autoritetit të shtetit” është 8,5 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 9 %.

Për këtë vepër vërehet tendenca në ulje gjatë vitit 2015 me 12,5 % krahasuar me vitin 2014.

Goditjet për shkak të detyrës


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër autoritetit të shtetit” është 16,5 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 16 %.

Për këtë vepër penale rezulton tendenca në ulje prej 5 % e procedimeve të regjistruara në vitin 2015 krahasuar me vitin 2014.

Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër autoritetit të shtetit” është 29 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 31 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 236 i Kodit Penal “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, në vitin 2015, prej 12 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale në vitin 2015:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale e kanë prokuroria e shkallës së parë Tiranë, që përbën 25 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Shkodër ka regjistruar 10 % të

numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Durrës ka regjistruar 8 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastrë e Berat kanë regjistruar respektivisht 7 % dhe 6 % të procedimeve në shkallë vendi, ndërsa prokuroritë e shkallës së parë Mat e Lezhë kanë regjistruar 5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, ndërsa prokuroritë e shkallës së parë Vlorë, Kukës, Elbasan e Fier kanë regjistruar në vitin 2015, një numër procedimesh që përbëjnë rreth 4 % të numrit total të procedimeve. Prokuroritë Dibër, Kavajë, Korçë, Krujë, Kurbin, Lushnje, Përmet, Pogradec e Tropojë kanë regjistruar një numër procedimesh më të ulët se 3 % ndërkohë që prokuroritë e shkallës së parë Pogradec e Pukë nuk kanë regjistruar asnjë procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 236 i Kodit Penal “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”.

Mosbindja ndaj urdhrimit të punonjësit të policisë së rendit publik


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Kundër autoritetit të shtetit” është 37 % për vitin 2015, tregues i njëjtë ky me vitin 2014.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal “Mosbindja ndaj urdhrimit të punonjësit të policisë së rendit publik”, në vitin 2015, prej 6 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale në vitin 2015:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale e kanë prokuroria e shkallës së parë Tiranë, që përbën 43 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Durrës ka regjistruar 7 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Shkodër ka regjistruar 5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Lezhë, Elbasan, Lushnje, Fier e Vlorë kanë regjistruar respektivisht, rreth 4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Korçë e Gjirokastrë kanë regjistruar 3 % të numrit total të procedimeve, ndërsa prokuroritë e shkallës së parë Berat, Dibër, Kavajë, Krujë, Kukës, Kurbin, Mat, Përmet, Pogradec, Pukë, Sarandë e Tropojë kanë regjistruar në vitin 2015 një numër procedimesh më të vogël se 3 % të procedimeve në shkallë vendit, për veprën penale të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal “Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik”.

VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA PUNONJËSIT SHTETËRORE OSE NË SHËRBIM PUBLIK

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 2,2 % ndërsa në vitin 2014 pesha e kësaj vepre ka qenë 2,4 %. Pra, vihet re ulje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreu VIII, Seksioni II, “Vepra Penale Kundër Veprimtarisë Shtetërore të Kryera nga Punonjësit Shtetërorë ose në Shërbim Publik”:


| VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA PUNONJËSIT SHTETËRORE OSE NË SHËRBIM PUBLIK | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|---|-----------------|-----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|------------------|-----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
| | Nr. Proc . Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proce d Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 248 Shpërdorim detyre | 705 | 102 | 264 | 226 | 114 | 607 | 129 | 240 | 286 | 140 |
| Neni 248/a Dhënia në kundërshtim me ligjin e pensioneve ose e të ardhurave të tjera nga sigurimet shoqërore | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 249 Kryerja e funksionit pas dhënies fund të tij | 2 | 0 | 1 | 0 | 0 | 1 | 1 | 0 | 1 | 1 |
| Neni 250 Kryerja e Veprimeve arbitrare | 45 | 6 | 13 | 11 | 7 | 40 | 9 | 18 | 17 | 10 |
| Neni 251 Mosmarrja e masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 252 Mbajtja në burg pa vendim | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 253 Shkelja e barazisë së shtetasve | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 254 Shkelja e paprekshmërisë së banesës | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 255 Pengimi dhe shkelja e fshehtësisë së korrespondencës | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 256 Shpërdorim i kontributeve të dhëna nga shteti | 1 | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 | 1 | 2 | 2 | 0 |
| Neni 257 Përfitim i paligjshëm i interesave | 2 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 |
| Neni 257/a Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimin, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurisë | 57 | 26 | 43 | 26 | 7 | 61 | 26 | 34 | 27 | 26 |
| Neni 258 Shkelja e barazisë në tendera apo ankande publike | 10 | 3 | 14 | 12 | 17 | 13 | 2 | 6 | 7 | 6 |
| TOTALI | 823 | 138 | 336 | 276 | 145 | 723 | 169 | 300 | 341 | 183 |

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një ulje prej 12 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik, në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi rritje prej 22 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 11 %, një rritje të numrit të të

pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 23,5 % dhe rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 26 % përkundrejt vitit 2014.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit, për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve të regjistruar, rezultojnë të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 12 % femra dhe 88 % meshkuj.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 73 % e të pandehurve gjithsej. Nga këta, 5 % janë funksionarë; 2,5 % nëpunës të nivelit të lartë; 24 % të pandehur janë nëpunës të nivelit të mesëm; 21 % janë nëpunës i nivelit të ulët; 45 % të pandehur janë funksionar të thjeshtë dhe 2,5 % prej tyre nivel ekzekutiv. Nga sektori privat janë regjistruar 17 % e të pandehurve.

Rezulton se 74 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 26 % prej tyre në fshat. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në qytet.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më pare.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Shpërdorim detyre


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në vitin 2014 në grupin e veprave penale “Vepra Penale Kundër Veprimtarisë Shtetërore të Kryera nga Punonjësit Shtetërorë ose në Shërbim Publik” është 84 %, ndërsa për vitin 2014 ky tregues ka qenë 85,6 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal “Shpërdorim detyre”, në vitin 2015, prej 14 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me numrin e procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër në vitet 2014 – 2015, sipas prokurorive të shkallës së parë:



Lidhur me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre në vitin 2015 grafiku në vijim paraqet të dhënat në përqindje sipas prokurorive:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh të procedimeve për këtë veprë penale e ka regjistruar prokuroria e shkallës së parë Tiranë, që përbën 25 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 10 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Elbasan e Lezhë kanë regjistruar nga 8 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Berat ka regjistruar 6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Durrës e Korçë kanë regjistruar 5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Fier e Dibër kanë regjistruar respektivisht 4 % të procedimeve penale ndërkohë që prokuroritë e shkallës së parë Kukës, Sarandë, Gjirokastër, Krujë, Lushnjë, Pukë, Mat, Kavajë, Pogradec, Përmet, Kurbini e Tropojë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 2 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi, ku numrin më të ulët gjatë vitit 2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal “Shpërdorim detyre”, 2 procedime, e ka regjistruar prokuroria e shkallës së parë Kukës.

Kryerja e veprimeve arbitrare

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Vepra Penale Kundër Veprimtarisë Shtetërore të Kryera nga Punonjësit Shtetërorë ose në Shërbim Publik” në vitin 2015 është 5,5 % tregues i njëjtë ky me vitin 2014.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal “Kryerja e veprimeve arbitrare”, në vitin 2015, prej 11 % në krahasim me vitin 2014.

Refuzimi për deklarin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarin


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë në vitin 2015 është 8,4 % ndërsa në vitin 2014 ka qenë 7 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në vitet 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal “Refuzimi per deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”. Kështu në vitin 2015 janë regjistruar 7 % më shumë procedime penale për këtë vepër.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen e procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale në prokuroritë e shkallës së parë në vitin 2015:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh të procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale e ka prokuroria e shkallës së parë Tiranë, që ka regjistruar 27 procedime ose 44 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Fier ka regjistruar 5 procedime penale ose 8 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Korçë e Sarandë kanë regjistruar nga 4 procedime penale ose 7 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Durrës, Elbasan, Gjirokastrë e Kukës kanë regjistruar nga 3 procedime penale ose 5 % të procedimeve, prokuroritë e shkallës së parë Berat, Lezhë e Shkodër kanë regjistruar nga 2 procedime penale ose 3 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Krujë ka regjistruar 1 procedim penal, ndërkohë që prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Kavajë, Kurbin, Lushnje, Mat, Përmet, Pogradec, Pukë, Tropojë e Vlorë nuk kanë regjistruar asnjë procedim gjatë vitit 2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”.

VEPRA PENALE KUNDËR RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 17 % ndërsa në vitin 2014 ka qenë 18,7 %. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun VIII, Seksioni III, Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike.

| VEPRA PENALE KUNDËR RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|--|----------------|----------------------|------------------|---------------------|-----------------|----------------|----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 261 Pengimi në ushtrimin e së drejtës për t'u shprehur, grumbulluar apo manifestuar | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 262 Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme | 8 | 2 | 9 | 8 | 4 | 8 | 3 | 8 | 8 | 8 |
| Neni 263 Organizimi i grumbullimeve e manifestimeve të paligjshme me pjesëmarrje të personave të armatosur | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 264 Detyrimi për të marrë pjesë ose jo në grevë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |


| | | | | | | | | | | |
|--|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|
| Neni 265 Nxitja e urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 2 | 1 |
| Neni 265/a Pjesëmarrja në veprime luftarake në një shtet të huaj | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 265/b Organizimi për pjesëmarrje në veprime luftarake në një shtet të huaj | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 265/c Thirrja për pjesëmarrje në veprime luftarake të dhunshme në një shtet të huaj | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 266 Thirrja për urrejtje nacionale | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 267 Përhapja e informatave të rreme që ngjallin panik | 3 | 0 | 1 | 0 | 0 | 14 | 4 | 5 | 5 | 3 |
| Neni 268 Poshtërimi i Republikës dhe i simboleve të saj | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 1 | 1 | 1 | 0 |
| Neni 269 Pengimi me dhunë i veprimtarisë së partive politike | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 |
| Neni 270 Rebelimi i të burgosurve | 2 | 2 | 4 | 4 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 |
| Neni 271 Disinformimi i ekipeve të urgjencës | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 272 Njoftimi i rremë në organet e rendit | 23 | 10 | 10 | 10 | 6 | 51 | 15 | 24 | 16 | 11 |
| Neni 273 Largimi nga vendi i aksidentit | 186 | 61 | 68 | 63 | 44 | 185 | 61 | 76 | 65 | 64 |
| Neni 274 Prishja e qetësisë publike | 95 | 59 | 86 | 67 | 40 | 96 | 48 | 86 | 80 | 59 |
| Neni 275 Përdor. me keqdashje i thirrj. Telefonike | 621 | 29 | 66 | 31 | 14 | 611 | 73 | 93 | 77 | 39 |
| Neni 276 Përdorimi pa të drejtë i emblemës së Kryqit të Kuq | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 277 Vetëgjyqësia | 202 | 89 | 143 | 115 | 51 | 189 | 129 | 150 | 171 | 126 |
| Neni 278 Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit | 755 | 473 | 597 | 530 | 469 | 604 | 359 | 436 | 413 | 343 |
| Neni 279 Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve të ftohta | 165 | 150 | 158 | 157 | 152 | 126 | 94 | 126 | 98 | 99 |
| Neni 280 Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve të gjuetisë dhe sportive | 122 | 91 | 112 | 99 | 73 | 69 | 59 | 63 | 62 | 68 |
| Neni 281 Shkelja e rregullave mbi lendët helmuese | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 282 Shkelja e rregullave mbi lendët plasëse, djegëse dhe radioaktive | 14 | 8 | 18 | 9 | 5 | 2 | 2 | 0 | 2 | 3 |

| | | | | | | | | | | |
|---|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| Neni 282/b Stërvitja për prodhimin dhe përd. e paligjshëm të armëve e lend. të tjera të rrezik. | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 283/b Krijimi i lehtësirave për marrjen dhe përd. e drogës | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 284/ç Prodhimi, tregëtimi dhe përdorimi i paligjshëm i prekursorëve | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 285/a Përshtatja e lokalit për përdorim droge | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 |
| Neni 285/b Hedhja ose braktisja e shiringave | 1 | 1 | 1 | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 |
| Neni 286 Nxitja për përdorimin e drogës | 2 | 0 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 286/a Përdorimi i paligjshëm i teknologjisë së lartë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 288 Prodhimi dhe shitja e ushqimeve dhe e lëndëve të tjera të rrezikshme për shëndetin | 5 | 1 | 4 | 1 | 0 | 7 | 1 | 4 | 1 | 1 |
| Neni 288/a Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industr. dhe ushqimorë | 17 | 8 | 18 | 9 | 3 | 23 | 19 | 23 | 20 | 17 |
| Neni 289 Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë | 77 | 12 | 32 | 15 | 5 | 91 | 16 | 55 | 21 | 12 |
| Neni 290 Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor | 632 | 263 | 524 | 271 | 233 | 737 | 354 | 616 | 366 | 262 |
| Neni 291 Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt | 3378 | 3393 | 3439 | 3426 | 3236 | 2737 | 2726 | 2782 | 2757 | 2676 |
| Neni 292 Shkelja e disiplinës së punës në transport | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 1 |
| Neni 293 Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit | 17 | 7 | 26 | 20 | 21 | 15 | 7 | 19 | 10 | 9 |
| Neni 293/d Shitja e paautorizuar e kartave SIM | | | | | | 5 | 4 | 4 | 4 | 3 |
| Totali | 6331 | 4659 | 5320 | 4836 | 4358 | 5581 | 3979 | 4575 | 4182 | 3809 |

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një ulje prej 12 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi ulje prej 15 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 14 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 14 % dhe ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 13 % përkundrejt vitit 2014.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër rendit dhe sigurisë publike për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Nga të pandehurit, 7 % kanë qenë të pandehur të mitur, nga të cilët 99 % meshkuj dhe 1 % femra. Nga të pandehurit e rritur (mbi 18 vjeç) kanë qenë 2 % femra dhe 98 % meshkuj.

Janë hetuar 22 të pandehur me shtetësi të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 55 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 39 % me arsim të mesëm dhe 6 % e të pandehurve me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar më pak se 1 % e të pandehurve. Nga sektori privat janë regjistruar 30 % e të pandehurve dhe të papunë 69 %.

Rezulton se 55 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 45 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më pare (97,6 % e tyre), vetëm 3 % prej tyre janë përsëritës në vepra penale të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Largimi nga vendi i aksidentit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” është 3,3 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 2,9 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore vërehet se procedimet e regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal "Largimi nga vendi i aksidentit", në vitin 2015 janë pothuajse në të njëjtin nivel me vitin paraardhës, konkretisht 186 procedime janë regjistruar në vitin 2014 dhe 185 procedime janë regjistruar në vitin 2015.

Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e "Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike" është 11 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 9,8 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal “Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike”, në vitin 2015, prej 1,6 % në krahasim me vitin 2014.

Vetëgjyqësia


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2015 është 3,4 %, ndërsa për vitin 2014 ka qenë 3,2 % .

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal “Vetëgjyqësia”, në vitin 2015, prej 6 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale në vitin 2015:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 26 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në vijim, në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë ku janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Fier, Kukës e Elbasan ku janë regjistruar respektivisht 7 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë ku janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokuroritë e shkallës së parë Durrës e Pukë është regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Shkodër, Gjirokastrë e Kurbin është regjistruar 4 % e procedimeve dhe në prokuroritë e shkallës së parë Berat, Dibër, Kavajë, Korçë, Krujë, Lushnjë, Mat, Përmet, Sarandë e Tropojë e Shkodër është regjistruar një numër procedimesh më i ulët se 3 % i numrit total të procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale. Ndërkohë që prokuroria e shkallës së parë Pogradec nuk ka regjistruar asnjë procedim për vitin 2015, për veprën penale të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal “Vetëgjyqësia”.

Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2015 është 11 %, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 11,9 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit” i Kodit Penal në vitin 2015, prej 20 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale në vitin 2015:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 15 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorië e shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 12 % e procedimeve penale, në prokurorinë e shkallës së parë për krime të rënda janë regjistruar 11 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi të cilat më pas janë dërguar për kompetencë në prokuroritë e shkallës së parë, në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Durrës janë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë janë regjistruar rreth 6 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Fier e Kurbin janë regjistruar përkatësisht 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Berat, Dibër, Gjirokastrë, Kavajë, Korçë, Krujë, Kukës, Lushnje, Mat, Përmet, Pogradec, Pukë, Sarandë e Tropojë, kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 3 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2015, ku numrin më të ulët me vetëm 1 procedim të regjistruar e ka prokuroria Përmet për nenin 278 të Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve ushtarake dhe municionit”.

Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2015 është 2,3 %, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 2,6 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 279 i Kodit Penal “Prodheri dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta”, në vitin 2015 prej 24 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale në vitin 2015:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 48 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Berat është regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Korçë janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 5 % e procedimeve në shkallë vendi dhe në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë janë regjistruar 4 % e procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Fier, Gjirokastrë, Krujë, Lushnjë, Mat, Sarandë, Tropojë e Vlorë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 3 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2015, dhe në prokuroritë e shkallës së parë Kavajë, Kukës, Kurbin, Përmet, Pogradec e Pukë nuk është regjistruar asnjë procedim penal për vitin 2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 279 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta”.

Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2015 është 1,2 %, ndërkohë që në vitin 2014 është 1,9 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”, në vitin 2015 prej 43 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale në vitin 2015:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale është në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë, që përbën 14 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër, janë regjistruar 12 % e procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale në shkallë vendi. Në prokuroritë e shkallës së parë Elbasan e Korçë janë regjistruar 10 % e procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë e Fier janë regjistruar 9 % e procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë janë regjistruar 6 % e procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale, në prokuroritë e shkallës së parë Berat e Lushnje janë regjistruar përkatësisht 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Durrës, Gjirokastrë, Krujë, Kukës, Kurbin, Mat, Përmet, Pogradec, Pukë e Sarandë janë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 3 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2015, ndërkohë që në prokuroritë e shkallës së parë Kavajë e Tropojë nuk është regjistruar asnjë procedim penal për vitin 2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”.

Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2015 është 1,6 %, ndërkohë që për vitin 2014 ka qenë 1,2 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”, në vitin 2015, prej 18 % në krahasim me vitin 2014.

Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2015 është 13 %, ndërkohë që për vitin 2014 ka qenë 10 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, në vitin 2015, prej 17 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me numrin e procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër në vitet 2014 – 2015, sipas prokurorive të shkallës së parë:



Lidhur me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre në vitin 2015 grafiku në vijim paraqet të dhënat në përqindje sipas prokurorive:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 21 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokuroritë e shkallës së parë Elbasan e Durrës janë regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Shkodër e Lezhë janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Vlorë e Korçë janë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Fier janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokuroritë e shkallës së parë Lushnje e Kurbin janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Berat, Kavajë e Krujë janë regjistruar përkatësisht rreth 3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, ndërsa në prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastër, Kukës, Sarandë, Pogradec, Mat, Tropojë, Dibër e Përmet kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 2 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2015, ndërkohë që prokuroria e shkallës së parë Pukë nuk ka regjistruar asnjë procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”.

Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2015 është 22% ndërsa në vitin 2014 ky tregues ka qenë 53,3 % .

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” në vitin 2015, prej 19 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara sipas prokurorive të shkallës së parë për vitin 2015:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë që përbën 32

% të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë e shkallës së parë Durrës janë regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Elbasan e Fier janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër është regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Lezhë, Vlorë e Lushnje janë regjistruar respektivisht rreth 5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Korçë janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe në prokuroritë e shkallës së parë Berat e Gjirokastrë janë regjistruar 3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Kavajë, Krujë, Kukës, Kurbin, Mat, Përmet, Pogradec, Pukë, Sarandë e Tropojë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 2 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2015, ndërkohë që numrin më të ulët të procedimeve për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, e ka regjistruar prokuroria e shkallës së parë Pukë.

VEPRA PENALE QË LIDHEN ME PASTRIMIN E PARAVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 përkundrajt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,75 %, ndërsa në vitin 2014 ky tregues ka qenë 0,6 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale.


| PASTRIMI I PARAVE | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|---|----------------|-----------------------|-------------------|----------------------|---------------|------------------|-----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pandenuar | Nr. Proc ed Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand enuar |
| Neni 287 Produktet e veprës penale ose veprimtarisë kriminale | 182 | 7 | 39 | 9 | 4 | 220 | 5 | 66 | 15 | 3 ¹⁸ |
| Neni 287/a Llogari anonime | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 287/b Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale | 25 | 22 | 58 | 52 | 34 | 23 | 12 | 46 | 35 | 32 |
| Totali | 208 | 29 | 97 | 61 | 38 | 245 | 17 | 112 | 50 | 35 |

¹⁸ Në vitin 2015 janë dënuar gjithsej 5 të pandehur por procedimi penal është regjistruar për vepra të tjera me marzh më të rëndë dënimi.

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 18 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale, në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi ulje prej 41 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re rritje e treguesve në krahasim me vitin 2014 i të pandehurve të regjistruar me 15 %, numri i të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit është ulur me 18 % dhe numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është ulur me 8 % përkundrejt vitit 2014.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër pastrimit të parave për 3 vitet e fundit paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve të regjistruar, rezultojnë të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 7 % femra dhe 93 % meshkuj. Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 4 shtetas të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 56 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 41 % me arsim të mesëm dhe 3 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore rezulton se 48 % e të pandehurve janë nga sektori privat dhe 52 % janë të papunë.

Rezulton se 60 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 40 % prej tyre në fshat. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në qytet.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më pare (98 % e të pandehurve) ndërsa vetëm 2 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprave penale për vitin 2015 është 90 % ndërsa për vitin 2014 ka qenë 87,5 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Gjatë vitit 2015 vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", prej 21 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara në vitin 2015 për këtë vepër penale:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 20 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 17 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Durrës është regjistruar 11 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Vlorë e Fier janë regjistruar 10 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Berat janë regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastrë e Korçë janë regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe në prokurorinë e shkallës së parë Lushnjë është regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Dibër e Sarandë kanë regjistruar numër të barabartë procedimesh që përbën 2 % të numrit të procedimeve të regjistruar për këtë veprë penale. Prokuroria e shkallës së parë Shkodër ka regjistruar 1 % të procedimeve penale në shkallë vendi, ndërsa prokuroritë e shkallës së parë Kavajë, Kukës, Mat e Tropojë kanë regjistruar një numër procedimesh që përbëjnë më pak se 1 % të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, ndërkohë që në prokuroritë e shkallës së parë Kurbin, Lezhë, Përmet e Pogradec nuk është regjistruar asnjë procedim për vitin 2015, për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”.

Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprave penale, në vitin 2015 është 19 %, ndërsa në vitin 2014 pesha e kësaj vepre brenda grupit ka qenë 12 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Gjatë vitit 2015 vërehet tendenca në ulje edhe e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 287/b i Kodit Penal “Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale”, prej 8 % në krahasim me vitin 2014.

VEPRA PENALE KUNDËR SEKRETIT DHE KUFIJVE SHETËTORË

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2015 është 1,3 %, ndërsa në vitin 2014 ka qenë 0,84 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale Kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë.


| VEPRA PENALE KUNDËR SEKRETIT DHE KUFIJVE SHETËTORË | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|--|----------------|----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|----------------|----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
| | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | |
|--|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|
| Neni 294 Tregtimi i sekretit shtetëror nga personi që i është besuar | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 295 Tregtimi i sekretit shtetëror nga shtetasit | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 295/a Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete | 3 | 1 | 0 | 1 | 1 | 3 | 0 | 1 | 1 | 0 |
| Neni 296 Humbja e dokumenteve sekrete | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 297 Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror | 207 | 124 | 199 | 136 | 91 | 360 | 262 | 347 | 279 | 204 |
| Neni 298 Ndhima për kalim të paligjshëm të kufirit | 74 | 27 | 93 | 44 | 24 | 66 | 34 | 71 | 55 | 62 |
| Neni 299 Shkelja e rregullave mbi fluturimet | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali | 286 | 152 | 292 | 181 | 116 | 429 | 296 | 419 | 335 | 266 |

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 50 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë, në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi rritje prej 95 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 43 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 85 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 129 % përkundrejt vitit 2014.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve të regjistruar, rezultojnë të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 2,7 % femra dhe 97,2 % meshkuj. Rezultojnë më pak se 1 % e të pandehurve të regjistruar të mitur meshkuj.

Të pandehur të huaj rezultojnë 38 në vitin 2015 dhe 26 të tillë në vitin 2014, që do të thotë ulje prej 46 % në krahasim me vitin 2014;

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 65 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 35 % me arsim të mesëm.

Nga sektori privat janë regjistruar 9 % e të pandehurve dhe 91 % të papunë. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 44 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 56 % prej tyre në fshat. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, vetëm 2 prej tyre është përsëritës për vepra penale të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë” në vitin 2015 është 84 %, ndërsa në vitin 2014 ky tregues ka qenë është 72 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror”, në vitin 2015, prej 74 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhënat lidhur me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale në prokuroritë që kanë regjistruar të dhëna për këtë vepër në vitin 2015:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale është në prokurorinë e shkallës së parë Sarandë, që përbën

24 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë është regjistruar 23 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Gjirokastrë është regjistruar 19 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër është regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Durrës është regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Pogradec e Dibër janë regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Korçë ka regjistruar një numër procedimesh që përbën 4 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2014, prokuroritë e shkallës së parë Vlorë e Kukës kanë regjistruar 2 % të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Përmet ka regjistruar 1 % të procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Berat ka regjistruar 1 procedim penal ose 0, 3 % të procedimeve penale në shkallë vendi, ndërsa prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar asnjë procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror” gjatë vitit 2015.

Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë” për vitin 2015 është 15 %, ndërsa për vitin 2014 ky tregues ka qenë 25 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal “Ndhimja për kalim të paligjshëm të kufirit”, në vitin 2015, prej 11 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale në ato prokurori ku janë regjistruar procedime për nenin 298 të Kodit Penal gjatë vitit 2015:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale është në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër, që përbën 23 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokuroritë e shkallës së parë Korçë e Tiranë janë regjistruar numër i njëjtë procedimesh që përbën 17 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Gjirokastrë është regjistruar 12 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokuroritë e shkallës së parë Vlorë e Elbasan janë regjistruar respektivisht 6 % e numrit total të procedimeve, në prokurorinë Durrës është regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Dibër e Përmet janë regjistruar 3 % e numrit total të procedimeve ndërsa në prokuroritë e shkallës së parë Berat, Fier, Krujë, Lushnjë e Sarandë është regjistruar respektivisht 1 procedim penal ose 2 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2015. Prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar asnjë procedim gjatë vitit 2015, për veprën penale të parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal “Ndhimja për kalim të paligjshëm të kufirit shtetëror”.

VEPRA PENALE KUNDËR DREJTËSISË

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 1 % ndërsa për vitin 2014 ka qenë 1,2 %. Pra vihet re ulje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e IX “Vepra penale kundër drejtësisë”:


| VEPRA PENALE KUNDËR DREJTËSISË | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|---|----------------|----------------------|-------------------|----------------------|------------------|----------------|----------------------|------------------|---------------------|------------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denu ar | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denu ar |
| Neni 300 Moskallëzimi i krimit | 14 | 16 | 72 | 102 | 75 | 26 | 22 | 112 | 118 | 100 |
| Neni 301 Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës | 9 | 4 | 21 | 17 | 12 | 6 | 6 | 9 | 13 | 8 |
| Neni 302 Përkrahja e autorit të krimit | 4 | 6 | 12 | 15 | 9 | 4 | 4 | 14 | 12 | 9 |
| Neni 303 Fshehja ose asgjësimi i kufomës | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | | | | | |
| Neni 304 Detyrimi për të kallzuar provën | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | | | | | |
| Neni 305 Kallëzimi i rremë | 46 | 43 | 42 | 51 | 38 | 55 | 65 | 51 | 67 | 53 |
| Neni 305/a Deklaratat e rreme përpara prokurorit | 0 | 0 | 0 | 1 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 0 |
| Neni 305/b Deklaratat e rreme përpara of.pol.gjyq. | 21 | 23 | 30 | 35 | 19 | 28 | 33 | 41 | 58 | 45 |
| Neni 306 Dëshmia e rreme | 39 | 30 | 45 | 36 | 24 | 23 | 25 | 37 | 30 | 23 |
| Neni 307 Refuzimi për të dëshmuar | 1 | 1 | 1 | 1 | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 | 0 |
| Neni 308 Përkthimi i rremë | | | | | | | | | | |
| Neni 309 Ekspertimi i rremë | 19 | 2 | 0 | 2 | 1 | 29 | 1 | 2 | 2 | 2 |
| Neni 310 Mosparaqitja e dëshmitarit, ekspertit apo përkthyesit | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4 | 0 | 4 | 0 | 0 |
| Neni 311 Kanosja për të mos kallzuar | 10 | 2 | 6 | 3 | 1 | 5 | 3 | 4 | 3 | 2 |
| Neni 312/a Kanosja për deklarime a dëshmi, ekspertim ose përkthim të rremë | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 | 5 | 1 | 3 | 1 | 1 |
| Neni 313 Fillimi i paligjshëm i ndjekjes penale | | | | | | | | | | |
| Neni 313/a Zhdukja ose humbja e fashikullit | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 313/b Ndalimi i dhënies dhe i shpalljes së të dhënave në kundërshtim me ligjin | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | | | | | |
| Neni 314 Përdorimi i dhunës gjatë hetimeve | 2 | 0 | 1 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 316 Kundërshtimi dhe goditja e gjyqtarit | 5 | 3 | 7 | 6 | 4 | | 1 | | 1 | 1 |
| Neni 317 Kanosja e gjyqtarit | 4 | 3 | 3 | 3 | 2 | 11 | 2 | 7 | 2 | 2 |
| Neni 318 Fyerja e gjyqtarit | 1 | 2 | 0 | 3 | 1 | 6 | 0 | 1 | 0 | 0 |
| Neni 320 Pengime për ekzekutimin e e vendimeve të gjykatës | 100 | 26 | 46 | 32 | 14 | 81 | 38 | 44 | 41 | 33 |
| Neni 320/a Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura i vendimit të gjykatës | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 1 | 0 | 2 | 2 |
| Neni 321 Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës | 107 | 79 | 98 | 79 | 53 | 86 | 77 | 75 | 77 | 79 |

| | | | | | | | | | | |
|--|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|
| Neni 322 Prishja e vulave dhe shenjave | | | | | | 1 | 1 | 1 | 1 | 0 |
| Neni 323 Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit | 29 | 19 | 28 | 29 | 16 | 45 | 38 | 49 | 39 | 27 |
| Neni 324 Dhënia ndihmë një të burgosuri për largim | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 |
| Totali | 415 | 259 | 413 | 415 | 272 | 333 | 224 | 272 | 260 | 217 |

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezultojnë se në vitin 2015 ka një ulje prej 20 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër drejtësisë në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi ulje prej 13,5 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 34 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 37 %. Numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është ulur me 20 % krahasuar me vitin 2014.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër drejtësisë për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve të regjistruar, rezultojnë të pandehur të rritur 94% (mbi 18 vjeç) nga të cilët 10 % femra dhe 90 % meshkuj. Rezultojnë 6 % e të pandehurve të regjistruar të mitur, nga të cilët 81 % meshkuj dhe 19 % femra.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 60 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 34 % me arsim të mesëm dhe 6 % e të pandehurve me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar më pak se 1 % e të pandehurve. Nga sektori privat janë regjistruar 28 % e të pandehurve dhe të papunë 71 %.

Rezulton se 61 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 49 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, vetëm 7 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.


Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Kallëzimi i rremë


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në vitin 2015 në grupin e veprave penale “Kundër drejtësisë” është 16,5 %, ndërsa për vitin 2014 ky tregues përbënte 11 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal “Kallëzimi i rremë”, në vitin 2015, prej 20 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen e procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë sipas rretheve:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 24 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokuroritë e shkallës së parë Korçë janë regjistruar 16 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 11 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës së parë Durrës janë regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Dibër e Elbasan kanë regjistruar nga 7 % të totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastrë, Krujë, Kurbin e Pukë kanë regjistruar përkatësisht nga 2 procedime ose 4 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2015, prokuroritë e shkallës së parë Fier, Kavajë, Lezhë, Lushnje, Mat e Shkodër kanë regjistruar nga 1 procedim penal ose 2 % të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, ndërkohë që prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar asnjë procedim penal për vitin 2015, për veprën penale të parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal “Kallëzimi i rremë”.

Ekspertimi i rremë


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Kundër drejtësisë” për vitin 2015 është 8,7 %, ndërsa për vitin 2014 ky tregues ishte 4,6 %. Pra vërehet rritje e këtij treguesi për vitin 2015.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje edhe për procedimet e regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal “Eksportimi i rremë”, në vitin 2015, prej 53 % në krahasim me vitin 2014.

Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër drejtësisë” për vitin 2015 është e njëjtë me vitin 2014 në vlerën 24 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal “Pengime për ekzekutimin e vendimit të gjykatës”, në vitin 2015, prej 19 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale sipas prokurorisë që kanë regjistrime për këtë vepër penale në vitin 2015:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 33 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë janë regjistruar 10 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Durrës e Elbasan janë regjistruar përkatësisht 9 % dhe 7 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Fier e Vlorë kanë regjistruar 6 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Berat, Gjirokastrë e Korçë kanë regjistruar përkatësisht nga 5 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Sarandë ka regjistruar 4 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2015, prokuroritë e shkallës së parë Krujë e Mat kanë regjistruar 2,5 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Kavajë, Kukës, Lushnje e Shkodër kanë regjistruar 1 % të procedimeve dhe prokuroritë e shkallës së parë Dibër, Kurbin, Përmet, Pogradec, Pukë e Tropojë nuk kanë regjistruar asnjë procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal “Pëngime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”.

Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Kundër drejtësisë” për vitin 2015 është 26 %, ndërsa në vitin 2014 pesha që zinin procedimet e regjistruara për këtë veprë përbënte 25,7 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në uljeje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 321 i Kodit Penal “Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës”, në vitin 2015, prej 20 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale në vitin 2015:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i madh i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale është në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, që përbën 29 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Në prokurorinë e shkallës së parë Durrës është regjistruar 16 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë e shkallës

së parë Korçë është regjistruar respektivisht 9 % e procedimeve penale. Në prokurorinë e shkallës së parë Lushnje është regjistruar 7 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Berat, Fier e Vlorë janë regjistruar një numër procedimesh që përbën 6 % të totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2015, në prokuroritë e shkallës së parë Mat, Sarandë e Shkodër janë regjistruar i njëjti numër procedimesh që përbën 3 % të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Dibër e Elbasan janë regjistruar përkatësisht nga 2 procedime penale ose 2 % e procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë e Pogradec janë regjistruar përkatësisht nga 1 procedim penal ose 1 % e procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për veprën penale të parashikuar nga neni 321 i Kodit Penal “Veprime në kundërshtim me vendimet e gjykatës”, në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastrë, Kukës, Përmet, Pukë e Tropojë nuk kanë regjistruar asnjë procedim penal për këtë vepër gjatë vitit 2015.

VEPRA PENALE QË PREKIN ZGJEDHJET E LIRA DHE SISTEMIN DEMOKRATIK TË ZGJEDHJEVE

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e X, “Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve”.

| VEPRAT PENALE PËR ZGJEDHJET E LIRA | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|--|----------------|----------------------|------------------|---------------------|-----------------|----------------|----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 325 Pengimi i subjekteve zgjedhore | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 | 6 | 0 | 1 | 0 | 0 |
| Neni 326 Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve | 0 | 1 | 0 | 8 | 0 | 4 | 2 | 0 | 21 | 0 |
| Neni 327 Shkelja e fshehtësisë së votimit | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 327/a Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar | 0 | 1 | 0 | 6 | 6 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 |
| Neni 328/a Detyrimi për pjesëmarrje në veprimtari politike | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 329 Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 | 4 | 1 | 4 | 2 | 2 |
| Neni 330 Pengimi i zgjedhësit | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 330/a Braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve | 1 | 0 | 6 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 331 Shkelja e të drejtës së zgjedhjes | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 332 Shpërdorimi i autoritetit ushtarak | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali | 1 | 2 | 6 | 14 | 13 | 14 | 3 | 5 | 23 | 3 |

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, gjatë vitit 2015 janë regjistruar 14 procedime penale për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve dhe 5 të pandehur. Janë dërguar për gjykim 3 procedime penale, me 23 të pandehur dhe janë dënuar nga gjykata 3 të pandehur.

Procedimet penale janë regjistruar përkatësisht:

6 procedime për veprën penale të parashikuar në nenin 325 të Kodit Penal, “Pengimi i subjekteve zgjedhore”;

4 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 326 i Kodit Penal “Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve” dhe 2 procedime për këtë vepër janë dërguar për gjykim;

4 procedime për veprën penale të parashikuar në nenin 329 të Kodit Penal, “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje” dhe 1 procedim penal për këtë vepër është dërguar për gjykim.

TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim.

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve të regjistruar, rezultojnë të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) vetëm meshkuj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 11 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 66 % me arsim të mesëm dhe 23 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori privat janë regjistruar 75 % e të pandehurve dhe të papunë 25 %.

Rezulton se 78 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 22 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë.

VEPRAT PENALE TË KORRUPSIONIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 0,65 % ndërsa për vitin 2014 ka qenë 0,42 %.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të korrupsionit.


| VEPRA PENALE KUNDËR | 2014 | 2015 |
|---------------------|------|------|
| | | |

| KORRUPSIONIT | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand . Per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proc. Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
|--|----------------|----------------------|-------------------|-----------------------|-----------------|----------------|-----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
| Neni 124/a Kërkimi ose marrja e shpërblimeve për procedurat e birësimit | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 |
| Neni 164/a Korrupsion aktiv në sektorin privat | 1 | 0 | 1 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 164/b Korrupsion pasiv në sektorin privat | 2 | 1 | 0 | 2 | 2 | 4 | 0 | 10 | 0 | 0 |
| Neni 244 Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike | 21 | 12 | 22 | 20 | 7 | 58 | 47 | 59 | 49 | 40 |
| Neni 244/a Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publikë | 1 | 1 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 |
| Neni 245 Korrupsion aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 |
| Neni 245/1 Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike | 24 | 15 | 25 | 31 | 14 | 23 | 19 | 32 | 40 | 26 |
| Neni 259 Korrupsion pasiv i personave me funksione publike | 82 | 19 | 52 | 29 | 14 | 89 | 19 | 62 | 26 | 17 |
| Neni 259/a Korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë | | | | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 260 Korrupsion pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë | 3 | 0 | 4 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 1 | 1 |
| Neni 312 Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 |
| Neni 319 Korrupsion aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë | 1 | 0 | 0 | 3 | 1 | 7 | 0 | 9 | 0 | 0 |
| Neni 319/a Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 319/b Korrupsioni aktiv i arbitrit vendas dhe të huaj | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 319/c Korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 319/ç Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë | 7 | 3 | 2 | 7 | 3 | 25 | 2 | 9 | 3 | 2 |
| Neni 319/d Korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 319/dh Korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 319/e Korrupsioni pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 328 Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 | 0 | 1 | 0 | 0 |
| Totali | 143 | 51 | 108 | 94 | 42 | 213 | 89 | 184 | 121 | 88 |

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 49 % të numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale të korrupsionit, në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi rritje prej 75 % të procedime të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 70 %, një rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 29 % dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 110 % përkundrejt vitit 2014.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër korrupsionit për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve të regjistruar, rezultojnë të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 12 % femra dhe 88 % meshkuj. Gjatë vitit 2015 janë regjistruar 2 shtetas të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 16 % e të pandehurve janë me arsim deri 9 vjeçar, 42 % janë me arsim të mesëm dhe 42 % të pandehur me arsim të lartë.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 50 % e të pandehurve. Nga këta, 36 % janë nëpunës të nivelit të lartë; 25 % nëpunës të nivelit të mesëm, 4,5 % nëpunës të nivelit të ulët; dhe 32 % janë nëpunës të thjeshtë, nivel ekzekutues 2,5 %.

Nga sektori privat janë regjistruar 35 % e të pandehurve dhe 15 % prej tyre rezultojnë të papunë.


Rezulton se 79 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 21 % prej tyre në fshat. Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në vitin 2015 në grupin e veprave penale të korrupsionit është 27 %, ndërsa në vitin 2014 pesha që zinte kjo vepër ka qenë 15 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Për vitin 2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, organi i prokurorisë ka regjistruar 58 procedime penale, që përbën rritje 2,7 herë ose 176 % në krahasim me vitin 2014. Janë dërguar për gjykim 47 procedime penale ndërsa në vitin 2014 rezultojnë 12 procedime të dërguara për gjykim. Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, vihet re rritje 168 % e numrit të të pandehurve të regjistruar dhe një rritje prej 145 % e numrit të të pandehurve dërguar për gjykim krahasuar me vitin 2014. Edhe numri i të pandehurve të dënuar në vitin 2015 është rritur 5,7 herë krahasuar me një vit më parë.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në përqindje mbi shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për këtë vepër penale:




Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh të procedime të regjistruara për këtë vepër e ka prokuroria e shkallës së parë Tiranë 36 procedime penale ose 62 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Korçë ka regjistruar 5 procedime penale ose 8,6 % të totalit të procedimeve, prokuroritë e shkallës së parë Elbasan e Vlorë kanë regjistruar përkatësisht nga 3 procedime ose 5 % të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Durrës, Lezhë e Shkodër kanë regjistruar përkatësisht nga 2 procedime ose 3 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, prokuroritë e shkallës së parë Berat, Dibër, Fier e Kurbin kanë regjistruar përkatësisht nga 1 procedim ose 2 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, ndërkohë që prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar asnjë procedim penal gjatë vitit 2015.

Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në vitin 2015 në grupin e veprave penale të korrupsionit është 12 %, ndërsa në vitin 2014 pesha që zinte kjo vepër ka qenë 16,7 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore vërehet një tendencë e lehtë në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal “Ushtimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, në vitin 2015, prej 4 % në krahasim me vitin 2014.

Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale të korrupsionit për vitin 2014 është 42 %, ndërsa për vitin 2014 ka qenë 57,3 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, në vitin 2015, prej 8,5 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në përqindje mbi shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për këtë vepër penale:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale e ka prokuroria e shkallës së parë Tiranë, 23 procedime që përbëjnë 26 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Elbasan ka regjistruar 20 procedime ose 22 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 8 procedime ose 9 % të numrit total të procedimeve, prokuroritë e shkallës së parë Fier, Korçë e Shkodër kanë regjistruar 6 procedime ose 7 % të numrit total të procedimeve, prokuroria e shkallës së parë Lushnje ka regjistruar 5 procedime ose 6 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Lezhë ka regjistruar 3 procedime ose 3 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Durrës e Kukës kanë regjistruar respektivisht nga 2 procedime ose 2 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Berat, Kurbin, Mat e Pogradec kanë regjistruar nga 1 procedim penal ose 1 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i personave me funksione publike”, ndërkohë që prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar asnjë procedim penal gjatë vitit 2015.

Korrupsioni aktiv e pasiv i funksionarëve të lartë shtetëror ose i të zgjedhurve vendor

Gjatë vitit 2015 është regjistruar 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, ndërsa në vitin 2014 nuk ka patur asnjë procedim të regjistruar për këtë veprë. Janë regjistruar 2 procedime penale për nenin 260 të Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, ndërkohë që në vitin 2014 rezultojnë 3 procedime të regjistruara.


Korrupsioni aktiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë

Për vitin 2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 319 i Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, organi i prokurorisë ka regjistruar 7 procedime penale me 9 të pandehur, ndërkohë që në vitin 2014 rezulton i regjistruar 1 procedim penal.

Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale të korrupsionit për vitin 2015 është 12 %, ndërsa për vitin 2014 ka qenë 4,9 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e numrit të procedimeve të regjistruara në vitin 2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”. Konkretisht organi i

prokurorisë ka regjistruar 25 procedime penale me 9 të pandehur, ndërkohë që në vitin 2014 janë regjistruar 7 procedime me 2 të pandehur. Janë dërguar për gjykim 2 procedime penale me akuzë ndaj 3 të pandehurve dhe nga gjykata ka përfunduar gjykimi dhe janë dënuar 2 të pandehur për vitin 2015 për këtë vepër penale.

KRIMI KIBERNETIK

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 është 0,4 % ndërsa për vitin 2014 ky grup veprash përbënte 0,37 % të numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

| KRIMI KIBERNETIK | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|--|----------------|----------------------|------------------|---------------------|-----------------|----------------|----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 74/a Shpërndarja kompjuterike e materialeve komp. pro genocitit ose krimeve kunder njerëzimit | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 84/a Kanosja me motive racizmi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 |
| Neni 119/a Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 119/b Fyerja me motive racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sist. kompj. | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 143/b Mashtrimi kompjuterik | 51 | 2 | 3 | 3 | 2 | 60 | 2 | 3 | 2 | 4 |
| Neni 186/a Falsifikimi kompjuterik | 27 | 4 | 18 | 20 | 0 | 18 | 2 | 1 | 2 | 0 |
| Neni 192/b Hyrja e paautorizuar kompjuterik | 12 | 0 | 0 | 0 | 3 | 8 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 293/a Përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterik | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 293/b Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike | 29 | 0 | 0 | 0 | 0 | 46 | 2 | 1 | 2 | 1 |
| Neni 293/c Ndërhyrja në sistemet kompjuterike | 3 | 0 | 0 | 2 | 0 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 293/ç Keqpërdorimi i pajisjeve | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali | 125 | 6 | 21 | 25 | 5 | 136 | 6 | 6 | 6 | 5 |


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale kundër krimit kompjuterik për vitet 2014 e 2015.

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 8,8 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër krimit kompjuterik

në krahasim me vitin 2014 ndërsa numri i procedimeve të dërguara për gjykim është në të njëjtin nivel. Treguesit për të pandehurit gjatë vitit 2015 rezultojnë me ulje dhe përkatësisht, kemi ulje prej 71 % të numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014, ulje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 76 % në krahasim me vitin 2014.

Grafikisht tendenca e krimit kibernetik për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit, të rritur (mbi 18 vjeç) 11 % femra dhe 89 % meshkuj. Rezulton vetëm një i pandehur i mitur mashkull. Në vitin 2015 është regjistruar 1 i pandehur i huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 37,5 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 37,5 % me arsim të mesëm dhe 25 % të pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim të mesëm dhe 9 vjeçar.

Rezulton se të gjithë të pandehurit kanë vendbanimin në qytet. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani të këtij fenomeni në qytet.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Mashtrimi kompjuterik


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër krimit kompjuterik” për vitin 2015 është 44 %, ndërsa për vitin 2014 ka qenë 40,8 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 143/b i Kodit Penal “Mashtrimi kompjuterik” në vitin 2015, prej 17,6 % në krahasim me vitin 2014.

Shpërndarja gjeografike e procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale për vitin 2015, paraqitet më poshtë:




Siç vërehet nga paraqitja grafike, prokuroria e shkallës së parë Tiranë ka regjistruar numrin më të madh të procedimeve për këtë veprë penale, duke përbërë 80 % të totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Durrës ka regjistruar 3 procedime penale ose 5 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këtë veprë në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Elbasan e Shkodër kanë regjistruar nga 2 procedime penale ose 3 % të totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastrë, Fier, Kavajë, Mat e Pukë kanë regjistruar nga 1 procedim penal ose 2 % të totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroritë e tjera nuk kanë regjistruar asnjë procedim gjatë vitit 2015 për veprën penale neni 143/b i Kodit Penal “Mashtrimi kompjuterik”.

Falsifikimi kompjuterik


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Kundër krimit kompjuterik” është 13 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 21,6 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 186/a i Kodit Penal “Falsifikimi kompjuterik”, me 33 % në vitin 2015 krahasuar me procedimet penale të regjistruara në vitin 2014.

Shpërndarja gjeografike e procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale për vitin 2015, paraqitet më poshtë:




Siç vërehet nga paraqitja grafike, prokuroria e shkallës së parë Elbasan ka regjistruar numrin më të madh të procedimeve për këtë veprë penale 7 të tilla, duke përbërë 39 % të totalit të

procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroria e shkallës së parë Tiranë ka regjistruar 3 procedime penale ose 17 % të totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastrë, Lezhë, Fier, Pogradec, Lushnje, Durrës e Berat kanë regjistruar nga 1 procedim penal ose 6 % të totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi gjatë vitit 2015, për veprën penale të parashikuar nga neni 186/a i Kodit Penal “Falsifikimi kompjuterik”.

Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Kundër krimit kompjuterik” është 34 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 23 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara në vitin 2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 293/b i Kodit Penal “Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike”, me 59 % krahasuar me procedimet penale të regjistruara në vitin 2014.

TRAFIQET E PALIGJSHME

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 1,2 % ndërsa në vitin 2014 ka qenë 1,3 %. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.


Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale kundër trafikëve të paligjshme.

| TRAFIKIMI | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|---|----------------|----------------------|------------------|---------------------|-----------------|----------------|----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 110/a Trafikim i Personave | 39 | 6 | 11 | 10 | 7 | 38 | 8 | 16 | 13 | 7 |
| Neni 128/b Trafikimi i të miturve | 5 | 4 | 3 | 8 | 1 | 14 | 1 | 8 | 1 | 5 |
| Neni 138/a Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës | 3 | 2 | 3 | 2 | 1 | 3 | 0 | 2 | 0 | 2 |
| Neni 141/a Trafikimi i mjeteve motorike | 231 | 9 | 27 | 12 | 8 | 185 | 8 | 17 | 10 | 2 |
| Neni 278/a Trafikimi i armëve dhe i municionit | 17 | 2 | 34 | 6 | 0 | 15 | 6 | 15 | 13 | 10 |
| Neni 282/a Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive | 6 | 1 | 8 | 4 | 4 | 3 | 3 | 5 | 5 | 4 |
| Neni 283/a Trafikimi i narkotikëve | 154 | 95 | 187 | 124 | 126 | 131 | 59 | 146 | 121 | 110 |
| Totali | 455 | 119 | 273 | 166 | 147 | 389 | 85 | 209 | 163 | 140 |

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një ulje prej 14,5 % të numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale të trafikëve të paligjshme në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi ulje prej 28,6 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, është regjistruar ulje prej 23 % e të pandehurve të regjistruar, kemi një ulje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 1,8 % dhe ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 5 % përkundrejt vitit 2014.

Grafikisht tendenca e veprave penale të trafikëve për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit, të rritur (mbi 18 vjeç) 2 % femra dhe 98 % meshkuj. Rezulton vetëm një i pandehur i mitur mashkull. Në vitin 2015 janë regjistruar 15 të pandehur të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 40 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 59 % me arsim të mesëm dhe më pak se 1 % të pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim të mesëm.

Në lidhje me gjendjen shoqërore të të pandehurve rezulton se 68 % janë nga sektori privat dhe pjesa tjetër (32 %) janë të papunë.

Rezulton se 54 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 46 % prej tyre në fshat. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në qytet.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, vetëm 6,6 % prej tyre rezultojnë përsëritës në vepra të ndryshme penale.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Trafikimi i mjeteve motorike


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafikëve të paligjshme” është 47,6 % për vitin 2015, ndërkohë që për vitin 2014 ka qenë 50,7 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal “Trafikimi i mjeteve motorike”, në vitin 2015, prej 20 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në përqindje mbi shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për këtë vepër penale për vitin 2015:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, për këtë veprë penale numrin më të madh të procedimeve të regjistruara e kanë prokuroria e shkallës së parë Tiranë, numër që përbën 31 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Durrës, Shkodër e Vlorë kanë regjistruar përkaësisht 12 %, 10 % dhe 9 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroritë e shkallës së parë Fier, Gjirokastrë e Lezhë kanë regjistruar numër të njëjtë procedimesh që përbëjnë secila 6 % të numrit total të procedimeve në shkallë, prokuroritë e shkallës së parë Elbasan e Kukës kanë regjistruar numër të njëjtë procedimesh që përbën 4 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi dhe prokuroria e shkallës së parë Pogradec ka regjistruar 3% të procedimeve penale të numrit total të procedimeve. Prokuroritë e shkallës së parë Berat, Dibër, Korçë, Kurbin, Lushnje e Sarandë kanë regjistruar më pak se 2,5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, ndërkohë që prokuroritë e shkallës së parë Kavajë, Krujë, Mat, Përmet, Pukë e Tropojë nuk kanë regjistruar asnjë procedim penal në vitin 2015, për veprën penale të parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal “Trafikimi i mjeteve motorike”.

Trafikimi i personave


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Kundër trafikëve të paligjshme” në vitin 2015 është 9,8 % ndërsa në vitin 2014 ka qenë 8,6 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet një tendencë e lehtë ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal “Trafikimi i Personave”, në vitin 2015, prej 2,6 % në krahasim me vitin 2014. Ndërsa numri i procedimeve të dërguara për gjykim është rritur nga 6 procedime me 10 të pandehur në vitin 2014, në 8 procedime me 13 të pandehur për vitin 2015. Nga gjykata janë dhënë 7 dënime ndaj të pandehurve që kanë kryer veprën penale të trafikimit të personave.

Trafikimi i të miturve

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Kundër trafikëve të paligjshme” në vitin 2015 është 3,6 % ndërsa në vitin 2014 ka qenë 1 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet një tendencë në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal “Trafikimi i të miturve”, në vitin 2015, prej 2,8 herë më shumë në krahasim me vitin 2014.

Trafikimi i armëve dhe i municionit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafikëve të paligjshme” është 3,9 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 278/a i Kodit Penal “Trafikimi i armëve dhe i municionit”, në vitin 2015, prej 12 % në krahasim me vitin 2014, ndërsa numri i procedimeve të dërguara për gjykim është rritur nga 2 procedime në vitin 2014 në 6 procedime në vitin 2015. Lidhur me dënimet, në vitin 2015 rezultojnë 10 të pandehur të dënuar për këtë vepër penale.

Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafikëve të paligjshme” është 0,6 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e kësaj veprë penale nga 12 procedime të regjistruara në vitin 2013, në 3 procedime penale të regjistruara në vitin 2014.

Trafikimi i narkotikëve

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafikëve të paligjshme” është 33,7 % ndërkohë që në vitin 2014 ky tregues ka qenë 33,8 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal “Trafikimi i narkotikëve”, në vitin 2015 prej 15 % në krahasim me vitin 2014.

VEPRAT PENALE QË LIDHEN ME PRODHIMIN DHE KULTIVIMIN E NARKOTIKËVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2015 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 5,9 %, ndërsa për vitin 2014 ka qenë 3,7 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale në lidhje me prodhimin dhe kultivimin e narkotikëve:


| PRODHIMI DHE KULTIVIMI I NARKOTIKËVE | 2014 | | | | | 2015 | | | | |
|---|----------------|----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|----------------|-----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Proc. Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 283 Prodhimi dhe shitja e narkotikëve | 716 | 374 | 768 | 491 | 378 | 743 | 300 | 901 | 454 | 315 |
| Neni 284 Kultivimi i bimëve narkotike | 535 | 64 | 123 | 69 | 57 | 1159 | 144 | 369 | 170 | 102 |
| Neni 284/a Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | | | | | | | | | | |
|--|-------------|------------|------------|------------|------------|-------------|------------|-------------|------------|------------|
| Neni 284/c Prodhimi dhe fabrikimi i lendeve narkotike dhe psikotrope | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 285 Mbajtja, prodhimi dhe transportimi i sustancave kimike | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 5 | 0 | 0 |
| TOTALI | 1251 | 438 | 891 | 560 | 435 | 1903 | 444 | 1275 | 624 | 417 |

TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 ka një rritje prej 52 % të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë grup veprash penale në krahasim me vitin 2014. Ndërkaq kemi rritje prej 1,4 % të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2014. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2014 prej 43 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 11,4 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 4 % përkundrejt vitit 2014.

Grafikisht tendenca e veprave penale për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, paraqitet si vijon:



TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale, si gjinia, moshja, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve të regjistruar, rezultojnë 96,6 % të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) nga të cilët 2,4 % femra dhe 97,6 % meshkuj. Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve të regjistruar, rezultojnë 4,4 % të mitur (14-18 vjeç) nga të cilët 3 % janë femra dhe pjesa tjetër meshkuj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 66 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 32 % me arsim të mesëm dhe 2 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se nga sektori privat janë regjistruar 17 % e të pandehurve dhe të papunë 83 %.

Rezulton se 51 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 49 % prej tyre në fshat.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë (94 % e tyre) ndërsa pjesa tjetër janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

Prodhimi dhe shitja e narkotikëve


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në këtë grup është 39 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 57,3 %.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore vihet re se për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, në vitin 2015, numri i procedimeve të regjistruara është 4 % më i lartë se në vitin 2014.

Të dhënat e regjistruara për këtë vepër penale në vitin 2015 krahasuar me vitin 2014 paraqiten në grafikun në vijim:



Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në përqindje në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale në vitin 2015:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh procedimeve të regjistruara për këtë veprën penale e kanë prokuroria e shkallës së parë Tiranë, që përbën 29 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Durrës ka regjistruar 11 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 8 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë për krime të rënda ka regjistruar 6 % të procedimeve në shkallë vendi të cilat më pas janë dërguar për kompetencë pranë prokurorisë të tjera shkallës së parë, prokuroritë e shkallës së parë Shkodër e Elbasan kanë regjistruar një numër procedimesh që përbën rreth 5,5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi ndërsa prokuroria e shkallës së parë Korçë ka regjistruar 5 % të procedimeve penale në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Berat, Lezhë, Sarandë e Fier kanë regjistruar rreth 4 % të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi dhe prokuroria e shkallës së parë Gjirokastër ka regjistruar 3 % të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Lushnje, Dibrë, Kavajë, Pogradec, Kukës, Krujë, Mat, Kurbin, Përmet, Pukë e Tropojë kanë regjistruar në vitin 2015, një numër procedimesh më të ulët se 2,2 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”.

Kultivimi i bimëve narkotike


Pesha specifike që zë kjo veprë penale këtë grup është 61 % për vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 ka qenë 42,7 %.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2011-2015 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje në vitin 2015 e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal "Kultivimi i bimëve narkotike", prej 117 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me procedimet penale të regjistruara për këtë veprë penale në vitet 2014 dhe 2015:



Lidhur me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre në vitin 2015 grafiku në vijim paraqet të dhënat në përqindje sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, numrin më të madh procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale e kanë regjistruar prokuroria e shkallës së parë Shkodër që përbën 23 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Vlorë ka regjistruar 16 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi, prokuroria e shkallës së parë Gjirokastër ka regjistruar 9 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Krujë e Tiranë kanë regjistruar nga 8 % të numrit total të procedimeve, prokuroria e shkallës së parë Fier ka regjistruar 5 % të numrit total të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Lezhë, Pukë, Tropojë e Berat kanë regjistruar nga një numër procedimesh që përbën 4 % të procedimeve në shkallë vendi, ndërsa prokuroritë e shkallës së parë Sarandë e Korçë kanë regjistruar në vitin 2015 respektivisht 3 % të procedimeve në shkallë vendi. Prokuroritë e shkallës së parë Kurbin, Lushnje, Elbasan, Mat, Përmet, Durrës Dibër, Pogradec, Kavajë e Kukës kanë regjistruar një numër procedimesh më të ulët se 2,5 për veprën penale të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal “Kultivimi i bimëve narkotike” gjatë viti 2015, ku numrin më të ulët e kanë regjistruar prokuroritë Kavajë e Kukës.

2.10 PËRMBLEDHJE E TENDENCAVE TË KRIMINALITETIT SIPAS GRUPVEPRAVE PENALE

Për vitin 2015 vihen re **tendenca në ulje të numrit të procedimeve të regjistruara** për veprat penale si më poshtë:

- “Krimet Kundër jetës të kryera me dashje” të regjistruara në vitin 2015 kanë pësuar një ulje prej 21,5 % në krahasim me vitin 2014;
- “Krimet kundër jetës të shkaktuar me pakujdesi”, të regjistruara në vitin 2015 janë ulur me 15 % në krahasim me vitin 2014;
- “Veprat Penale kundër jetës të kryera me dashje” janë ulur me 11, 5 % në krahasim me vitin 2014;
- “Krimet kundër shëndetit të shkaktuar me pakujdesi” të regjistruara në vitin 2015 janë më të ulëta se numri i procedimeve të regjistruara në vitin 2014, nga 6 procedime në 3;
- “Veprat penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose nga mosdhënia e ndihmës” në vitin 2015 kanë një ulje prej 23 % të numrit të procedimeve të regjistruara, në krahasim me vitin 2014;
- “Veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit”, sikurse vihet re edhe nga tabela, rezultojnë se në vitin 2015 kanë një ulje prej 4,4% në krahasim me vitin 2014;
- “Veprat penale kundër vjedhjes së pasurisë” në vitin 2015 kanë një ulje prej 7 % të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2014;
- “Veprat penale që çënojnë regjimin juridik të tokës” në vitin 2015 kanë një ulje prej 26 % të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2014;
- “Veprat penale kundër mjedisit” kanë një ulje prej 16 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014;
- “Krimet kundër autoritetit të shtetit” të regjistruara në vitin 2015 kanë pësuar një ulje prej 6 % në krahasim me vitin 2014;
- “Veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik” në vitin 2015 kanë pësuar një ulje prej 12 % të numrit të procedimeve të regjistruara, në krahasim me vitin 2014;
- “Veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike” në vitin 2015 kanë një ulje prej 12 % të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2014;
- “Veprat penale kundër drejtësisë” të regjistruara në vitin 2015 kanë pësuar një ulje prej 20 %, në krahasim me vitin 2014;
- “Veprat penale të trafiqeve të paligjshme” në vitin 2015 kanë pësuar një ulje prej 14,5 % të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2014;

Për sa i përket veprave penale të mëposhtme, vihet re **një rritje e numrit të procedimeve të regjistruara** për vitin 2015. Kështu:

- “Krimet seksuale” në vitin 2015 kanë pësuar një rritje prej 16 % të numrit të procedimeve të regjistruara, në krahasim me vitin 2014;


- “Veprat penale kundër lirisë së personit” në vitin 2015 kanë një rritje prej 20,7 % të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2014;
- “Veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” për vitin 2015 kanë një rritje prej 3 % në krahasim me vitin 2014;
- “Veprat penale të mashtrimit” në vitin 2015 kanë një rritje prej 18 % krahasuar me vitin 2014;
- “Veprat penale të shkatërrimit të pronës” në vitin 2015 kanë një rritje në krahasim me vitin 2014, në masën 3,5 % të numrit të procedimeve të regjistruara;
- “Veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare” në vitin 2015 kanë një rritje të gjithë treguesve statistikorë në krahasim me vitin 2014;
- “Veprat penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare” në vitin 2015 kanë një rritje prej 8 % të numrit të procedimeve të regjistruara;
- “Krimet në fushën e doganave” në vitin 2015 kanë një rritje të lehtë prej 2,6 % të numrit të procedimeve të regjistruara;
- “Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet” në vitin 2015 kanë një rritje 2 herë më të madhe të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2014;
- “Veprat penale të falsifikimit të monedhave dhe letrave me vlerë” në vitin 2015 kanë një rritje prej 19 % të numrit të procedimeve të regjistruara;
- “Veprat penale të falsifikimit të dokumenteve” në vitin 2015 kanë një rritje prej 10 % të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2014;
- “Veprat penale me qëllime terroriste” kanë një total prej 12 rastesh të procedimeve të regjistruara për në vitin 2015, ndërsa në vitin 2014 janë regjistruar 11 procedime penale;
- “Veprat penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale” në vitin 2015 kanë regjistruar 15 procedime penale me 41 të pandehur, ndërsa në vitin 2014 rezultojnë 13 procedime të regjistruara
- “Veprat penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale” për vitin 2015 kanë një rritje prej 18 % të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2014;
- “Veprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë” në vitin 2015 kanë një rritje prej 50 % të numrit të procedimeve të regjistruara, në krahasim me vitin 2014;
- “Veprat penale kundër krimit kompjuterik” në vitin 2015 kanë një rritje prej 8,8 % të numrit të procedimeve të regjistruara;
- “Veprat penale të korrupsionit” në vitin 2015 kanë një rritje prej 49 % të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2014;
- “Veprat penale kundër prodhimit dhe kultivimit të narkotikëve” në vitin 2015 kanë një rritje prej 52 % të numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2014;

2.11 TREGUESI I EFEKTIVITETIT TË ORGANIT TË PROKURORISË NË VITE, NË NGRITJEN E AKUZËS NË FAZËN E HETIMIT PARAPRAK

Nga të dhënat statistikore rezulton se treguesi i efektivitetit të ngritjes së akuzës në fazën e hetimit paraprak ka qenë si më poshtë:

Në vitin 2011 janë përfunduar hetimet për 11330 të pandehur nga të cilat 9256 janë dërguar për gjykim dhe për 2074 të pandehur janë pushuar hetimet ose janë dërguar për gjykim 81,69 % e personave për të cilat është ngritur akuzë. Në vitin 2012 janë përfunduar hetimet për 11654 të pandehur nga të cilët 9354 janë dërguar për gjykim 80,26 % e personave për të cilët është ngritur akuzë. Në vitin 2013 janë përfunduar hetimet për 12315 të pandehur nga të cilët 9974 janë dërguar për gjykim 80,99 % e personave për të cilët është ngritur akuzë. Në vitin 2014 janë përfunduar hetimet për 18982 të pandehur nga të cilët 15806 janë dërguar për gjykim ose 83 % e personave për të cilët është ngritur akuzë dhe për 3176 të pandehur janë pushuar hetimet ose për 17 % të të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë dhe në vitin 2015 janë përfunduar hetimet për 20148 të pandehur nga të cilët 16906 janë dërguar për gjykim ose 84 % e personave për të cilët është ngritur akuzë dhe për 3242 të pandehur janë pushuar hetimet ose për 16 % të të pandehurve.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet efektiviteti i ngritjes së akuzës në fazën e hetimit paraprak për vitin 2015:




Treguesi i efektivitetit të organit të prokurorisë në vite, në gjykimin dhe në dënimin e të pandehurve

Nga të dhënat statistikore rezulton se, në vitin 2011 për rreth 96,21 % e personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata dhe në vitin 2012 për rreth 88,35 % e personave të gjykuar janë



shpallur fajtorë nga gjykata, në vitin 2013 për rreth 93 % e personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata, në vitin 2014 për rreth 90,4 % e personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata dhe në vitin 2015 për rreth 94,2 % e personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata.

Grafiku i mëposhtëm përmban të dhëna të detajuara lidhur me numrin e të pandehurve dërguar në gjyq, gjykuar, dënuar dhe ata që kanë marrë pafajësi në pesë vitet e fundit:




Të dhëna mbi kërkesën e prokurorit dhe vendimet e gjykatës

Më poshtë paraqiten në përqindje të dhënat lidhur me kërkesat e prokurorit dhe vendimet e gjykatës gjatë vitit 2015, lidhur me dënimin me burgim, dënimin me gjobë dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë:




Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me **masën e dënimit “Burgim i përjetshëm”** për periudhën 2011-2015:



Në lidhje me burgimin e përjetshëm, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 kërkesat e prokurorit për dënim me burgim të përjetshëm janë rritur në krahasim me vitin 2014 në masën 18.75 %, në vitin 2014 kërkesat e prokurorit për dënim me burgim të përjetshëm janë rritur në krahasim me vitin 2013 në masën 33 %, në vitin 2013 ka patur një ulje 42.85 % të kërkesave të prokurorit për këtë masë dënimi në krahasim me vitin 2012 dhe në vitin 2012 ka një rritje prej 16,66 % të kërkesave të prokurorëve për këtë masë dënimi në krahasim me vitin 2011.

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2015 vendimet e gjykatës për dënim me burgim të përjetshëm janë në të njëjtin nivel si në vitin 2014 e në vitin 2013, në vitin 2013 ka një ulje të vendimeve të gjykatës prej 25 % për këtë masë dënimi në krahasim me vitin 2012 dhe në vitin 2012 ka një ulje të vendimeve të gjykatës prej 7,69 % për këtë masë dënimi në krahasim me vitin 2011.


Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me **dënimin e të pandehurve me burgim sa maksimumi i** parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete për vitet 2011-2015:



Nga të dhënat statistikore vihet re se në vitin 2015 ka një ulje prej 19,77 % të kërkesave të prokurorit për dënimin e të pandehurve me maksimumin e dënimit me burgim të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete krahasuar me vitin në vitin 2014. Në vitin 2014 vërehet një ulje prej 3,5 % e kërkesave të prokurorit për dënimin e të pandehurve me maksimumin e dënimit me burgim të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete krahasuar me vitin 2013. Në vitin 2013 ka një ulje prej 18,98 % të kërkesave të prokurorëve për dënimin me burgim në maksimum në krahasim me vitin 2012 dhe në vitin 2012 ka një rritje prej 17,24 % të të kërkesave të prokurorëve për dënimin me burgim në maksimum në krahasim me vitin 2011.

Lidhur me vendimet e dënimit në maksimumin e masës së dënimit të parashikuar për veprën penale konkrete gjatë vitit 2015, vërehet ulje në masën 32,84 % në krahasim me vitin 2014, në vitin 2014 ka rritje prej me 3,4 % të vendimeve të dhëna nga gjykata me dënimin në maksimum krahasuar me një vit më parë. Në vitin 2013 ka një ulje prej 23,64 % të vendimeve të gjykatës për dënimin me burgim në maksimum në krahasim me vitin 2012 dhe në vitin 2012 ka një rritje prej 20,39 % të vendimeve të gjykatës për dënimin me burgim në maksimum në krahasim me vitin 2011.


Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me masën e **dënimit me burgim në minimumin** e parashikuar nga ligji:



Në lidhje me masën e dënimit me burgim në minimum, vihet re se në vitin 2015 kërkesat e prokurorit janë rritur me 70,52 % krahasuar me vitin 2014, në vitin 2014 kërkesat e prokurorit janë rritur me 86,68 % krahasuar me vitin 2013. Në vitin 2013 ka rritje të kërkesave të prokurorëve për bërëgim në minimum nga viti 2012 prej 11,57 % dhe në vitin 2012 ka ulje të kërkesave të prokurorëve për bërëgim në minimum nga viti 2011 prej 2,61 %.

Vihet re se në vitin 2015 vendimet e gjykatës për dënimin në minimumin e parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete janë rritur me 22,23 % krahasuar me vitin 2014, në vitin 2014 vendimet e gjykatës për dënimin në minimum janë rritur me 78,23 % krahasuar me vitin 2013. Në vitin 2013 ka rritje prej 13,66 % të vendimeve të gjykatës për këtë lloj dënimi në krahasim me vitin 2012 dhe në vitin 2012 ka rritje prej 5 % të dënimeve të gjykatës për dënimin me burgim në minimum krahasuar me vitin 2011.


Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me zbatimin e nenin 59 të Kodit Penal ku është parashikuar **“Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë”** si kërkime të prokurorit ashtu edhe vendime të gjykatës, në pesë vitet e fundit:



Nga të dhënat statistikore, vihet re se në vitin 2015 ka një rritje prej 11,63 % të numrit të kërkesave të prokurorit për aplikimin e alternativës së dënimit me burg të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë” në krahasim me vitin 2014, në vitin 2014 ka një rritje prej 205 % të numrit të kërkesave për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal në krahasim me vitin 2013. Në vitin 2013 ka një rritje prej 4,72 % në krahasim me vitin 2012 dhe në vitin 2012 ka një ulje prej 3,53 % të kërtimeve të prokurorit për aplikim të dënimit alternativ “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë” në krahasim me vitin 2011.

Ndërkohë që edhe vendimet e gjykatës kanë pësuar një rritje prej 24 % në krahasim me vitin 2014.

Në lidhje me dënimin me gjobë, grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për vitet 2011-2015:



Të dhënat statistikore tregojnë rritje të kërkesave të prokurorit për dënimin me gjobë në vitin 2015 prej 30,68 % krahasuar me vitin 2014, në vitin 2014 vërehet rritje e kërkesave të prokurorit për dënime me gjobë prej 18,27 % në krahasim me vitin 2013. Në vitin 2013 vërehet ulje e kërkesave të prokurorit për dënime me gjobë prej 36,49 % në krahasim me vitin 2012 dhe gjatë vitit 2012 ka një ulje prej 19,86 % të kërkesave të prokurorit për dënime me gjobë në krahasim me vitin 2011.


Ndërsa lidhur me vendimet e dënimit me gjobë, vihet re se në vitin 2015 ka një rritje prej 31,77 % në krahasim me vitin 2014, në vitin 2014 ka rritje prej 22,38 % në krahasim me vitin 2013, në vitin 2013 ka një ulje prej 38,86 % dhe në vitin 2012 ka një ulje prej 19 % krahasuar me një vit më parë.

2.12 TË DHËNA PËR TË PANDEHURIT PËR VITIN 2014

Të dhëna lidhur me të pandehurit regjistruar, dërguar gjyqit dhe dënimet për veprat penale ushtarake gjatë vitit 2015, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

| | Të pandehur regjistruar | Të pandehur dërguar gjyqit | Të pandehur të dënuar | Të pandehur të pafajshëm |
|---------------|-------------------------|----------------------------|-----------------------|--------------------------|
| Totali | 40 | 34 | 24 | 1 |

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për të pandehurit në hetim (sipas Kodit Penal civil) në pesë vitet e fundit (2011 – 2015):



Në të dhënat e një viti përfshihen të pandehur çështjet e të cilëve janë mbartur nga viti i kaluar, të pandehur për të cilët është rifilluar hetimi nga organi i prokurorisë, të pandehur të regjistruar nga organi i prokurorisë.

Sikurse shihet nga grafiku i mësipërm, të dhënat tregojnë një tendencë në ulje e numrit të pandehurve në hetim nga viti 2014 në vitin 2015.

Në lidhje me të pandehurit e regjistruar, nga të dhënat statistikore rezulton se dinamika e këtij treguesi në pesë vite është si më poshtë:

Në vitin 2011 janë regjistruar 10779 të pandehur, që do të thotë rritje prej 2,09 % në krahasim me vitin 2010, në vitin 2012 janë regjistruar 10798 të pandehur, që do të thotë rritje prej 9 % në krahasim me vitin 2011, në vitin 2013 janë regjistruar 13416 të pandehur, që do të thotë rritje prej 24,24 % në krahasim me vitin 2012, në vitin 2014 janë regjistruar 18585 të pandehur, që do të thotë rritje prej 38,5 % në krahasim me vitin 2013 dhe në vitin 2015 janë regjistruar 18076 të pandehur që do të thotë ulje prej 2,7 % në krahasim me vitin 2014.


Në lidhje me të pandehurit mbartur në hetim, duke marrë në referencë vitet 2011-2015 rezulton se:

Në 2011 janë mbartur 2879 të pandehur, që do të thotë rritje prej 1,8 % në krahasim me vitin 2010, në vitin 2012 janë mbartur 3207 të pandehur që do të thotë rritje prej 4 % në krahasim me vitin 2011, në vitin 2013 janë mbartur 3008 të pandehur që do të thotë ulje prej 6,2 % në krahasim me vitin 2012, në vitin 2014 janë mbartur 5295 të pandehur që do të thotë rritje prej 76 % në krahasim me vitin 2013 dhe në vitin 2015 janë mbartur 6549 të pandehur që do të thotë rritje prej 73,7 % në krahasim me vitin 2014.

Në lidhje me të pandehurit, për të cilët është vendosur rifillimi hetimeve rezulton se:

Në vitin 2011 janë rifilluar hetimet për 150 të pandehur që do të thotë një ulje e lehtë prej 3,84 % në krahasim me vitin 2010, në vitin 2012 janë rifilluar hetimet për 119 të pandehur, që do të thotë ulje 20,66 % në krahasim me vitin 2011, në vitin 2013 janë rifilluar hetimet për 103 të pandehur, që do të thotë ulje 13,4 % në krahasim me vitin 2012, në vitin 2014 janë rifilluar hetimet për 149 të pandehur që do të thotë rritje prej 44,6 % në krahasim me vitin 2013 dhe në vitin 2015 janë rifilluar hetimet për 162 të pandehur që do të thotë rritje prej 8,7 % në krahasim me vitin 2014.


Grafiku i mëposhtëm paraqet numrin e të pandehurve për të cilët kanë përfunduar hetimet dhe mënyra e përfundimit të tyre për vitet 2014 dhe 2015:



Sikurse shihet nga grafiku i mësipërm, të dhënat tregojnë për një tendencë në rritje të numrit të pandehurve dërguar gjyqit për vitin 2015, gjatë të cilit i janë dërguar në gjyq 16906 të pandehur, që do të thotë rritje 6,96 % në krahasim me vitin 2014.


Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me gjininë e të pandehurve në vitet 2013-2015:



Nga të dhënat statistikore rezulton se raporti i të pandehurve meshkuj-femra në vitin 2013 ka qenë 95,9 % me 4,1 % ndërkohë, në vitin 2014 ka qenë 95,77 % me 4,23 % dhe në vitin 2015 raporti i të pandehurve të regjistruar është 94,44 % meshkuj dhe 5,56 % femra.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me arsimin e të pandehurve në vitet 2013-2015:




Nga të dhënat statistikore vërehet se në vitin 2013 rezultojnë 63,75 % e të pandehurve me arsim deri 9 vjeçar, në vitin 2014 rezultojnë 61,39 % të pandehurve me këtë nivel arsimor që përbën ulje 2,4 % në krahasim me vitin 2013 dhe në vitin 2015 rezultojnë 55,70 % të pandehurve me këtë nivel arsimor që përbën ulje 5,7 % në krahasim me vitin 2014.

Me arsim të mesëm, në vitin 2013 rezultojnë 31,07 % e të pandehurve raport i njëjtë ky me vitin 2012, në vitin 2014 rezultojnë 32,77 % e të pandehurve me arsim të mesëm, që do të thotë rritje prej 2,7 % në krahasim me vitin 2013 dhe në vitin 2015 rezultojnë 37,76 % e të pandehurve me arsim të mesëm, që do të thotë rritje prej 5 % në krahasim me vitin 2014.

Me arsim të lartë, në vitin 2013 rezultojnë 5,18 % e të pandehurve ose një rritje prej 1 % në krahasim me vitin 2012 dhe në vitin 2014 rezultojnë 5,84 % e të pandehurve, që do të thotë rritje prej 0,66 % në krahasim me vitin 2013 dhe në vitin 2015 rezultojnë 6,54 % e të pandehurve me arsim të lartë, që do të thotë rritje prej 0,7 % në krahasim me vitin 2014.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me gjendjen shoqërore të të pandehurve për vitet 2013- 2015:




Përsa i takon gjendjes shoqërore të të pandehurve, rezulton se në vitin vitin 2013 të punësuar në sektorin shtetëror rezultojnë 3,47 % e të pandehurve, në vitin 2014 të pandehurit e punësuar në sektorin shtetëror përbëjnë 3,22 % të totalit të të pandehurve të regjistruar dhe në vitin 2015 të pandehurit e punësuar në sektorin shtetëror përbëjnë 3,66 % të të pandehurve regjistruar.

Nga të dhënat statistikore rezulton se të pandehur të punësuar në sektorin privat në vitin 2013 rezultojnë 29,39 %, në vitin 2014 të pandehurit e punësuar në sektorin privat përbëjnë 33,53 % të numrit të të pandehurve ose rritje rreth 4 % krahasuar me këtë raport në vitin 2013 dhe në vitin 2015 të pandehurit e punësuar në sektorin privat përbëjnë 31,91 % të numrit të të pandehurve.

Në vitin 2013 rezultojnë 67,14 % e të pandehurve të papunë, në vitin 2014 janë 63, 25 % e të pandehurve të regjistruar që rezultojnë të papunë dhe në vitin 2015 janë 64,43 % e të pandehurve të regjistruar në prokurori që rezultojnë të papunë.


Pra ajo që vërehet nga të dhënat statistikore është se gjatë tre viteve të fundit më shumë se 60 % e të pandehurve të regjistruar janë të papunë dhe ky është një nga faktorët kryesor kriminogjenë.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me vendbanimin e të pandehurve për vitet 2013-2015:



Sikurse rezulton edhe nga tabela e mësipërme, në lidhje me vendbanimin e personave të cilët janë marrë të pandehur, theksojmë se nga të dhënat statistikore rezulton se kriminaliteti mbetet një fenomen i pranishëm më shumë në qytet sesa në fshat, ndërkohë që për vitin 2015 vërehet tendencë në ulje e të pandehurve që rezultojnë me banim në qytet dhe rritje e të pandehurve që rezultojnë me banim në fshat.

Grafiku në vijim paraqet të dhëna në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve për vitet 2013-2015:




Përsa i takon gjendjes gjyqësore të të pandehurve, në vitin 2015 rezultojnë se 1,56 % e të pandehurve janë përsëritës për të njëjtën veprë penale që do të thotë ulje me 0,3 % krahasuar me vitin 2014, në vitin 2014, 1,86 % e të pandehurve janë përsëritës për të njëjtën veprë penale që do të thotë 0,6 % më pak se në vitin 2013 dhe në vitin 2013 rezultojnë 2,45 % e të pandehurve përsëritës për të njëjtën veprë penale.

Përsëritës për vepra penale të ndryshme në vitin 2015 rezultojnë se janë 3,07 % e të pandehurve, që do të thotë rritje me 0,2 % krahasuar me vitin 2014, në vitin 2014 rezultojnë 2,86 % e të pandehurve, që do të thotë ulje me 2,6 % në krahasim me vitin 2013 në të cilin rezultojnë 5,43 % e të pandehurve përsëritës për vepra penale të ndryshme.

Të pandehurit e padënuar më parë, në vitin 2015 përbëjnë 95,37 % të të pandehurve, në vitin 2014 përbëjnë 95,27 % dhe në vitin 2013 përbëjnë 92,11 % të të pandehurve të regjistruar.

Shtetësia e të pandehurve

Përsa i përket shtetësisë së të pandehurve, gjatë vitit 2015 mbi 99 % e tyre janë me shtetësi shqiptare. Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike, në vitin 2013 janë regjistruar 152 të pandehur të huaj që përbëjnë 0,92 %, në vitin 2014 janë regjistruar 125 të pandehur të huaj që përbëjnë 0,67 % të numrit të të pandehurve të regjistruar dhe në vitin 2015 janë regjistruar 162 të pandehur që përbëjnë 0,89 % të numrit të të pandehurve të regjistruar.



Veprat penale të kryera më së shumti nga të pandehurit me shtetësi të huaj janë, kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror kryer nga 20 % e të pandehurve, falsifikimi i letërnjoftimeve, pasaportave ose i vizave, kryer nga 18,5 % e të pandehurve, trafiku i narkotikëve kryer nga 8 % e të pandehurve, drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt, kryer nga 5,5 % e të pandehurve. Pjesa tjetër e pandehurve me shtetësi të huaj, kanë kryer vepra penale të tjera të cilat të veçuara kanë peshë specifike më të vogël se 3 % brenda totalit.

Të pandehur të mitur 2015

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me të pandehurit e mitur në vitet 2011-2015:




Në lidhje me të pandehurit e mitur, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013 rezultojnë 911 të pandehur të mitur të hetuar, në vitin 2014 rezultojnë 1013 të pandehur të mitur ose 11 % më shumë se në vitin 2013 dhe në vitin 2015 rezultojnë 978 të pandehur të mitur ose 3,5 % më pak se në vitin 2014.


Të miturit dërguar gjyqit në vitin 2015 janë 849 ose 1,3 % më pak se në vitin 2014, gjatë të cilit i janë dërguar gjyqit 860 të pandehur të mitur.

Në lidhje me të pandehurit e mitur të dënuar nga gjykata, nga të dhënat statistikore rezulton se gjatë vitit 2015 janë dënuar 758 të pandehur të mitur që përbën rritje prej 1,3 % në krahasim me vitin 2014 gjatë të cilit janë dënuar 748 të pandehur të mitur.

Grafikisht, të dhënat paraqiten si vijon:



Kriminaliteti te të miturit sipas veprave penale paraqitet si vijon:



Siç vihet re nga grafiku vjedhja e pasurisë përbën grupveprat penale të kryera më së shumti nga të miturit 14 deri 18 vjeç, e konkretisht nga 46 % e të pandehurve të mitur.

Një veprë tjetër penale problematike, për të cilën janë regjistruar 24 % e të pandehurve të mitur është ajo e “Drejtimin të automjeteve në mënyrë të parregullt”.

Lidhur me veprat penale kundër personit, rezulton se 10 % e të miturve kanë kryer vepra penale drejtuar personit.


Për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” janë regjistruar 3 % e të pandehurve të mitur.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” janë regjistruar 3 % e të pandehurve të mitur.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 279 i Kodit Penal, “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta” janë regjistruar 1 % e të pandehurve të mitur.


Pjesa tjetër e të miturve të regjistruar e hetuar kanë kryer vepra penale të tjera të cilat të veçuara nuk kanë peshë specifike të veçantë brenda totalit.

Grafiku në vijim paraqet të dhënat për veprat penale të kryera nga të pandehurit në vitet 2014 – 2015, ku siç vërehet veprat e kryera më së shumti në të dy vitet janë vjedhja e pasurisë e cila në vitin 2015 rezulton me rritje prej 4 %:



Lidhur me caktimin e dënimit për të pandehurit e mitur 14 deri 18 vjeç gjatë vitit 2015, rezulton se është kërkuar për 385 të pandehur të mitur caktimi i dënimeve alternative, kryesisht pezullimi i vendimit të dënimit me burg dhe vënia në provë, ndërsa në vitin 2014 është kërkuar caktimi i dënimeve alternative për 345 të pandehur të mitur, e shprehur në përqindje një rritje prej 12 % krahasuar me vitin 2014 dhe 30 % krahasuar me vitin 2013. Ndërsa kërkesat e prokurorit për caktimin e dënimit me burg¹⁹ kanë ardhur duke u ulur çdo vit, ku të dhënat tregojnë se në vitin 2015 janë ulur 10 % krahasuar me vitin 2014 dhe 26 % krahasuar me vitin 2013.


Të dhënat paraqiten grafikisht si vijon:



¹⁹ Nuk përfshihet në këtë shifër aplikimi i nenit 53 të Kodit Penal ulja e dënimit nën minimum ose caktimi i një dënimi më të butë se ai që parashikon dispozita.

Pasojat e veprave penale për vitin 2015

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me pasojat në dëm të jetës e shëndetit të regjistruara në tre vitet e fundit:






Në lidhje me pasojat e veprave penale në dëm të jetës, në vitin 2015 rezulton se numri i vdekjeve ka qenë 23 % më i ulët se në vitin 2014, në vitin 2014 rezulton se numri i vdekjeve ka qenë 22,7 % më i ulët se në vitin 2013.

Pasojat nga veprat penale në dëm të shëndetit “plagosje e rëndë”, rezulton në vitin 2015 ka pësuar rritje prej 5 % në krahasim me vitin 2014 dhe në vitin 2014 ka pësuar ulje prej 37 % në krahasim me vitin 2013.

Me ulje rezulton në vitin 2015 edhe numri i plagosjeve të lehta me 32 % krahasuar me vitin 2014, në vitin 2014 numri i plagosjeve të lehta rezulton me ulje prej 21 % krahasuar me vitin 2013.

Në shifrat e mësipërme përfshihen pasojat në dëm të jetës dhe të shëndetit të personave, për çdo fakt të dyshuar kriminal të hetuar, pavarësisht nga mënyra e përfundimit të procedimit rreth tij.

Të dhëna të detajuara për pasojat e ardhura nga veprat penale konkrete, paraqiten në grafikët e mëposhtëm:



III. MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË ÇËSHTJET PENALE

I. Ekstradime


i. Ekstradime nga jashtë

Gjatë vitit 2015 janë paraqitur gjithsej 107 kërkesa ekstradimi për shtetasit shqiptarë apo të huaj, të cilët janë arrestuar ose lokalizuar nga autoritetet policore të shteteve të tjera pasi janë shpallur në kërkim ndërkombëtar mbi bazën e një vendimi penal dënimi të formës së prerë ose vendimi për caktimin e masës së sigurimit personal “*arrest në burg*” të dhënë nga Gjykatat shqiptare.

Krahasuar me vitin 2014, gjatë vitit 2015 vërehet ulje e numrit të kërkesave të paraqitura nga autoritetet shqiptare për ekstradimin e shtetasve nga jashtë në masën 8,5 %, për shkak se gjatë kësaj periudhe janë arrestuar nga autoritetet e huaja më pak shtetas shqiptarë

Më poshtë paraqesim në formë tabelare dhe grafike të dhënat për periudhën 2013-2015:


| | Viti 2013 | Viti 2014 | Viti 2015 |
|------------------------------------|-----------|-----------|-----------|
| Nr. kërkesave për ekstradim | 125 | 117 | 107 |



Nga të dhënat statistikore konstatohet se, gjatë vitit 2015, numri më i madh i kërkesave për ekstradim vijon t'i jetë paraqitur autoriteteve italiane, greke dhe gjermane përkatësisht me nga 36, 30 dhe 10 kërkesa; 9 kërkesa janë paraqitur për autoritetet gjyqësore të Britanisë së Madhe, 3 kërkesa Zvicrës, 2 Kosovës dhe nga 1 kërkesë i është paraqitur Belgjikës, Bosnjë-Herzegovinës, Francës, Hungarisë, Malit të Zi, Rumanisë e Spanjës.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat statistikore për këtë tregues (*ekstradime nga jashtë*), si dhe grafiku përkatës sipas shteteve të cilëve i janë drejtuar kërkesat për ekstradim:

| Ekstradime nga Jashtë | | |
|-----------------------|-----------|-----------|
| | Viti 2014 | Viti 2015 |
| Itali | 29 | 36 |
| Greqi | 22 | 30 |
| Gjermani | 7 | 10 |
| Angli | 8 | 9 |
| Zvicër | 3 | 3 |
| Kosovë | 5 | 2 |
| Francë | 5 | 1 |



ii. Ekstradime për jashtë

Nga të dhënat statistikore rezultojnë se gjatë vitit 2015 janë arrestuar në territorin e Republikës së Shqipërisë me qëllim ekstradimit drejt shteteve të tjera 128 shtetas shqiptarë apo të huaj, një tregues ky i cili rezultojnë me rritje të ndjeshme në masën 32% krahasuar me vitin 2014.


| Ekstradime për jashtë | |
|-----------------------|------------|
| Viti 2014 | Viti 2015 |
| 97 | 128 |

Vlen të theksohet se, për 22 subjekte të arrestuar me qëllim ekstradimit në Itali, autoritetet italiane kanë paraqitur kërkesa për njohjen e vendimeve penale duke konvertuar kështu, procedurën e ekstradimit me atë të njohjes me qëllim ekzekutimin në Shqipëri të vendimeve penale të dhënë

nga këto autoritete në ngarkim të shtetasve shqiptarë, duke sjellë një situatë problematike për autoritetet gjyqësore shqiptare pasi nuk gjen rregullim konkret në legjislacionin shqiptar.

Gjithashtu nga të dhënat statistikore rezulton se, gjatë vitit 2015 autoritetet italiane kanë tërhequr kërkesën për ekstradim për 7 subjekte pasi është revokuar prej tyre Urdhri i Arrestit Ndërkombëtar dhe për 3 subjekte është rrëzuar kërkesa për ekstradim nga autoritetet gjyqësore shqiptare për shkak të parashkrimit etj.

Sikurse paraqitet në grafikun e mëposhtëm përsa i takon volumit të ekstradimeve për jashtë gjatë periudhës 2014-2015, rezulton se viti 2015 zë 57 % të volumit në raport me periudhën 2-vjeçare, ndërsa viti 2014 përbën 43 %:



Gjatë vitit 2015 numri më i lartë i kërkesave të ekstradimit për shtetasit shqiptarë ose të huaj, të arrestuar në territorin e Republikës së Shqipërisë është paraqitur nga Italia me 81 kërkesa, Kosova 9 kërkesa, Maqedonia 6 kërkesa, Gjermani 5, Zvicra 5, Serbia 4, Shtetet e Bashkuara të Amerikës 2 etj.


Sa më sipër, paraqitet grafikisht:

| Ekstradime për jashtë | | |
|-----------------------|-----------|-----------|
| Shteti | Viti 2014 | Viti 2015 |
| Itali | 62 | 81 |
| Kosove | 6 | 9 |

| | | |
|----------|---|---|
| Maqedoni | 4 | 6 |
| Gjermani | 3 | 5 |
| Zvicër | 3 | 5 |
| Serbi | 3 | 4 |
| SH.B.A | 5 | 2 |

Ekstradime për jashtë

■ Viti 2015 ■ Viti 2014



Vlen të përmendet se, pesha specifike e numrit të kërkesave për ekstradim të ardhura nga autoritetet italiane në raport me totalin e përgjithshëm të kërkesave për ekstradim për vitin 2015


është 63 %, ndërsa për shtete të tjera si Kosova pesha specifike është 7 %, Maqedonia 4,7 %, Gjermania dhe Zvicra përkatësisht 4 % dhe Serbia 3 %.

Në kuadër të paraqitjes së kërkesave nga autoritetet e huaja për ekstradimin nga Shqipëria drejt shteteve kërkuese, theksojmë se, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë gjatë vitit 2015 i ka kërkuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda në **45 raste**, zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së këtyre shtetasve, brenda objektit të nenit 3, pika 1/d (*fusha e zbatimit*) dhe nenin 8/1 (*verifikimet paraprake*) të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”.

II. Letërporositë


i. Letërporositë nga jashtë

Sa i takon kërkesave për ndihmë juridike në çështjet penale të ardhura nga autoritetet e huaja, gjatë vitit 2015 janë transmetuar 661 letërporosi, tregues i cili rezulton me rritje të ndjeshme në masën 40 % krahasuar me vitin 2014, vit në të cilin janë transmetuar 473 letërporosi.



Duke iu referuar të dhënave statistikore konstatohet se, numri më i lartë i kërkesave ka ardhur nga shtetet kufitare si, Greqia me 238 kërkesa, Kosova me 93, Maqedonia 54, Kroacia 52 kërkesa, Mali i Zi 41, Italia 40, Turqia dhe Hungaria përkatësisht nga 18 letërporosi, Gjermania 15, Holanda 14, Portugali 9, Belgjika e Anglia 7, Norvegjia e Rumania 6, Spanja, Serbia Franca me nga 5 letërporosi, ndërsa shtetet e tjera me më pak se 4 kërkesa të tilla.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



ii. Komisione Rogatore dhe dorëzime të kontrolluara

Një pjesë e kërkesave për ndihmë juridike ekzekutohen në prezencë të përfaqësuesve të autoriteteve huaja të drejtësisë, sikurse parashikohet shprehimisht në nenin 16 të ligjit nr. 10193, datë 03.12.2009 “*Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale*”. Më konkretisht, disa komisione rogatore të suksesshme përmenden si më poshtë:


- a. Autoritetet **italiane** të drejtësisë kanë përcjellë kërkesën për ndihmë juridike në kuadër të një operacioni të përbashkët policor, e cila kishte si objekt kryerjen e një sërë veprimesh hetimore dhe proceduriale për veprën penale të “*Organizatës kriminale me qëllim trafikimin ndërkombëtar të lëndëve narkotike*”.
- b. Autoritetet **italiane** të drejtësisë kanë dërguar një kërkesë për ndihmë juridike, që lidhet me procedimin penal në ngarkim të 45 shtetasve, ndër të cilët edhe shtetas shqiptarë në kuadër të veprës penale të “*Trafikimit të lëndëve narkotike*”.
- c. Autoritetet **italiane** kanë përcjellë në Prokurorinë e Përgjithshme një letërporosi në kuadër të operacionit ndaj një organizate kriminale me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike, objekt i së cilës është *krijimi i një skuadre të përbashkët hetimore, kryerja e veprimeve hetimore, përgjimi telematik i disa numrave telefonikë etj.*
- d. Autoritetet **italiane** kanë transmetuar kërkesën për ndihmë juridike në kuadër të një operacioni policor, lidhur me procedimin penal ndaj një organizate kriminale me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike.
- e. Në Ohër, **Maqedoni**, SELEC mundësoi zhvillimin e një takimi të përbashkët operacional me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe të provave që disponohen deri tani, si dhe koordinimin e veprimeve të mëtejshme për evidentimin e aktivitetit të një grupi të strukturuar kriminal.
- f. Autoritetet **zviceriane** të drejtësisë kanë dërguar një kërkesë për ndihmë juridike në kuadër të procedimit penal për veprat penale të “*Vrasjes*” dhe “*Shkeljes së ligjit mbi lëndët narkotike*”. Ekzekutimi është bërë në prezencë të përfaqësuesve të autoriteteve zviceriane të drejtësisë.
- g. Autoritetet **belge** të drejtësisë kanë transmetuar një kërkesë për ndihmë juridike, me objekt kryerjen e një sërë veprimesh proceduriale në kuadër të veprës penale të “*organizatës kriminale me aktivitet tregtimin e lëndëve helmuese, psikotrope, narkotike, dizinfektuese dhe antispetike , tregtimin e lëndëve që mund të përdoren për prodhimin*”.

ilegal të lëndëve narkotike dhe psikotrope si dhe pastrimin e produkteve të veprës penale”.

- h. Autoritetet **franceze** kanë transmetuar drejtpërsëdrejti në Prokurorinë e Përgjithshme, kërkesën për ndihmë juridike në kuadër të procedimit penal për kryerjen e veprave penale të *“Trafikut të armëve dhe bashkëpunimit në bandë të organizuar me qëllim trafikun e armëve”*.
- i. Autoritetet **hollandeze** të drejtësisë kanë përcjellë një letërporosi në kuadër të procedimit penal për veprat penale të *“Vrasjes me dashje dhe paramendim/vrasje me dashje dhe pa paramendim/shkaktim zjarri”*, të parashikuara nga legjislacioni penal hollandez. Objekt i kësaj letërporosie ishte kryerja e veprimeve procedurale si marrja në pyetje e disa shtetasve, marrja e mostrës së ADN-së, përcjellja e informacioneve etj.
- j. Autoritetet **italiane** kanë përcjellë drejtpërdrejt në Prokurorinë e Përgjithshme, kërkesën për ndihmë juridike në kuadër procedimit penal ndaj një organizate kriminale me qëllim *trafikimin e lëndëve narkotike*.

iii. Letërporositë për jashtë

Gjatë vitit 2015, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore i kanë drejtuar autoriteteve të huaja gjyqësore gjithsej 748 kërkesa për ndihmë juridike në kuadër të ushtrimit në vendin tonë të ndjekjes penale ndaj subjekteve shqiparë dhe të huaj. Ky tregues ka pësuar rritje prej 23 % krahasuar me vitin 2014.



Letërporosi për jashtë

| Viti 2014 | Viti 2015 |
|------------------|------------------|
| 608 | 748 |

Të dhënat statistikore sikurse paraqiten edhe në grafikun e mëposhtëm konfirmojnë faktin se, Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë që rezultojnë me numrin më të madh të procedimeve penale të regjistruara për vitin 2015 kanë respektivisht edhe numrin më të lartë të letërporosive të dërguara jashtë vendit. Më konkretisht, nga të dhënat statistikore rezulton se kanë dërguar letërporosi jashtë vendit Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë përkatësisht Tirana 229, Durrësi 97, Shkodra 61, Fieri 56, Prokuroria për Krime të Rënda 47, Vlora 40, Korça 38, Elbasani 25, Berati 21 letërporosi etj.



iv. Letërkërkesat sipas veprave penale të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda

Gjatë vitit 2015, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore kanë dërguar pranë autoriteteve të huaja kërkesa për ndihmë juridike në kuadër të procedimeve penale të regjistruar për vepra të ndryshme penale, ndër të cilat përmendim ato të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda si më poshtë:

- **180 letërporosi për autoritetet e huaja (ose 24 % e totalit të letërporosive)** për kryerjen e veprave penale të **trafiqeve të paligjshme**, përfshirë këtu trafikimin të miturve, personave të rritur, trafikimin e narkotikëve dhe trafikimin e mjeteve motorike;

- **121 letërporosi (ose 16,2 % e totalit të letërporosive)** për kryerjen e veprave penale të **krimit kibernetik**, të cilat i janë drejtuar shteteve si, SHBA, Britani e Madhe, Nigeri, Gjermani, Suedi etj;
- **116 letërporosi (ose 15,5 % e totalit të letërporosive)** për kryerjen e veprës penale të **pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale**;
- **20 letërporosi (ose 2,7 % e totalit të letërporosive)** për veprat penale të **mashtimit**;
- **18 letërporosi (ose 2,4 % e totalit të letërporosive)** në kuadër të procedimeve për kryerjen e **krimeve kundër jetës të kryera me dashje**;
- **5 letërporosi** për kryerjen e veprave penale të **dhunës në familje dhe braktisjes së fëmijëve**;
- **4 letërporosi** për kryerjen e veprave penale të **korrupsionit** aktiv apo pasiv të gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë, apo korrupsionit të personave që ushtrojnë funksione publike;
- **2 letërporosi** drejtuar autoriteteve amerikave të drejtësisë në kuadër të veprës penale të **grupit të strukturuar kriminal**; si dhe **1 letërporosi** për veprat penale të **terrorizmit**;

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2015, autoritetet gjyqësore të huaja kanë dërguar pranë autoriteteve shqiptare kërkesa për ndihmë juridike në kuadër të procedimeve penale të regjistruar për vepra të ndryshme penale, ndër të cilat përmendim ato të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda si më poshtë:

- **48 letërporosi** të ardhura nga autoritetet e huaja gjyqësore për kryerjen e veprave penale të **trafiqeve të paligjshme**, ndër të cilat 14 i ka transmetuar Kosova, 11 Italia etj;
- **17 letërporosi** për vepra penale të kryera nga **organizata kriminale**, ndër të cilat 6 kanë ardhur nga Italia, 4 nga Franca etj;
- **12 letërporosi** për veprën penale të **pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale**, nga shtete si Holanda, Greqia, Mbretëria e Belgjikës, Franca, Italia etj;
- **2 letërporosi** për veprat penale të terrorizmit të ardhura nga autoritetet gjyqësore greke dhe serbe;

Gjithashtu, për periudhën raportuese rezulton se:


- **1 shtetas shqiptar është ekstraduar** në Itali në kuadër të çështjes penale për veprën penale të krijimit të organizatës kriminale me qëllim **kryerjen e akteve terroriste**;
- **8 kërkesa për ekstradim** janë paraqitur nga autoritetet e huaja për shtetasit e shpallur në kërkim ndërkombëtar që janë arrestuar në Shqipëri, për veprat penale të **trafikimit**;
- **28 kërkesa për ekstradim** janë paraqitur nga autoritetet e huaja për shtetasit e shpallur në kërkim ndërkombëtar që janë arrestuar në Shqipëri, për veprat penale të **organizatës kriminale**, përkatësisht 1 nga Kosova e Serbia dhe 26 kërkesa nga Italia;

III. Njohjet e vendimeve penale

i. Njohjet e vendimeve penale të huaja

Në referencë të të dhënave statistikore rezulton se, për vitin 2015 autoritetet e huaja kanë paraqitur gjithsej 71 kërkesa për njohjen e vendimeve të tyre penale dhënë në ngarkim të shtetasve shqiptarë, tregues ky i cili rezulton me rritje të ndjeshme në masën 82 % krahasuar me vitin 2014, në të cilin është kërkuar njohja e vendimeve penale në 39 raste.

Njohje Vendimesh Penale të Huaja




Sikurse vërehet në tabelën e mëposhtme por edhe në të dhënat e tjera statistikore rezulton se, Kosova dhe Italia kanë vijuar të zënë pjesën më të madhe të kërkesave për njohje, përkatësisht Kosova me 26 kërkesa ose 73 % më shumë se viti i kaluar dhe Italia me 31 kërkesa ose 48 % më shumë se viti i kaluar. Po ashtu rritje ka patur edhe Greqia nga 2 kërkesa vitin e kaluar në 5 të

tilla për vitin 2015; Maqedonia ka paraqitur 3 kërkesa për njohje vendimesh penale, Belgjika e Mali i Zi nga 2 kërkesa dhe Turqia 1 kërkesë.

Njohje vendimesh penale të huaja


| | Viti 2014 | Viti 2015 |
|---------------|-----------|-----------|
| Kosovë | 15 | 26 |
| Itali | 21 | 31 |
| Greqi | 2 | 5 |

Sa më sipër, paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



ii. Njohjet e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit

Nga të dhënat statistikore rezulton se, gjatë vitit 2015 autoritetet shqiptare kanë paraqitur gjithsej 21 kërkesa për njohjen e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit, me një rritje me mbi 2 herë më shumë se në vitin 2014.




Në tabelën e mëposhtme, shihet qartë se numri më i lartë i kërkesave i është dërguar autoriteteve kosovare me 10 të tilla, duke vijuar më pas me 3 kërkesa për Malin e Zi, 2 kërkesa për Italinë etj.

| Njohje vendimesh penale shqiptare jashtë vendit | | |
|--|------------------|------------------|
| | Viti 2014 | Viti 2015 |
| Kosovë | 8 | 10 |
| Mal i Zi | 0 | 3 |
| Itali | 0 | 2 |
| Iran | 0 | 2 |
| Greqi | 1 | 1 |
| Hollande | 0 | 1 |
| Maqedoni | 0 | 1 |
| Suedi | 0 | 1 |
| Totali | 10 | 21 |

Grafikisht këto të dhëna paraqiten në grafikun e mëposhtëm:


Njohje e vendimeve penale shqiptare jashtë shtetit



IV. Transferimet e procedimeve penale

i. Transferimet e procedimeve nga jashtë

Në vitin 2015 është kërkuar në 21 raste transferimi i procedimeve penale nga jashtë me qëllim ushtrimin e ndjekjes penale në Shqipëri, duke konstatuar një rritje të ndjeshme me 1.1 herë më shumë krahasuar me vitin 2014, në të cilin është kërkuar transferimi në 10 raste.



Vlen të theksojmë se, numri më i lartë i kërkesave për transferimin e procedimeve nga jashtë i përket Kosovës dhe Malit të Zi përkatësisht me nga 7 dhe 6 procedime të transferuara, ndërsa Italia 3, Greqia 2, Franca, Holanda e Suedia me nga 1 procedim të transferuar në Shqipëri.

ii. Transferimet e procedimeve për jashtë

Në lidhje me transferimet e procedimeve për jashtë, sikurse paraqitet në grafikun e mësipërm, gjatë vitit 2015 rezulton se autoritetet shqiptare kanë transferuar tek autoritetet e huaja gjithsej 7 procedime penale. Më konkretisht, 6 procedime penale janë transferuar në Kosovë, ndërsa 1 procedim është transferuar në Gjermani.


V. Transferimet e personave të dënuar

i. Transferimet e personave të dënuar nga jashtë

Në vitin 2015 janë paraqitur në 56 raste, kërkesa për transferimin e subjekteve të dënuar nga jashtë, e më konkretisht nga Anglia 29 kërkesa, Italia 17 kërkesa, Kosova 3, si dhe Greqia,


Kroacia e Maqedonia përkatësisht me 2 kërkesa, Mali i Zi 1 kërkesë, duke konstatuar një rritje tepër të lartë prej 6 herë më shumë se viti 2014.

| Viti | 2014 | 2015 |
|--------------------------------------|------|------|
| Transferimi i të dënuarve nga jashtë | 8 | 56 |




ii. Transferimet e personave të dënuar për jashtë

Në vitin 2015 janë paraqitur 7 kërkesa për transferimin jashtë vendit të subjekteve të dënuar nga autoritetet shqiptare, duke konstatuar një ulje të lehtë krahasuar me vitin 2014, në të cilin është kërkuar transferimi në 9 raste.



VI. Urdhrat e arrestit ndërkombëtar

Një pjesë e rëndësishme e punës së Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme është procesi i shpalljes apo heqjes nga kërkimi ndërkombëtar i shtetasve shqiptarë të cilët janë dënuar me vendim të formës së prerë ose ndaj tyre me vendim Gjykate është caktuar një masë sigurimi personal “Arrest në burg”. Ky proces realizohet në koordinim me Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë në vendin tonë.



Referuar të dhënave statistikore konstatohet se gjatë vitit 2015 Prokuroria Shqiptare ka shpallur në kërkim ndërkombëtar gjithsej 309 subjekte. Ky tregues ka pësuar rritje të ndjeshme prej 49% krahasuar me vitin 2014, në të cilin janë shpallur në kërkim ndërkombëtar 207 subjekte.

Gjithashtu, Prokuroria ka kërkuar që Zyra Qëndrore Kombëtare Interpol Tirana të procedojë me heqjen e 170 subjekteve nga listat e kërkimit ndërkombëtar për shkaqe të ndryshme si p.sh një pjesë e tyre janë arrestuar në territorin shqiptar, dënimi konsiderohet i përfunduar për shkak se subjektet kanë përfituar nga Ligji për Amnistinë, është konstatuar parashkrimi i ekzekutimit të dënimit etj.

Vlerësojmë të theksojmë se, përveç volumit të punës të trajtuar specifikisht sipas fushave të mësipërme të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme ka trajtuar në kohë reale gjatë vitit 2015 edhe **729 kërkesa të ndryshme** të ardhura nga autoritetet gjyqësore vendase e ato ndërkombëtare.

Në konkluzion, nga të dhënat statistikore rezulton se pesha specifike e volumit të kërkesave²⁰ në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar sipas fushave të caktuara në raport me volumin e tyre në tërësi paraqitet si më poshtë:

- Pesha specifike e kërkesave për ekstradim nga jashtë zë 4,7 % të totalit të kërkesave;
- Pesha specifike e kërkesave për ekstradim të ardhura nga autoritetet e huaja është 5,6 %;
- Pesha specifike e letërporosive të ardhura nga autoritetet e huaja është 30 %;
- Pesha specifike e kërkesave për njohjen e vendimeve penale të ardhura nga autoritetet e huaja është 3,1 %;
- Pesha specifike e kërkesave për njohjen e vendimeve penale shqiptare drejtuar autoriteteve të huaja është 0,9 %;
- Pesha specifike e kërkesave për transferimin e procedimeve penale të ardhura nga autoritetet e huaja është 0,9 %;
- Pesha specifike e kërkesave për transferimin e procedimeve penale drejtuar autoriteteve të huaja është 0,3 %;
- Pesha specifike e kërkesave për transferimin e personave të dënuar të ardhura nga autoritetet e huaja është 2,4 %;
- Pesha specifike e kërkesave për transferimin e personave të dënuar drejtuar autoriteteve të huaja është 0,3 %;
- Pesha specifike e kërkesave për shpallje në kërkim ndërkombëtar është 13,5 %;
- Pesha specifike e kërkesave për heqjen nga kërkimi ndërkombëtar është 7,4 %;
- Pesha specifike e kërkesave të ndryshme të ardhura nga autoritetet gjyqësore vendase e ato ndërkombëtare është 31,8 %;

²⁰ Në volumin e kërkesave për efekt të kësaj analize nuk janë përfshirë kërkesat për ndihme juridike të Prokurorive pranë gjykatave të Rretheve Gjyqësore drejtuar autoriteteve të huaja nepermjet Ministrise se Drejtesisë.

VIII. Trajnime, vizita të prokurorëve jashtë vendit

Gjatë vitit 2015, Institucioni i Prokurorisë, ka marrë pjesë në një sërë aktivitetesh ndërkombëtare si, trajnime, vizita, konferenca etj., duke u përfaqësuar me prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore dhe ndihmës ligjorë.

Ndër këto aktivitete përmendim:

- Në datat **14 deri 16 Janar 2015, në Podgoricë, Mali i Zi**, u zhvillua trajnimi me temë *“Rëndësia e strategjisë së Teknologjisë së Informacionit e Komunikimit në punën e Prokurorisë”*, në të cilën morën pjesë përfaqësues të Institucionit të Prokurorisë shqiptare.
- Në datën **26 - 28 Janar 2015, në Romë, Itali**, është zhvilluar një takim koordinativ i nivelit të lartë ndërmjet Prokurorisë së Republikës së Shqipërisë dhe Drejtorisë Kombëtare Antimafia të Republikës së Italisë. Takimi kishte në fokus kryesor forcimin e bashkëpunimit, si dhe janë diskutuar për një sërë kërkesash për ndihmë juridike, kryesisht të Prokurorisë së Cagliari dhe Prokurorisë së Brescia.
- Në datën **25 Shkurt - 27 Shkurt 2015, në Londër, Mbretëri e Bashkuar**, janë zhvilluar disa takime koordinative të nivelit të lartë ndërmjet Prokurorisë së Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Kombëtare të Krimit të Mbretërisë së Bashkuar. Takimet kanë patur në fokus kryesor forcimin e bashkëpunimit, si dhe është diskutuar për një sërë kërkesash të bëra për ndihmë juridike ndërkombëtare.
- Në datat **16 – 17 Prill 2015**, një delegacion i Prokurorisë së Shtetit të Kosovës, zhvilloi një vizitë zyrtare në Shqipëri.
- Në datën **21 Prill 2015, në Bruksel, Belgjikë**, u zhvillua Konferenca e 7-të e Nënkomitetit për Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë, e organizuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të Marrëveshjes për Stabilizimin dhe Asociimin.
- Në datat **21 - 24 Prill 2015**, një delegacion i Prokurorisë së Përgjithshme zhvilloi një vizitë zyrtare në Karlsruhe, Gjermani, për nisjen e diskutimeve dhe shkëmbimin e ideve mbi bashkëpunimin në drejtësinë penale.
- Në datën **4 Maj – 6 Maj 2015**, në Bruksel, Belgjikë është zhvilluar një takim koordinativ lidhur me një procedimin penal të rregjistruar në Prokurorinë e Përgjithshme.
- Në datat **18 – 21 Maj 2015, në Beograd, Serbi**, është zhvilluar Takimi i 2-të Rajonal në kuadër të Rrjetit të Evropës Juglindore të Ekspertëve për Armët e Zjarrit (SEEFEN).

- Në datat **27– 30 Maj 2015, në St.Petersburg, Rusi**, është zhvilluar konferenca ndërkombëtare e *“Forumit Ligjor”*, Forum në të cilin ishin ftuar të marrin pjesë dhe përfaqësues të Prokurorisë Shqiptare.
- Në datat **10-11 Qershor 2015**, në Londër, Angli është zhvilluar një vizitë studimore, organizuar nga Zyra e Bashkimit Europian për Zgjerimin, TAIEX Instrument, me temë *“Marrja në pyetje e të Dyshuarve të Mitur”*.
- Në datat **08 - 11 Qershor 2015**, një delegacion i Prokurorisë së Përgjithshme zhvilloi një vizitë zyrtare në Pragë, Çeki, për nisjen e diskutimeve dhe shkëmbimin e ideve, eksperiencës dhe informacionit në kuadër të bashkëpunimit në drejtësinë penale, lidhur me luftën kundër krimit të organizuar, trafikeve dhe terrorizmit.
- Në datat **24 - 25 Qershor 2015, në Hagë, Hollandë**, u zhvillua një takim mbi taktikat kundër terrorizmit me temë *“Drejt një përgjigje të përbashkët gjyqësore ndaj luftëtarëve të huaj”*, e organizuar nga Eurojust.
- Në datat **22 - 24 Qershor 2015, në Podgoricë, Mal i Zi**, është zhvilluar takimi rajonal për të prezantuar dhe promovuar LURIS (Sistemi mbi rregjistrimin dhe menaxhimin e çështjeve për ndihme të ndërsjellë juridike). Prezantimi është bërë nga programi Rajonal IPA 2014.
- Në datat **29 – 30 Qershor 2015, në München, Gjermani**, është zhvilluar konferenca e 9-të ndërkombëtare *“Përdorimi i teknikave kompjuterike të avancuara në kriminalistikë”*.
- Në datat **22 – 26 Qershor 2015, në Budapest Hungari**, u zhvillua trajnimi me temë *“Hetimi i veprave penale ndaj mjedisit”*.
- Në datat **5-6 Korrik 2015, në Ohër, Maqedoni**, SELEC mundësoi zhvillimin e një takimi të përbashkët operacional me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe të provave që disponohen deri tani, si dhe koordinimin e veprimeve të mëtejshme për evidentimin e aktivitetit të një grupi të strukturuar kriminal.
- Në datat **14 – 18 Shtator 2015, në Zagreb, Kroaci**, është zhvilluar trajnimi *“Menaxhimi i çështjeve komplekse ndërkombëtare”*, i organizuar nga ICITAP – Albania (International Criminal Investigative Training Assistance Program).
- Në datat **14 - 18 Shtator 2015, në Strasburg, Francë**, është zhvilluar Takimi i 48-të Plenar i MONEYVAL, aktivitet në të cilin kanë marrë pjesë delegacione të vendeve të ndryshme me përfaqësues nga Institucione si Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e

Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, Ministria e Drejtësisë, Policia e Shtetit, Banka e Shqipërisë, etj.

- Në datat **16 - 18 Shtator 2015, në Vienë, Austri**, është zhvilluar takimi i 3-të i Grupit Tematik të Punës mbi Rrjetin e Ekspertëve të Skuadrave të Përbashkëta Hetimore, në kuadër të Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore, aktivitet i organizuar nga Sekretariati i PCC SEE.
- Në datat **13 – 17 Shtator 2015, në Zyrih, Zvicër** është zhvilluar Konferenca Vjetore e 20-të e Shoqatës Ndërkombëtare të Prokurorëve, Konferencë në të cilën ishin ftuar të marrin pjesë dhe përfaqësues të Prokurorisë Shqiptare.
- Në datat **21-23 Shtator 2015, në Ohër, Maqedoni**, Misioni i OSCE në Shkup u zhvillua një takim i përbashkët operacional me qëllim përforcimin e aftësive operative në luftën kundër fenomenit të trafikimit të lëndëve narkotike.
- Në datat **21 – 22 Shtator 2015, në Bar (Tivar), Mali i Zi**, u zhvillua Seminari Rajonal me temë: *“Informacioni kriminal, grumbullimi, përpunimi dhe shpërndarja e tij me qëllim luftën kundër aktiviteteve të paligjshme që mund të kryhen përmes transportit të kontenierëve”*.
- Në datat **29 – 30 Shtator 2015, në Zagreb, Kroaci**, u zhvillua Takimi i I-rë i përbashkët rajonal, ndërmjet grupeve të punës të policisë dhe prokurorisë në Ballkanin Perëndimor në kuadër të Projektit IPA 2014 *“Bashkëpunimi ndërkombëtar në Drejtësinë Penale: Rrjeti i Prokurorëve të Ballkanit Perëndimor”*.
- Në datat **11 - 14 Tetor 2015** ka zhvilluar një vizitë zyrtare në vendin tonë një delegacion i Prokurorisë së Përgjithshme të Bosnjë-Herzegovinës i kryesuar nga Prokurori i Përgjithshëm, *Z. Goran Salihović*, me qëllim nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Prokurorive Homologe.
- Në datat **14 - 16 Tetor 2015, në Gjenevë, Zvicër**, u zhvillua *Sesioni i 17-të i Forumit “Crans Montana” të Sigurisë së Brendshme dhe Globale, si dhe i Krimin Ndërshtetëror*.
- Në datat **25 – 31 Tetor 2015, në Zagreb, Kroaci**, është zhvilluar një vizitë studimore me temë *“Hetimi dhe ndjekja penale e veprave penale të korrupsionit/ Eksperienca Kroate”*, e organizuar nga TAIEX (Njësia e Ndërtimit të Institucioneve e Komisionit Evropian), në kuadër të riorganizimit dhe funksionimit të Njesisë Task-Force Antikorrupsion në Prokurorinë e Krimeve të Rënda.

- Në datat **27-29 Tetor 2015, në Maltë**, është zhvilluar **Konferenca Rajonale** mbi “Rolin e sistemit të drejtësisë kriminale në zbatimin e strategjive parandaluese dhe shtypëse kundër luftëtarëve të huaj terroristë: Analizë e rasteve praktike dhe shkëmbimi i praktikave më të mira”.
- Në datat **25 Tetor - 28 Tetor 2015**, në Munich, Gjermani, është zhvilluar Forumi i 17-të Ndërkombëtar mbi Prokurorinë Publike.
- Në datat **25– 27 Tetor 2015**, me ftesë të Prokurorit të Përgjithshëm të Mbretërisë së Spanjës Znj.Consuelo Madrigal Martinez-Pereda, një delegacion i Prokurorisë së Republikës së Shqipërisë ka zhvilluar një vizitë punë në Madrid, Spanjë.
- Në datat **16 deri 20 Nëntor 2015**, në ambjentet e Akademisë ILEA, në **Budapest Hungari**, u zhvillua kursi i trajnimit me temë “*Hetimi i veprave penale ndaj mjedisit*”.
- Në datat **17 – 18 Nëntor 2015, në Varshavë, Poloni**, është zhvilluar Konferenca me temë “Kundërveprimi ndaj pastrimit të parave që burojnë nga korrupsioni”, e organizuar nga Ministria e Financave të Polonisë, Inspektorati i Përgjithshëm i Informacionit Financiar dhe Departamenti i Informacionit Financiar.
- Në datat **23 – 27 Nëntor 2015, në Paris, Francë**, Shkolla Kombëtare e Magjistraturës dhe Shërbimi Qëndror për Parandalimin e Korrupsionit në Francë, ka organizuar trajnimin me temë "Korrupsioni: zbulimi, parandalimi dhe ndëshkimi".
- Në datat **30 Nëntor – 4 Dhjetor 2015, në Budapest Hungari**, u zhvillua trajnimi me temë “*Teknikat e hetimit financiar*”.
- Në datën **7- 9 Dhjetor 2015, në Paris, Francë**, u zhvillua Takimi i 6-të i Zbatimit të Ligjit Rrjeti ACN.
- Në datat **15 – 17 Dhjetor 2015**, me ftesë të Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Francës, një delegacion i Prokurorisë së Republikës së Shqipërisë ka zhvilluar një vizitë pune në **Paris, Francë**.
- Në datat **15 – 18 Dhjetor 2015, në Romë, Itali**, është zhvilluar një vizitë studimore me temë “*Roli i prokurorit në procesin penal*”, e organizuar nga TAIEX (Njësia e Ndërtimit të Institucioneve e Komisionit Evropian).

IX. Akte të përbashkëta

Prokuroria e Përgjithshme vazhdimisht është angazhuar për hartimin, nënshkrimin apo azhurnimin e Protokolleve të Përbashkëta të Bashkëpunimit me Institucionet homologe të vendeve të rajonit, e konkretisht, më datë 12.10.2015 është nënshkruar në Tiranë Marrëveshja për Bashkëpunim ndërmjet Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të Shqipërisë dhe Prokurorisë së Bosnjës e Hercegovinës.

Më poshtë paraqesim listën e Memorandumeve të Bashkëpunimit të nëshkruara nga Institucioni i Prokurorisë Shqiptare ndër vite, në rend kronologjik:

- Protokoli për bashkëpunim ndërmjet Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë Publike të Rumanisë për parandalimin e krimit në përgjithësi dhe krimit të organizuar në veçanti (nënshkruar në Bukuresht më datë 05.05.2000);
- Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Zyrës së Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë, Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, Zyrës së Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kroacisë, Zyrës së Prokurorit Publik e Republikës së Serbisë dhe Zyrës së Prokurorit Shtetëror Suprem të Malit të Zi për bashkëpunimin rajonal kundër krimit të organizuar dhe formave të tjera të krimit të rëndë (nënshkruar në Maqedoni më datë 20.03.2005);
- Memorandum Mirëkuptimi mbi Bashkëpunimin ndërmjet Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Maqedonisë në luftën kundër krimit ndërkufitar, trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigracionit të paligjshëm (nënshkruar në Ohër më 11.05.2007);
- Memorandumi i Mirëkuptimit për bashkëpunim ndërmjet Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Kroacisë në luftimin e krimit transnacional dhe pastrimit të të ardhurave përkatëse të krimit (nënshkruar më datë 11.06.2007);
- Memorandum Mirëkuptimi mbi Bashkëpunimin ndërmjet Zyrës së Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Malit të Zi dhe Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë në luftën kundër krimit të organizuar, trafikimit të narkotikëve, qenieve njerëzore, korrupsionit, pastrimit të parave etj (nënshkruar në Podgoricë më datë 26.07.2007);
- Memorandum Mirëkuptimi për Bashkëpunim ndërmjet Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm së Republikës të Ukrainës dhe Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të

Republikës së Shqipërisë në luftën kundër krimit transnacional dhe pastrimit të produkteve të veprës penale (nënshkruar në Odessa më datë 18.10.2007);

- Memorandum Mirëkuptimi mbi Bashkëpunimin ndërmjet Zyrës së Prokurorit Suprem të Republikës së Kinës dhe Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë në luftën kundër krimit në përgjithësi dhe në veçanti kundër terrorizmit (nënshkruar në Pekin, 2007);
- Memorandum Mirëkuptimi (ndryshuar më 25.01.2010) ndërmjet Zyrës së Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë, Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, Zyrës së Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kroacisë, Zyrës së Prokurorit Publik të Republikës së Republikës së Serbisë dhe Zyrës së Prokurorit Shtetëror Suprem të Malit të Zi për bashkëpunimin rajonal kundër krimit të organizuar dhe formave të tjera të krimit të rëndë (nënshkruar në Romë, Itali më datë 25.01.2010);
- Memorandum Mirëkuptimi për Bashkëpunim në çështjet penale ndërmjet Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës dhe Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë në luftën kundër krimit të organizuar, trafikimit të narkotikëve, qenieve njerëzore, korrupsionit, pastrimit të parave, etj. (nënshkruar në Tiranë më datë 12.10.2010);
- Marrëveshje për Bashkëpunim ndërmjet Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Prokurorit Federal të Belgjikës për bashkëpunim gjyqësor në veçanti në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit (nënshkruar në Bruksel më datë 10.05.2011);
- Deklarata e përbashkët ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Turqisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë për parandalimin dhe luftën kundër kriminalitetit, korrupsionit dhe pastrimit të parave, trafikimit të qenieve njerëzore dhe në veçanti të krimit të organizuar dhe ndërkuftar (nënshkruar në Tiranë më datë 12.06.2014);
- Memorandum për Bashkëpunim ndërmjet Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë dhe Drejtorisë Kombëtare (*Direzione Nazionale Antimafia*) të Republikës së Italisë në krimin e organizuar (nënshkruar në Tiranë më datë 28.10.1997);
- Memorandum për Bashkëpunim ndërmjet Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë dhe Drejtorisë Kombëtare (*Direzione Nazionale Antimafia*) të


Republikës së Italisë në krimin e organizuar dhe veprat penale të lidhura me to dhe të pastrimit të parave (e nënshkruar në Tiranë më datë 05.11.2014);

- Marrëveshje për Bashkëpunim ndërmjet Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të Shqipërisë dhe Prokurorisë së Bosnjë-Hercegovinës në parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të krimit të rëndë, krimit të organizuar në veçanti ndërkombëtar dhe transnacional, krimit ekonomik dhe korrupsionit, përdorimit të paligjshëm të aseteve kriminale, terrorizmit ndërkombëtar dhe krimeve e lidhura me to, krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit, gjenocidit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare (nënshkruar në Tiranë më datë 12.10.2015).

IV. PROKURORIA PËR KRIME TË RËNDA

4.1 Volumi dhe dinamika e lëvizjes së procedimeve

Gjatë vitit 2015 në Prokurorinë për Krime të Rënda u hetuan 776²¹ procedime, nga të cilat 274 të mbartura nga vitet e mëparshme dhe 365 të regjistruara rishtazi gjatë vitit që kaloi. Kanë marrë zgjidhje 476 procedime, ndërkohë që u mbartën për vitin 2016, 301 procedime. Kjo situatë paraqitet grafikisht në vijim:




Vihet re se numri i procedimeve të regjistruara rishtazi është thajse i njëjtë me vitin 2014 (10 më pak). Morën zgjidhje përfundimtare 476 procedime, ose 153 procedime më shumë në krahasim me vitin e kaluar. Për shkak të rritjes së ngarkesës, u rrit edhe numri i çështjeve të mbartura. Për 34 kallëzime u vendos mosfillimi i procedimit për mungesë të elementeve të faktit penal.

²¹ Nga numri i procedimeve të regjistruara ku përfshihen dhe ato të ardhura me transferim, janë zbritur procedimet e bashkuara me procedimet në hetim. Në këtë numër nuk përfshihen gjithashtu procedimet e ndara nga ato në hetim, procedimet rifilluara dhe procedimet e reregjistruara pas kthimit nga gjykata.

4.2 Treguesit teknikë

Në përfundim të hetimeve u dërguan për gjykim 148 çështje, u pushuan 91 procedime dhe u pezulluan 59. Në gjyq u dërguan rreth 50 % e numrit të procedimeve të zgjidhura, i cili mund të konsiderohet një tregues i mirë. Gjatë 2015-ës u transferuan për kompetencë në prokuroritë e rretheve gjyqësore 178 procedime penale.




4.3 Tipologjia dhe tendenca e kriminalitetit

Ndër grupveprat penale në hetim gjatë vitit 2015, ashtu si vitet e kaluara, pjesën dërmuese e përbëjnë krimet e trafikimit të lëndëve narkotike, shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë, trafikimi i qenieve njerëzore, vrasjet e ndryshme, sidomos vrasjet brenda familjes, krimet e korrupsionit, veprat e ndryshme penale të kryera nga organizata kriminale dhe grupe të strukturuar, trafikimi i armëve dhe i municioneve, krimet e lidhura me terrorizmin, rrëmbimi i personit. (Të dhëna të detajuara gjenden në pjesën e dytë të këtij raporti).


Analiza e të dhënave tregon se, numri i procedimeve për trafikim të lëndëve narkotike ka treguar një rënie të lehtë krahasuar me dy vitet e mëparshme, ndërsa rritje patën procedimet për krimet e trafikimit të njerëzve, veprat korruptive, krimet e kryera nga organizata dhe grupe të strukturuar kriminale, krimet e lidhura me terrorizmin, shtrëngimi për dhënien e pasurisë. Krimet e vrasjeve në kompetencë të kësaj zyre mbetën thuajse në të njëjtin nivel duke treguar se ashpërsimi i sanksioneve në Kodin Penal nuk ka dhënë efektin e pritur në drejtim të parandalimit të kimit brenda familjes. Rastet e kimit të shtrëngimit me anën e kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë dhe rrëmbimi i personit kanë shënuar rritje. Tendenca e kriminalitetit të hetuar për krime të kryera nga organizata ose grupe të strukturuar dhe krime të terrorizmit ka një rritje sasiore në raport me vitet e mëparshme.

4.4 Vendimmarrja për subjektet

Gjatë vitit 2015 u vunë nën hetim 706 persona, 89 më shumë se gjatë vitit 2014 dhe 293 më shumë se gjatë vitit 2013. Nga këta, 311 u dërguan për gjykim dhe 229 (43 më pak se vitin e kaluar) u mbartën për vitin në vazhdim. U pushuan hetimet ose akuzat për 50 subjekte, ndërsa procedimet për 116 subjekte të tjera u transferuan për kompetencë në prokuroritë e rretheve gjyqësore.



Nga 311 subjektet e dërguara për gjykim, pjesa më e madhe e tyre (274 persona) kanë qenë nën masën e sigurimit arrest në burg (248 në fakt dhe 26 në mungesë), kurse 7 prej tyre nën masën e arrestit në shtëpi. Ndërkohë, 8 subjekte kanë qenë nën masën e sigurimit detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore, kurse 16 subjekte pa masë sigurimi.



4.5 Volumi dhe dinamika e gjykimeve

Gjatë vitit 2015 përfundoi gjykimi në shkallë të parë për 152 çështje (2 më shumë se një vit më parë) me 243 persona të akuzuar (35 persona më shumë se në 2014-n). Numri i çështjeve të gjykuara gjatë vitit të kaluar është më i larti ndër vite. Gjithashtu, përfundoi gjykimi në apel dhe u vunë në ekzekutim 120 vendime penale. Në fazën e gjykitimit në shkallë të parë u mbartën për vitin 2016, 32 çështje (5 më shumë se në vitin 2014). Të gjitha vendimet e gjykatës së apelit janë vënë në ekzekutim brenda afatit ligjor.

4.6 Tregues të politikës së dënimit

Edhe gjatë vitit 2015, megjithë ashpërsimin e sanksioneve për krimet e vrasjes brenda familjes, në planin parandalues nuk u shënuan rezultate pozitive dhe numri dhe përhapja e këtyre krimeve mbeten të larta. Për krimin e trafikimit të lëndëve narkotike, gjatë vitit 2015, dënimet ishin pothuajse të njëjta, me një ashpërsim prej disa muajsh në gjykimin në apel.

V. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2016

Prokuroria Shqiptare, duke patur në vëmendje analizën e punës së gjithë strukturave të saj, arritjet dhe nevojat për përmirësim, rekomandimet e Progres Raportit 2015 për Shqipërinë, dokumentat strategjikë kombëtarë dhe tendencat e kriminalitetit gjatë vitit 2015, ka përcaktuar prioritetet për vitin 2016 si vijon:

- **Konsolidimin e strukturave antikorrupsion**, Njësinë e Hetimit të Korrupsionit në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda dhe Njësitë e Përbashkëta Hetimore, duke mbështetur stafet e tyre me trajnime, pajisje logjistike, infrastrukturë informatike etj;
- **Rritjen e kapaciteteve të shërbimeve të ekspertimit** në funksion të hetimit të këtyre krimeve dhe hetimit pasuror;
- Do të synojmë rritjen e bashkëveprimit ndërmjet prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe seksionit të hetimit të pasurive në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda, duke ndërhyrë në akte nënligjore me qëllim rritjen e efikasitetit të zbatimit të ligjit “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar;
- Rritja e efektivitetit të ndjekjes penale ndaj veprave me tendencë në rritje të kriminalitetit gjatë vitit 2015, do të jenë në qendër të veprimtarisë sonë në vitin 2016;
- **Rritjen e efikasitetit të hetimeve proaktive** dhe metodave të posaçme të hetimeve në goditjen e krimit të organizuar;
Ne vlerësojmë se nevojitet të investohet më shumë në aspektin infrastrukturor, ligjor e njerëzor për sa i takon përafrimit me standartet europiane. Në këtë kuadër sa i përket përgjimit të komunikimeve elektronike, përbën domosdoshmëri rritja e kapaciteteve interceptuese të tyre, kushtëzuar së pari nga aktivitetet e grupeve kriminale në territorin e Republikës së Shqipërisë apo edhe jashtë saj si dhe sofistikimi i komunikimit ndërmjet anëtarëve të këtyre grupeve;
- Intensifikimin e punës në drejtim të kontrollit të brendshëm të prokurorive të shkallës së parë dhe apeleve. Përmirësimi i kuadrit nënligjor me qëllim rritjen e cilësisë dhe shpejtësisë së hetimeve si dhe unifikimin e qëndrimeve për ushtrimin e ndjekjes penale, sa i përket krimeve në përgjithësi, krimeve të rënda si dhe krimit të organizuar në veçanti;

- **Forcimin e luftës ndaj krimit kibernetik.** Gjithnjë e më shumë në eksperiencën hetimore vendase apo ndërkombëtare, po vërehet një lidhje e ngushtë e aktivitetit të krimit të organizuar, terrorizmit, financimit të tij, pastrimit të parave dhe krimeve kompjuterike, të cilat synojnë përfitimet ekonomike të paligjshme apo cënimin e infrastrukturës kritike të një vendi. Në këtë kuadër, përfitimi nga projekti IPA në lidhje me forcimin e kapaciteteve për sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit kibernetik, është në linjën e synimeve tona për një luftë më efektive ndaj këtij kriminaliteti. Për shkak të masivizmit të përdorimit të internetit, vështirësive dhe kostos së vënies para përgjegjësive të autorëve, bashkëpunimi me strukturat e tjera shtetërore të përfshira në Dokumentin e Politikave për Sigurinë Kibernetike për një qasje parandaluese ndaj krimit kibernetik, do të jetë gjithashtu një synim në të ardhmen;
- **Vëmendje e veçantë ndaj grupeve vulnerabël.** Prokuroria do të vazhdojë të ndjekë një politikë penale të përshtatshme ndaj të miturve, grave dhe personave me aftësi të kufizuara që procedohen penalisht, apo edhe ndaj personave që akuzohen për kryerjen e veprave penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore, si në caktimin e masave të sigurimit ashtu edhe në aplikimin e dënimeve alternative;
- **Forcimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit** me të gjitha institucionet që kanë shërbime të policisë gjyqësore dhe koordinimi me institucione të tjera ligjzbatuese si domosdoshmëri në punën e organit të prokurorisë;
- **Forcimin e bashkëpunimit bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar** dhe bashkëpunimit me agjensitë e huaja të zbatimit të ligjit;
- **Rritja dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore.** Forcimi i kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme dhe rritja e integritetit të prokurorit dhe oficerëve të policisë gjyqësore në arritjen e standarteve më të mira në aktivitetin institucional, performancën dhe efektivitetin në punën e tyre, do të jetë një objektiv i rëndësishëm edhe në vitin 2016. Vlerësimi i punës, inspektimi, procesi disiplinor dhe çështjet që lidhen me karrierën e prokurorit dhe oficerëve të policisë gjyqësore do të jenë të një rëndësie të veçantë gjatë vitit 2016. Do të synohet kontrolli më thellësisht i cilësisë së veprimtarisë së prokurorit nga këndvështrimi i formulimit dhe arsyetimit të akteve procedurale. Kjo do të ndihmojë në vlerësimin real dhe të drejtë të punës së tyre duke i shërbyer karrierës profesionale dhe rritjes së cilësisë së hetimit dhe ndjekjes penale në tërësi;
- Përdorimin me efektivitet të fondeve buxhetore për përmirësimin e kushteve dhe ambjenteve të punës për prokurorët mbetet një objektiv i rëndësishëm edhe për vitin 2016;

Të nderuar deputetë,

Prokuroria Shqiptare në përmbushje të objektivave të saj në luftën kundër kriminalitetit është e angazhuar maksimalisht në rritjen e efektivitetit të hetimit, ndjekjes penale e përfaqësimit të akuzës në gjyq në emër të shtetit shqiptar duke garantuar të drejtat e liritë themelore të shtetasve.

Ju faleminderit!

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

ADRIATIK LLALLA